



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

LEGJISLATURA IX - SEANCA E DITËS SË ENJTE, 5 DHJETOR 2019, TIRANË

PROCESVERBAL

**SEANCËN E DREJTON
KRYETARI I KUVENDIT
GRAMOZ RUÇI**

(Seanca filloi në orën 10:00)

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të datës 15.11.2019 *(neni 44, pika 2, i Rregullores)*

2. Njoftimi i projektligjeve të depozituara në Kuvend *(neni 44, pika 3, i Rregullores)*

3. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”. *(në parim: nenet 73-74 dhe 82 të Rregullores, shumicë e thjeshtë votash për miratimin në parim)*

Pyetje

Paraqitja e projektligjit nga nismëtari
Shprehet Komisioni përgjegjës për
Ekonominë dhe Financat.

Relator: Anastas Angjeli

Diskutime në parim

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit në parim

4. Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar” *(në parim: nenet 73-74 dhe 82 të Rregullores, shumicë e thjeshtë votash për miratimin në parim)*

Pyetje

Paraqitja e projektligjit nga nismëtari
Shprehet Komisioni përgjegjës për
Ekonominë dhe Financat.

Relator: Anastas Angjeli

Diskutime në parim

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit në parim

5. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar” *(në parim: nenet 73-74 dhe 82 të Rregullores, shumicë e thjeshtë votash për miratimin në parim)*

Pyetje
Paraqitja e projektligjit nga nismëtari
Shprehet Komisioni përgjegjës për
Ekonominë dhe Financat.

Relator: Anastas Angjeli

Diskutime në parim

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit në parim

6. Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar” (në parim: *nenet 73-74 dhe 82 të Rregullores, shumicë e thjeshtë votash për miratimin në parim*)

Pyetje

Paraqitja e projektligjit nga nismëtari
Shprehet Komisioni përgjegjës për
Ekonominë dhe Financat.

Relator: Anastas Angjeli

Diskutime në parim

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit në parim

7. Projektligji “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit” (në parim: *nenet 73-74 dhe 82 të Rregullores, shumicë e thjeshtë votash për miratimin në parim*)

Pyetje

Paraqitja e projektligjit nga nismëtari
Shprehet Komisioni përgjegjës për
Ekonominë dhe Financat.

Relator: Anastas Angjeli

Diskutime në parim

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit në parim

8. Projektligji “Për buxhetin e vitit 2020” (në parim: *nenet 73-74 dhe 82 të Rregullores, shumicë e thjeshtë votash për miratimin në parim*)

Pyetje

Paraqitja e projektligjit nga nismëtari
Shprehet Komisioni përgjegjës për
Ekonominë dhe Financat

Relator: Arben Ahmetaj

Diskutime në parim

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit në parim

9. Akt normativ nr. 4, datë 30.11.2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar” (neni 101 i Kushtetutës dhe *nenet 73-74 dhe 88 të*

Rregullores, shumicë e thjeshtë votash për miratim)

Pyetje

Paraqitja e aktit normativ nga nismëtari
Shprehet Komisioni përgjegjës për
Ekonominë dhe Financat

Relator: Arben Ahmetaj

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit

10. Akt normativ nr. 5 datë 30.11.2019 “Për një shtesë në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar” (neni 101 i Kushtetutës dhe *nenet 73-74 dhe 88 të Rregullores, shumicë e thjeshtë votash për miratim*)

Pyetje

Paraqitja e aktit normativ nga nismëtari
Shprehet Komisioni përgjegjës për
Ekonominë dhe Financat.

Relator: Arben Ahmetaj

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit

11. Akt normativ nr. 6, datë 30.11.2019 “Për dhurimin e apartamenteve familjarëve të viktimave, si pasojë e tërmetit të datës 26.11.2019” (neni 101 i Kushtetutës dhe *nenet 73-74 dhe 88 të Rregullores, shumicë e thjeshtë votash për miratim*)

Pyetje

Paraqitja e aktit normativ nga nismëtari
Shprehet Komisioni përgjegjës për
Ekonominë dhe Financat.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Relator: Arben Ahmetaj

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit

12. Akt normativ nr. 7, datë 30.11.2019 “Për një shtesë në ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar” (neni 101 i Kushtetutës dhe *nenet 73-74 dhe 88 të Rregullores, shumicë e thjeshtë votash për miratim*)

Pyetje

Paraqitja e aktit normativ nga nismëtari

Shprehet Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat.

Relator: Arben Ahmetaj

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit

13. Projektligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në aktin final të konferencës së shteteve anëtare të Konventës Ndërkombëtare për Standardet e Kualifikimit, Çertifikimit dhe Shërbimit për Detarët, (STCW) 1978” *(nenet 121 dhe 122 të Kushtetutës dhe nenet 73-77 të Rregullores, shumicë absolute votash për miratim)*

Pyetje

Paraqitja e projektligjit nga nismëtari

Shprehet Komisioni përgjegjës për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Politikën e Jashtme.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Sigurinë Kombëtare.

Relator: Edmond Leka

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit (në parim, nen për nen dhe në tërësi)

14. Projektrezolutë “Për ndërhyrjet e huaja në proceset zgjedhore dhe dezinformimit në proceset demokratike kombëtare” *(neni 78 i Kushtetutës dhe nenet 18, 55 e 73-77 të Rregullores, shumicë e thjeshtë votash për miratim)*

Paraqitja e projektrezolutës nga nismëtari

Shprehet Komisioni përgjegjës për Sigurinë Kombëtare

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Politikën e Jashtme

Relatore: Ermonela Felaj

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit

15. Projektvendimi “Për zgjedhjen e Prokurorit të Përgjithshëm”. *(neni 148/a i Kushtetutës, neni 35 i ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, votim i fshehtë,*

shumicë e cilësuar votash për miratim, 3/5-at e të gjithë anëtarëve të Kuvendit).

Koha e votimit

16. Projektvendimi “Për shqyrtimin me procedurë të përsheptuar të projektligjit “Për një ndryshim në ligjin “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar *(pika 2 e nenit 83 të Kushtetutës dhe neni 28 i Rregullores, shumicë e thjeshtë votash për miratim)*

Shprehet një folës pro dhe një folës kundër.

Koha e votimit

17. Projektvendimi “Për një shtesë në objektin e veprimtarisë së komisionit hetimor “Për kontrollin e ligjshmërisë së veprimeve të kryera nga ana e Presidentit të Republikës së Shqipërisë, në kuadër të ushtrimit të kompetencave të tij, lidhur me zhvillimin e zgjedhjeve në organet e qeverisjes vendore”, ngritur me vendimin e Kuvendit nr. 84/2019” *(neni 8 i ligjit nr. 8891/2002 “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore” dhe neni 25 i Rregullores, shumicë e thjeshtë votash për miratim)*

Koha e votimit

18. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës *(neni 45 i Rregullores)*

Koha e diskutimeve deri në 60 minuta.

Gramoz Ruçi - Ulemi, kolegë deputetë!
 Le të futet media brenda!
 Kolegë deputetë, le të ulemi, ju lutem!
 Le të fillojmë, ju lutem!
 Seancën e ditës së sotme e deklaroj të hapur!

Të nderuara zonja dhe zotërinj deputetë,
 Të dashur qytetarë të Shqipërisë,
 Zonja dhe zotërinj deputetë,
 Kjo seancë është e para, pas tërmetit shkatërrimtar të 26 nëntorit.

Prandaj, në kujtim e nderim të 51 viktimave të tërmetit të 26 nëntorit, ju ftoj të gjithëve të mbajmë një minutë heshtje.

(Mbahet një minutë heshtje.)

U prehshin në paqe!

Të nderuar deputetë,

Para se të fillojmë me rendin e ditës së kësaj seance, dëshiroj të ndaj me ju disa refleksione të miat, pas kësaj dhimbjeje të madhe dhe pas kësaj goditjeje që na dha natyra.

Refleksioni i parë është mësimi prej humanizmit, prej solidaritetit dhe prej sakrificave të shqiptarëve kudo ku ndodhen, në Shqipëri, në Kosovë, në trevat e tjera shqiptare dhe në gjithë diasporën shqiptare.

Ne, ligjvënësit, duhet ta lexojmë mirë dhe thellë sjelljen e qytetarëve tanë, e njëherësh edhe të bashkëkombësve tanë.

Në fillim do të falënderoja dhe do të inkurajoja të gjitha koleget dhe kolegët deputetë, që në këto ditë, por jo vetëm, u gjenden dhe do të vazhdojnë të gjenden pranë qytetarëve.

Do të vlerësoja përgjegjësinë dhe impenjimin e qeverisë në lidhje me masat emergjente, si dhe parapërgatitjet e përgatitjet që ajo po bën për të gjitha problemet, me qëllim që t'u japë zgjidhje si problemeve afatshkurtra, ashtu edhe atyre afatmesme e afatgjata.

Do të falënderoja të gjitha palët politike, pa përjashtim, përfshirë opozitën parlamentare dhe atë joparlamentar, që dhanë shenja mirëkuptimi e vënien e jetës së qytetarëve mbi interesat politike dhe elektorale.

Por motrat dhe vëllezërit tanë të goditur nga tërmeti, të gjithë shqiptarët kudo ku janë, presin që relaksimi i betejave të stërzgjitura politike të pasohet në vazhdim nga një bashkëpunim i plotë politik.

Prandaj, unë do t'u bëja thirrje të gjitha palëve që, si një lutje për shpirtin e 51 viktimave,

të ndiejmë apelin e familjarëve të tyre, të ndiejmë apelin e një mijë të lënduarve, të mijëra familjeve që mbetën të pastreha, të nxënësve që u janë rrënuar shkollat, si dhe të bashkëpunojmë për t'ua lehtësuar atyre dhimbjen.

Refleksioni i dytë lidhet direkt me punën tonë si ligjvënës të Republikës.

Gjatë viteve të fundit, por edhe gjatë këtyre tri dekadave, kemi bërë reforma, kemi miratuar kode e korpuse të tërë ligjesh, të cilat kanë ndihmuar zhvillimin e Shqipërisë dhe kanë përmirësuar mirëqenien e qytetarëve.

Por 26 nëntori duhet të na zgjojë dhe duhet të na kujtojë se diçka nuk e kemi bërë si duhet.

Ligjet që kemi miratuar, unë do t'i ndaja në dy grupe të mëdha: ligje që rregullojnë punët e shoqërisë dhe ligje që rregullojnë marrëdhëniet e bashkëjetesës tonë me natyrën.

Është e pamundur që në pak ditë të formosh një gjykim për ligjet tona, por në këtë grup të dytë, sigurisht që situata na nxori se ka diçka që nuk shkon.

Prandaj mendoj se legjislacioni për tokën, për mjedisin, për ndërtimet, për ujërat, parandalimin e fatkeqësive natyrore, si dhe çështje të tjera që lidhen me natyrën, burimet, pasuritë, por edhe kapriçot e saj, nuk është thjesht i papërsosur.

Dyshoj se në mjaft çështje nevralgjike të kompetencave tona mbi natyrën dhe mbi menaxhimin e marrëdhënieve me mjedisin kemi probleme.

Ne, të nderuar kolegë, mund të merremi vesh shumë mirë me njeri-tjetrin, mund të hartojmë ligje që na përshtaten neve dhe duket sikur i përshtaten edhe Shqipërisë. Por a mbështeten të gjitha ligjet tona në mirëkuptimin me natyrën dhe ligjësitë e saj?

Natyra mund të jetë e pabesë, por pabesia e saj rritet në proporcion gjeometrik me paditurinë, abuzivizmin dhe pabesinë tonë ndaj natyrës.

Nuk rikthehem në pozitat e të drejtës natyrore, nëse mendoj dhe kërkoj që ligjet që miratojmë nuk mund dhe nuk duhet t'u kundërvihen ligjësive të natyrës, të cilat janë universale, janë të pandryshueshme e të përvetshme.

Refleksioni i tretë lidhet me instrumentet që përdorim për të zbatuar ligjet që kemi miratuar, sidomos korpusin e ligjeve të bashkëpunimit e bashkëjetesës me natyrën. Nga ky korpus po

veçoj bllokun e ligjeve për ndërtimet. Tërmeti i 26 nëntorit na kujtoi se kemi nevojë për një veting të thellë, për të verifikuar kualifikimet, aftësitë, agjencitë, procedurat, rregulloret, licencimet dhe lejet për të ndërtuar.

Ligjet nuk i kemi të përsosura, por edhe të tilla po të ishin, ato mund të komprometoheshin e mund të helmatiseshin, nëse në këto instrumente e mekanizma mbizotërojnë abuzivizmi dhe korruptimi.

Natyrisht, që të verifikojmë sa përmenda më sipër, nuk është një punë e lehtë, sepse kërkon vizion, kohë, energji e vullnet, por unë mendoj se duhet të nisim të mendojmë për këto gjëra që të mund të marrim masa sa më të shpejta e afatgjata.

Mendoj se Kuvendi, krahas ekzekutivit, duhet të marrë pjesën e vet të detyrës në këto rishikime ligjesh, për të cilat duhet të thërrasim e bashkëpunojmë jo vetëm me ekspertët më të mire vendas, por edhe nga bota.

Natyrisht, ne nuk mund të ndalojmë dhe as mund të ndryshojmë ligjësitë e natyrës, por mund të rrisim shkallën dhe kapacitetet mbrojtëse ndaj tyre, mund t'i minimizojmë pasojat, në vend që t'i shumëfishojmë ato. Përndryshe, një fatkeqësi natyrore si tërmeti nuk mbetet thjesht e vetëm natyrore.

Së fundi, dëshiroj t'ju informoj se unë, si Kryetar i Kuvendit, në emër tuaj, u kam shkruar të gjithë kryetarëve të parlamenteve të vendeve të Bashkimit Europian, Presidentes së Dhomës së Përfaqësuesve dhe Presidentit të Senatit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, kryeparlamentarëve të vendeve fqinje, si dhe të gjitha vendeve tona partnere e mike, nga Kanadaja në Japoni, për t'i falënderuar për ndihmën bujare emergjente ndaj vendit tonë, si edhe për të kërkuar mbështetje financiare për zgjidhjen e qëndrueshme e afatgjatë të problemit të strehimit dhe nevojave të tjera të banorëve të zonave të prekura nga tërmeti.

Jam i bindur se mbështetja e vendeve mike e partnere nuk do të na mungojë.

Ju faleminderit!

Vazhdojmë me rendin e ditës.

(Pasi lexon rendin e ditës)

Në lidhje me procesverbalin e seancës së kaluar, a ka vërejtjetje? Nuk ka.

Miratohet.

Njoftime

Ju njoftoj se Këshilli i Ministrave ka depozituar 6 projektligje dhe 4 akte normative me fuqinë e ligjit, të cilat i kemi sot në rendin e ditës, siç e lexova më parë.

Nga deputetët janë depozituar 2 projektligje, njëri prej të cilëve, nismë e deputetit Arben Ahmetaj "Për rivlerësimin e pasurive të paluajtshme", i cili do të shqyrtohet në seancën plenare të datës 19.12.2019.

Kemi një interpelancë, një kërkesë për shqyrtimin me procedurë të përshpejtuar të nismës së deputetit Ilir Beqaj, si dhe dy kërkesa për ndryshime në ngritjen e komisionit hetimor: kërkesë për shqyrtimin për zgjerimin e objektit dhe zgjatjen e afatit të veprimtarisë së këtij komisioni.

Në vijim të njoftimeve, ju bëj me dije se Grupi Parlamentar i Partive të Djathta pushon së ekzistuari, pasi numri i anëtarëve ka rënë nën minimumin e parashikuar në pikën 6 të nenit 15 të Rregullores, si pasojë e largimit nga ky grup i 4 deputetëve.

Nga Presidenti i Republikës është depozituar një dekret për kthim të ligjit për rishqyrtim.

Nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë është depozituar që prej datës 22.11.2019 vendimi "Për renditjen e kandidatëve për Prokuror të Përgjithshëm", si dhe relacioni shoqërues.

Këtë çështje e kemi sot në rendin e ditës.

Njoftimi i fundit: nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është depozituar kërkesa për ndryshim në strukturën organizative, organikën dhe klasifikimin e pagave të personelit të këtij institucioni.

Nismat dhe njoftimet i keni të gjithë mbi tavolinat tuaja të punës dhe këto materiale, si gjithnjë, do t'i gjeni të publikuara në faqen virtuale zyrtare të Kuvendit.

Fillojmë me çështjen e parë të rendit të ditës, projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar", pra, në total për të gjithë paketën fiskale, pa i lexuar të gjitha me radhë.

Urdhëroni, ministrja e Financave!

Anila Denaj – I nderuar Kryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Më lejoni të përmbledh në këtë fjalim disa pika, të cilat, sipas rendit të ditës, nga pika e tretë deri në pikën e shtatë, përbëjnë atë që është pjesë e diskutimit të paketës fiskale.

Do të them shkurtimisht se çfarë nënkupton secila prej tyre.

Në vitet e kaluara kemi ndërmarrë një sërë masash për reduktimin e barrës fiskale, ofrimin e incentivave dhe lehtësive për industri dhe sektorë strategjikë të ekonomisë shqiptare.

Këtë vit, ndryshe nga tradita e mëparshme, qeveria shqiptare nuk vjen me një paketë tipike fiskale, por me një paketë ndryshimesh në ligjet fiskale, me masa fiskale kryesisht në funksion të miradministrimit tatimor dhe nxitjes së disa sektorëve.

Kërkesat e bizneseve kanë qenë reduktimi i informalitetit, krijimi i mjedisit më konkurrues në formën e adresimit të drejtë të problematikave dhe të informalitetit dhe, mbi të gjitha, një qasje më proaktive ndaj nxitjes së një klime pozitive të marrëdhënies me ta.

E rëndësishme për t'u sjellë në vëmendje është, gjithashtu, puna e nisur me ekspertët e FMN-së për draftimin e Strategjisë Afatmesme të të Ardhurave.

Për këtë arsye, më lejoni të evidentoj më poshtë, disa nga objektivat që realizon projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar”.

Propozohen ndryshime, të cilat synojnë:

Harmonizimin e dispozitave përkatëse të ligjit për procedurat tatimore, me përcaktimet e projektligjit “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”; harmonizimin dhe unifikimin e kundërvajtjeve administrative që lidhen me çështjet e faturimit, duke synuar përshkallëzimin e gjobave sipas përgjegjësiive tatimore dhe administratës në përgjithësi; kompensimin e detyrimeve tatimore ndërmjet administratës tatimore dhe administratës doganore; lidhjen e një marrëveshjeje për detyrimet që administrata tatimore ka ndaj tatimpaguesve për TVSH-në e rimbursueshme, sipas një plani pagese të rënë dakord, me një afat kohor deri në 30.06.2021; zgjerimin e objektit për lidhjen e marrëveshjes së pagesës me këste për detyrimet e tatimpaguesve dhe për detyrimet e vetëdeklaruarra për TVSH-në, si dhe për

sigurimet shoqërore në raste specifike për institucionet buxhetore; ndryshimin e deklaratës së tatimpaguesit vetëm një herë brenda 36 muajve dhe për sigurimet shoqërore vetëm një herë në muajin pasardhës; njoftimin e tatimpaguesit para kontrollit dhe vizitës fiskale, e cila nga 30 ditë dhe 10 ditë bëhet përkatësisht 10 dhe 5 ditë.

Në projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar”, incentivizohet sektori i industrisë automotive, duke caktuar normë tatim fitimi 5% për personat juridikë që ushtrojnë veprimtari ekonomike në këtë industri.

Vendosja e një norme të reduktuar tatimi mbi fitimin për këtë sektor, siç kemi bërë edhe më parë për sektorin e agrobiznesit apo ICT-së, e shndërron këtë sektor në një sektor prioritar dhe e përfron me incentiva që vende të tjera të rajonit në Ballkanin Perëndimor kanë realizuar për këtë industri.

Politika fiskale këtë vit ka synuar, gjithashtu, promovimin e sportit, me qëllim rritjen e impaktit pozitiv të tij në shoqëri.

Për të orientuar dhe inkurajuar sponsorizimet e bizneseve në këtë sektor, kemi propozuar njohjen e shumave të sponsorizuara në fushën e sportit si shpenzime të zbritshme, për efekt të llogaritjes së tatimit mbi fitimin, sa trefishi i shumës së sponsorizuar. Ky ndryshim do të vlejë vetëm për personat juridikë, të cilët realizojnë fitim vjetor të tatueshëm mbi 100 milionë lekë.

Gjithashtu, kemi propozuar të rriten shpenzimet e njohura të sponsorizimit për sportin me 5% të fitimit para tatimit, nga 3% që janë aktualisht.

Një propozim tjetër, që synon tërheqjen dhe mbajtjen e investitorëve të huaj, lidhet edhe me rishikimin në rritje të afatit të mbartjes së humbjeve nga ana fiskale. Sigurisht që investimet e mëdha kërkojnë një periudhë të gjatë investimi për të kaluar në fitim dhe për këtë arsye është zgjatuar afati nga 3 në 5 vjet, sikurse është edhe praktika rajonale dhe europiane.

Pjesë e kësaj pakete është edhe trajtimi tatimor i tatimit mbi pagën për të gjithë ata individë, të cilët kanë më shumë se një pagë.

Dëshiroj të ndalem këtu, nisur edhe nga diskutimet mediatike lidhur me këtë çështje. Ne

kemi propozuar që këta individë të deklarojnë në deklaratën e tyre vjetore të të ardhurave në një shumë të vetme të gjitha të ardhurat e siguruara nga punësimi.

Do të kenë detyrim për të dorëzuar këtë deklaratë vjetore të ardhurash edhe nëse realizimi i të ardhurave të tyre është nën 2 milionë lekë.

Nuk kemi të bëjmë me vendosjen e një tatimi të ri, por ndryshimin e formës së deklarimit dhe pagesën e tatimit mbi të ardhurat, sikurse është parashikuar në ligj për të ardhurat nga punësimi.

Sistemi tatimor nuk deformohet, pasi ligji ka përcaktuar që baza e tatimit është paga, tatóhet paga bruto, pra të ardhurat totale nga paga.

Kjo masë është rekomanduar edhe nga misioni i fundit i FMN-së, i cili asistoi Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë në hartimin e paketave të përmendura.

Dy janë ndryshimet kryesore në projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”:

- Përfshirja nga TVSH-ja i automjeteve të reja vetëm me motor elektrik, me synimin për të nxitur individët dhe bizneset që të orientohen drejt blerjes së këtyre mjeteve, të cilat do të jenë më pak të dëmshme për ambientin.

- Harmonizimi i dispozitave përkatëse të ligjit “Për tatimin mbi vlerën e shtuar” në vendin tonë lidhur me faturimin dhe përcaktimet e projektligjit “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, i cili sjell një ndikim në gjithë procesin e transaksioneve.

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar”.

Ndryshimet kryesore të propozuara në këtë ligj lidhen me taksat e makinave, si ato të përdorura, edhe ato luksoze.

Kemi propozuar shtimin e dy kategorive të makinave që përfshihen nga taksa e makinave të përdorura dhe konkretisht:

Shtimin e kategorisë së personave me aftësi të kufizuar për t’u përfshiruar nga taksa vjetore e mjeteve të përdorura. Ky është një përfshirje me efekt social për këtë kategori personash në nevojë që ishte i nevojshëm. Ligji aktual

parashikon përfshirje nga taksa e makinave të përdorura për të verbrit e invalidët dhe në bazë të të dhënave janë rreth 11 mijë automjete në pronësi të kësaj kategorie.

Përfshirjen nga pagimi i taksës vjetore të mjeteve të përdorura të automjeteve të hershme me interes historik dhe koleksionimi.

Numri i mjeteve të hershme me interes historik dhe koleksionimit të vetëdeklaruarve pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor deri në këto momente është afërsisht 200 automjete.

Përfshirja nga taksa i këtyre mjeteve është një praktikë e njohur europiane dhe synon si promovimin e sektorit të mekanikës, ashtu dhe uljen e kostove të shërbimeve të këtyre mjeteve.

Këto janë ndryshimet kryesore të përcaktuara në pikat 3, 4, 5 dhe 6.

Më lejoni të ndalem të pika 7, e cila është pjesë e paketës fiskale!

Projektligjit “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit” është hartuar nga pala kontraktore në bashkëpunim me strukturat e administratës tatimore, AKSH-in dhe Ministrinë e Financave.

Ky projektligji vjen në formën e strategjisë së qeverisë shqiptare për përafrimin e legjislacionit tonë dhe atij evropian, si dhe reflekton sugjerimet dhe kërkesat që erdhën nga grupet e interesit gjatë konsultimit publik që zgjati për gati një muaj e gjysmë.

Projekti i quajtur ndryshe “projekti i fiskalizimit” bën që raportimi, monitorimi dhe mbledhja e të ardhurave të bëhet shumë më efiçente dhe të ndodhë në kohë reale.

Ndërkohë, paralelisht, administrimi tatimor dhe inspektimi zhvillohen mbi bazën e riskut dhe do të ketë mundësi që të jetë më i organizuar dhe i adresuar në kontekst të parametrave të riskut dhe metodologjive të përcaktuara në këtë drejtim.

Zakonisht iniciohen dy procese të ndara, të trajtuara në dy fusha:

Së pari, mes deklarimit të të ardhurave reale projekti i fiskalizimit realizon kryesisht ndjekjen e marrëdhënieve biznes-klient ose biznes-konsumator, duke zbatuar në kohë reale ndjekjen e të gjithë informacionit që vjen nga kasat dhe nga mjetet e tjera të informacionit, sikurse rrit efiçencën e procesit, duke synuar që në marrëdhëniet e biznesit raportimi i

detyrueshëm i të gjitha faturave të lëshuara përmes sistemit qendror dhe atyre që bëhen përmes sistemit bankar të jetë i verifikuar.

Projekti i fiskalizimit i përmban të dyja këto zgjidhje duke garantuar që informacioni të jetë i plotë, i saktë dhe të kemi mundësi ta adresojmë të gjithë informacionin në kohë reale.

Elementet kryesore të projektligjit janë raportimi në kohë reale, rikonceptimi i tarifave fiskale, raportimi në administratën tatimore i të gjitha importeve në raport me faturën, duke mundësuar kështu monitorimin në kohë reale të të gjithë zinxhirit të trajtimit të produkteve. Edhe importuesit kanë detyrim që brenda tri ditëve nga importimi i mallit të bëjnë faturë dhe ta paraqesin tek administrata tatimore.

Hapja e tregut të shoqërive të IT-së që ofrojnë fiskalizimin e faturave.

Sot kemi aktualisht 4 kompani, të cilat realizojnë fiskalizimin e faturave dhe janë ato të kasave fiskale. Ky treg, për arsye të zgjerimit, bën të mundur që tregu të zgjerohet dhe të përfshijë kompani IT-je, telekomunikacioni e të tjera dhe të mundësojnë për tatimpaguesit dhe bizneset një kosto më të ulët për projektin e fiskalizimit.

Sigurisht, ai synon inventarizim të mallrave dhe asetëve të çdo biznesi, sipërfaqen e ushtrimit të një biznesi, lejen e pronësisë apo qiradhënies, numrin e punonjësve, monitorimin e kohës së aktivitetit shitës, pra jep një bazë shumë të mirë të detajuar të të gjithë aktivitetit që mund të regjistrohet në kohë reale në sistemin e administratës tatimore.

Gjithashtu, kemi ndryshimin automatik nga sistemi i dokumenteve tatimore, si libri i shitjes, deklarata e TVSH-së, duke ndikuar njëkohësisht edhe në një miradministrim më të mirë edhe të bizneseve për materiale, të cilat sot realizohen në një mënyrë më të ndërlikuar.

Evidentimi ditor i gjendjes së arkës ka qenë gjithmonë një shqetësim, kur vjen puna e hapësirave edhe për nënraportim apo, e thënë ndryshe, “evazion”. Më qëllim uljen e këtij fenomeni, është menduar që edhe gjendja e arkës të shikohet si një element, i cili, duke u depozituar brenda një kufiri të caktuar në sistemin bankar, të zbusë sa më shumë këtë efekt të informalitetit që mund të vijë në këtë element.

Njëkohësisht, me qëllim uljen e kostove të tatimpaguesve, me numër të limituar faturash,

është përcaktuar se fiskalizimi do të ndodhë përmes një portali të veçantë, i cili ofrohet falas.

Këto përcaktohem me një vendim të posaçëm të KM-së, që do të jetë shumë shpejt për informacion për të gjitha palët.

Meqenëse sektori i hidrokarbureve ka specifika të transaksioneve për konsumatorin final, për bizneset, të cilat janë përcaktuar në këtë sektor, është caktuar që me vendim të Këshillit të Ministrave do të përcaktohet skema e monitorimit të tyre në vijim. Procesi i fiskalizimit do të zhvillohet në 3 faza:

Faza e parë janë transaksionet me para në dorë: biznes- konsumator.

Faza e dytë transaksionet pa para në dorë: biznes-qeveri. Kjo do të fillojë nga data 1 janar 2021.

Faza e tretë janë transaksionet pa para në dorë: biznes me biznes që do të fillojnë nga 1 korriku i vitit 2021.

Më lejoni t’ju njoftoj se faza e parë, e cila ka të bëjë me një marrëdhënie të drejtpërdrejtë me konsumatorin, do të ketë efektivitet të plotë pas 6- muorit të parë të vitit, duke menduar se 6 -muori është një periudhë e nevojshme, në mënyrë që i gjithë procesi të jetë i adaptuar për kërkesat e bizneseve. Por ligji do të hyjë në zbatim më 1 janar të vitit 2020 me një dispozitë kalimtare, e cila do të lejojë 6 -muorin si një kohë të mjaftueshme për të adaptuar të gjitha proceset e lidhura edhe me ndikimet e infrastrukturës *hardware* dhe *software*.

Në datën 30 korrik ky projektligj është kaluar për konsultim publik me të gjithë grupet e interesit. Ky konsultim ka qenë i gjerë për gati 6-7 javë. Është realizuar edhe një ligj më i përmirësuar falë ndikimit të të gjitha grupeve të interesit, të pyetjeve të tyre, si edhe të konsulencave, duke ndryshuar 4 nga nenet, të cilat në Komisionin e Ekonomisë janë aprovuar në parim.

Më lejoni të them se janë edhe 2 vendime të KM-së, të cilat do të jenë për aprovim në javët në vijim, që përcaktojnë kriteret e certifikimit të prodhuesve dhe mirëmbajtësve *software* për procedurën e thjeshtëzuar të fiskalizimit. Kjo VKM do të përcaktojë edhe se cilat do të jenë institucionet që do të realizojnë edhe certifikimin. Të parashikuara do të jenë Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe AKSH-i.

Ky është një proces që do të kërkojë angazhimin e shumë palëve. Është e nevojshme që jo vetëm koha, siç e thamë pak më parë në fillim të këtij diskutimi, 6 muaj të jetë i mjaftueshëm, por edhe proceset që lidhen me komunikimin, me trajnimin të jenë të mjaftueshme dhe të parashikuara sa më mirë.

Aktualisht ka filluar trajnimi në administratën tatimore dhe janë menduar të paktën 12 seanca trajnimi dhe më tej një plan komunikimi me gjitha bizneset për 6- muajin e parë, kur do të shtrihet faza e komunikimit për të gjithë çështjen e implementimit të marrëdhënies biznes-klientë.

Të nderuar deputetë, kuptohet jemi të vetëdijshëm se ky është një transformim i mënyrës sesi regjistrohen të dhënat, është një mënyrë e re që do sjellë jo vetëm nevojën për komunikim, por edhe për sqarim. Është e rëndësishme të shikojmë objektivin afatmesëm të këtij projektligji, i cili synon jo vetëm realizimin në kohë reale të informacionit, por, mbi të gjitha, synon që të dhënat në administratën tatimore të jenë të plota, të jenë në kohë reale dhe, mbi të gjitha, administrata tatimore të riorganizohet në një administratë tatimore moderne dhe të synojë jo vetëm përpjekjen për të reduktuar informalitetin, por edhe për ta luftuar atë në mënyrë inteligjente në të ardhmen.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zonja Ministre!

Fjalën e ka kryetari i Komisionit për Ekonominë dhe Financat, zoti Ahmetaj.

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar deputetë,

Seanca e sotme e parlamentit, siç e theksuat edhe ju, zoti Kryetar, vjen pas një ngjarjeje të jashtëzakonshme, tragjike me humbje jete të qytetarëve, me dëmtime të pronave, me shkatërrim të pasurive të paluajtshme dhe me trauma psikologjike jo vetëm në zonat që janë dëmtuar nga tërmeti, por në të gjithë Shqipërinë. Solidariteti ishte. Është emocioni dhe detyrimi i parë që ne kemi si parlament, si qytetarë dhe si një trupë që do të duhet të ndërtojme përgjigjen për këtë situatë të jashtëzakonshme. Në këto situata përgjigja nuk mund të jetë e zakonshme. Nuk mund të jetë si çdo herë që vijmë në parlament për të hartuar,

për të debatuar dhe për të votuar buxhetin e shtetit, duke folur për parametrat fiskalë, natyrshëm që janë të rëndësishëm, por sot duhet të flasim se si përgjigjet kjo maxhorancë, kjo qeveri ndaj një ngjarjeje të jashtëzakonshme.

Unë dua të ndaj me ju se maxhoranca ka vendosur t'i përgjigjet kësaj ngjarjeje të jashtëzakonshme me instrumente të forta të jashtëzakonshme, të cilat në themel kanë moton e Kryeministrit, të qeverisë, të kësaj maxhorance që ne nuk lëmë askënd mbrapa.

Në diskutimin për ligjin dua të përmend edhe atë kujdes financiar që qeveria, maxhoranca, Kryeministri treguan edhe në një ditë të vështirë si kjo, ku e gjithë bota solidarizohet me ne, ku qytetarët shqiptarë kanë kontribuar me mijëra në portalin *e-Albania*, deri dje ishin 54 milionë lekë, dikush mund të thotë se janë pak, dikush se janë shumë, por unë po ju them se 54 milionë lekë nga mbi 5300 qytetarë shqiptarë janë shumë, se nuk kanë hequr nga tepricat, por kanë hequr bukën e gojës për të ndarë dhimbjen dhe për t'u bashkuar me solidaritetin me të gjithë ata qytetarë që janë duke vuajtur direkt pasojat e tërmetit.

Cila ishte përgjigja e menjëhershme e qeverisë dhe e Kryeministrit? U krijua grupi i emergjencës me në krye ministrin e Bujqësisë, zotin Çuçi, të cilin gjej rastin ta falënderoj edhe në emër të Komisionit të Ekonomisë edhe të Grupit Parlamentar për punën e palodhur të tij dhe të shtabeve të tij 24 orë, por edhe të gjithë qeverinë, të gjithë ministrat, ministrin Klosi në veçanti, për qëndrimin afër prej 2 vjetësh në të gjithë sektorët e turizmit. Çdokush do të mendonte: "Po, është çështje numrash turizmi". Një ditë i gjithë ai kujdes prej 2 vjetësh vlejti për solidaritetin. E gjithë industria e turizmit u përgjigj për të strehuar 4 mijë qytetarë, pa pasur akoma një angazhim kontraktual apo financiar nga qeveria, që në datën 27, sepse angazhimi financiar kontraktual i qeverisë erdhi me vendimet e qeverisë 4 ditë më vonë.

Na jepet rasti të falënderojmë të gjithë ato njësi të shpëtimit shqiptar nga të gjitha institucionet që treguan heroizëm, me gjithë mungesën e mjeteve, duhet ta pranojmë, krahasimisht me të gjitha njësitë e huaja që u solidarizuan dhe na ndihmuan.

Vijmë te buxheti. Nuk do të rrisim asnjë taksë. Në mënyrë direkte nuk do të rrisim as borxhin, por do t'i përgjigjemi në dinamikë duke filluar që nga 1 janari me programin specifik të detajuar, të ndërtuar nga vetë Kryeministri me ndihmën e Komisionit të Ekonomisë dhe me një punë të detajuar me Ministren e Financave për të arritur atë që sot prezantohet si programi i rindërtimit. Siç e theksova, është dinamik, nuk ka rritje të taksave dhe që ditën e parë fillon me gati 200 milionë dollarë.

Jemi duke filluar me një mbështetje të kalkular nga ana jonë në 7 miliardë lekë, 70 milionë dollarë nga donatorët. Të jeni të bindur se mbështetja nga donatorët do të shkojë mbi 150 milionë euro.

Shumë shpejt do të ketë një konferencë donatorësh të iniciuar nga Komisioni European, ku vendet e BE-së dhe jo vetëm do të deklarohen për mbështetje në shenjë solidariteti, për mbështetjeje financiare. Ju e dëgjuat dje Komisionin, ju e dëgjuat dje fjalën e Kryeministrit në samitin e NATO-s, ju e keni parë deklaratën e samitit të NATO-s dje, ku në një nga paragrafët thuhej: "Solidarizimi me popullin shqiptar në një ditë të vështirë tragjike si ajo e 26 nëntorit". Ky është buxheti. Mund të futemi në detaje, thelbi i buxhetit është ky:

1. Ka një program të rëndësishëm rindërtimi që do të fokusohet te ndërtimi i banesave në Tiranë, në Durrës, në Thumanë, në Lezhë apo edhe diku tjetër ku janë dëmtuar apartamentet, pallatet apo banesat.

Në të njëjtën kohë, paralel me këtë gjë, do të ketë një politikë të tërë strehimi për të gjithë ata që kanë nevojë për strehim afatgjatë, duke filluar që nga ekobanesat në fshat dhe deri te bonusi i qirasë që në fillësë në buxhet është 1 miliard lekë.

Dua të ndaj me qytetarët shqiptarë se kostoja sot e akomodimit nëpër hotele është rreth 2,4 milionë dollarë në muaj, që përballohet nga qeveria. Të mos harrojmë se qeveria, Kryeministri, ministri për Turizmin, ministrja për Financën po mendojnë akomodimin sa më shpejt të qytetarëve nga hotelet në apartamente, mundësisht më të mëdha, më të qenësishme, për t'i lënë gjithashtu frymëmarrje edhe industrisë së turizmit, sepse rritja ekonomike duhet të vazhdojë. Pikë së pari duhet që shoqëria

shqiptare, të gjithë ne për 1-2 muaj duhet ta kemi kaluar traumën psikologjike, traumën e rëndë që pësuam nga tragjedia. Ata që kanë humbur të dashurit e tyre dhe pronën do ta kenë vuajtjen tërë jetën, por ne duhet të fokusohemi te zhdukja e pasojave, moslënia e çdo qytetari mbrapa, rindërtimi i vendit, i atyre zonave që u shkatërruan nga tërmeti dhe te rritja e ekonomike. Pse e theksoj rritjen ekonomike? Ky buxhet që kalojmë sot, nuk preket, nuk ulet, nuk cenohen shërbime, nuk cenohen pagat, nuk cenohen pensionet, zero. Nuk cenohet asnjë shërbim publik, asnjë investim publik, asnjë pagë, asnjë pension, asnjë subvencion për njerëzit në nevojë, zero. Përkundrazi, ndjekin ritmin vjetor të rritjes.

2. Programi i rindërtimit fillon me një shumë dinjitoze që fton kontributin e donatorëve. Të jeni të bindur se deri në mesin e vitit do të kemi të paktën edhe 150 milionë euro, siç e theksova, kontribute nga donatorët.

3. Nuk e rrit direkt borxhin, pra ajo që kemi thënë dikur që quhet balanca primare, që për qytetarët dua ta shpjegoj është se sa e rrit qeveria borxhin me operacionet korrente. Qeveria nuk e rrit borxhin me operacionet korrente. Ai element teknik, që është shumë i rëndësishëm dhe tregon përgjegjshmërinë e një qeverie, përsëri është pozitiv edhe në një ditë të vështirë.

Të nderuar qytetarë, e dini që vendet e pasura si: Japonia, SHBA-ja apo çdo vend european kur kanë pasur fatkeqësi të kësaj natyre, shpenzimet u kanë kërcyer me 3-4% të GDP-së? E dini se çfarë do të thonë këta parametra të buxhetit? Sërish qëndrojmë në nivele shumë të kontrolluara të deficitit tradicional që sjell qeveria, është vetëm 1,6%. Ne këtu në Kuvend, bashkë me qeverinë dhe Kryeministrin, do të vendosim sot paketën, e cila e çon deficitin në 2,2. Po të doni shembuj nga uragani Kaltrina, po ju them se janë gati 200 miliardë dollarë, po të doni shembull, jo shumë larg, po nga Serbia, në momentin që u përmyt i kërcëu deficiti është nga 2 në 5 minus.

Shtylla tjetër e buxhetit: nuk cenohen pagat, pensionet, investimet, nuk cenohet mbështetja për qytetarët në nevojë, nuk cenohet asnjë shërbim publik, nuk lihet asnjë qytetar mbrapa nëpërmjet programit të rindërtimit me atë 200 milionësh, i cili në dinamikë do të rritet dhe, në

të njëjtën kohë, nuk rrisim taksat, nuk cenojmë rritjen e pensioneve me atë 2,5 miliardë lekësh, që kemi planifikuar, nuk cenojmë investimet në qendrat shëndetësore, në shkolla e në rrugë. I gjithë programi i qeverisë do të vazhdojë të ndiqet nga institucionet përkatëse, për të plotësuar nevojat që kemi për infrastrukturë dhe për shërbime, si dhe për të furnizuar rritjen ekonomike.

Në të njëjtën kohë dua të theksoj se institucionet e mbledhjes së të ardhurave kanë detyrë specifike patriotike, përtej asaj së zakonshmes, që në mënyrë gati perfekte të mos humbasim asnjë të ardhur vitin tjetër, me qëllim që të kemi mundësi të përmbushim sa më mirë moton e Kryeministrit, të kësaj qeverie dhe të kësaj maxhorance që ne nuk lëmë askënd mbrapa.

Dikush më pyeti: sa do të zgjasë rindërtimi? Ky është një diskutim që besoj se do të vijojë gjatë këto ditë, por unë jam i bindur se qeveria është e angazhuar 24 orë në 7 ditët e javës dhe me fillimin e rindërtimit besoj se brenda vitit 2020 do të kemi mbyllur një pjesë shumë të madhe të punëve të rindërtimit. Deri në Krishtlindjet e vitit 2019 do të jenë pastruar të gjitha rrënojat dhe kujtesa traumatike nga tërmeti. Kurse në Krishtlindjet e vitit 2020, 80-90% e qytetarëve do të jenë futur në shtëpitë e tyre të reja, të rindërtuara nga projekti i rindërtimit të vendit, i iniciuar dhe i detajuar nga Kryeministri, nga qeveria dhe nga parlamenti.

Unë jam i bindur që në një ditë të rëndë dhe të jashtëzakonshme si kjo, se kjo është përgjigja e parë e Kuvendit, me këto instrumente të jashtëzakonshme ne do t'ia dalim të fshijmë nga kujtesa dhe nga terreni gjithë atë traumë sociale, jetësore dhe ekonomike. Në krye të një muaji e gjysmë apo dy të riinjektojmë pozitivitetin shoqëror dhe ekonomik përmes solidaritetit dhe paketës shumë të rëndësishme për rindërtim. Jam i bindur që, me gjithë rezervat që mund të ketë opozita në traditën e vet për buxhetin e shtetit, këtë radhë do ta votojë me ne programin e rindërtimit, për t'u bashkuar në solidaritet me ata qytetarë që kanë vuajtur dhe vuajnë, me solidaritetin e shoqërisë shqiptare për të kaluar këtë moment të vështirë, ku nuk ka vend për politikë, por për solidaritet, për përgjegjshmëri dhe për punën e institucioneve 24 orë.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Janë regjistruar për të diskutuar: Elisa Spiropali, Elva Margariti, Belinda Balluku, Besa Shahini, Ogerta Manastirliu, Taulant Balla, Blendi Klosi. Në emër të Grupit Parlamentar të PS-së, Ervin Bushati, nga Grupi Demokrat: Rudina Hajdari, Myslim Murrizi, Korab Lita dhe Fatjona Dhimitri, nga Grupi i Pavarur: Edlira Hyseni, Enver Roshi, Nimet Musaj dhe Ralf Gjoni. Nga deputetët jashtë grupeve parlamentare janë regjistruar: Lefter Maliqi, Kostaq Papa, Kujtim Gjuzi, Zef Shtjefni, Artur Roshi, Erion Piciri dhe Vasil Sterjovski.

Fjalën e ka Rudina Hajdari.

Të përgatitet Elisa Spiropali.

Rudina Hajdari – Shumë të dashur qytetarë,

Ndërsa ky vit po mbyllet, mund të them me një pikëllim të thellë si nënë, si grua, si motër, si bashkëqytetare, se është një ndër vitet më të vështira që ka përjetuar Shqipëria në dekadat e fundit. Tërmeti i 26 nëntorit na kapi të papërgatitur dhe të paditur se çfarë pasojash katastrofike do të kishte për vendin tonë.

Më lejoni të shpreh, si fillim, ngushëllimet më të thella për familjarët e prekur nga kjo tragjedi dhe për njerëzit e dashur që ata humbën në këtë goditje të rëndë që iu bë vendit tonë. Dua, gjithashtu, t'u uroj shërim të shpejtë të gjithë të lënduarve dhe t'u them se ata janë në zemrat e mendjet tona në çdo moment. Dua të shpreh mirënjohjen time të thellë për çdo vullnetar që doli në zonat e prekura që në momentin e parë, duke ofruar ndihmë, përfshirë edhe doktorët, infermierët dhe çdo qytetar të thjeshtë. Ju treguat një ndjenjë të pashembullt solidariteti për njëri-tjetrin dhe kjo nuk është pak.

Dua të shpreh mirënjohjen time të thellë për forcat e sigurisë, për njësitë operacionale të policisë, për ekipet e emergjencës, veçanërisht për njësitë operacionale të Kosovës, që u ndodhën që në momentin e parë, po ashtu edhe për vendet tona fqinje: Greqinë, Italinë, Serbinë dhe për të gjithë ata që iu bashkuar operacioneve të kërkimit dhe shpëtimit.

Ju nuk reshtët deri në momentin e fundit duke bërë të pamundurën për të nxjerrë bashkëqytetarët tanë nga gërmadhat.

Gjithashtu, dua të falënderoj edhe medien e gazetarët, edhe këdo, që vërtet u bashkua me dorë në zemër për t'i dhënë transparencë situatës dhe u gjenden pranë familjarëve.

Dua t'ju falënderoj të gjithëve ju dhe çdo shqiptar e donator, brenda dhe jashtë vendit, që treguan një gatishmëri të lartë dhe sakrificë të pakursyera gjatë kësaj kohe të vështirë. Nuk ka vlerësim më të lartë e më të thellë solidariteti e humanizmi që treguam ne si popull, një model frymëzimi për të gjithë, sepse ne treguam vlerat e popullit shqiptar, zemërgjerësinë tonë dhe faktin që i gjendemi pranë njëri-tjetrit në momentet më të vështira.

Të gjithë shqiptarët kudo, u bënë bashkë për të përballuar pasojat katastrofike që shkaktoi tërmeti shkatërrimtar i 26 nëntorit. Në këtë betejë, tashmë me një bilanc të rëndë njerëzor, Shqipëria nuk mbeti e vetme, se shumë vende mike dhe partnere na u gjendën pranë dhe treguan se shqiptarët janë ata që e bëjnë Shqipërinë, janë ata që e duan Shqipërinë dhe kjo ndihmë që u tregua nga aleatët tanë, nuk ishte për elitën politike, por ishte pikërisht për shqiptarët.

Do t'ju jemi gjithmonë mirënjohës! Puna dhe solidariteti juaj nuk ka për t'u harruar kurrë! Është e vërtetë se tërmeti i 26 nëntorit tundi fort, si asnjëherë më parë, themelet e mijëra e mijëra ndërtesave në Shqipëri, madje i rrëzoi shumë prej tyre, por është po kaq e vërtetë se ai provoi se themelet njerëzore janë të pakufishme si këtu me njëri-tjetrin, ashtu edhe jashtë kufijve.

Sot jemi mbledhur për të diskutuar edhe për masat që duhen marrë tani e tutje.

Si fillim, buxheti i 2020-s duhet të rishikohet për përballimin e pasojave të rënda, të parashikohet planifikimi dhe mbështetja e domosdoshme për ta përballuar këtë situatë.

Së dyti, duhet bërë inspektimi i të gjitha ndërtesave të prekura dhe të mos lejohet shembja e tyre pa u bërë hetimi i plotë për çdo ndërtesë, që përbën provë për një hetim penal. Po ashtu, rindërtimi i banesave dhe rikuperimi njerëzor duhet të fillojë sa më shpejt, në mënyrë që të fillojë shërimi i kësaj plage të madhe shoqërore. Patjetër, tani e tutje, duhen marrë të gjitha masat për plotësimin e legjislacionit të planifikimit urban me elemente të reja sigurie, sipas procedurave bashkëkohore, në projektimin dhe ndërtimin e objekteve të ndërtimit, si dhe për

ngritjen e kapaciteteve të emergjencave civile me standarde të larta bashkëkohore.

Pasojat e tërmetit nuk përmbyllen në një ditë, pasi vuajtja dhe trauma do të vazhdojnë për një kohë shumë të gjatë.

Ajo që mund të bëjmë ne si politikanë është të ndihmojmë këdo që është prekur nga dhe t'u qëndrojmë pranë qytetarëve. Sot ka ende nevojë për ushqime, për strehim, për ngrohje, për batanije, për veshmbathje e për pajisje të ndryshme, për ata që po kalojnë kohë të vështira në këto ditë të ftohta dimri. Pavarësisht se ka pasur kontribute financiare të konsiderueshme, ende nuk po shikohet që kjo ndihmë materiale të ketë ardhur në shërbim të barabartë për të prekurit. Ka ende kërkesa për të strehuar familje dhe mundësi për të kontribuar me ushqime dhe materiale jetike për familjet në zonat e prekura.

Më lejoni të theksoj se kanë qenë pikërisht kontributet vullnetare, të cilat kanë ardhur si ndihmë e parë për qytetarët e prekur, mbështetësit kryesorë të kësaj fatkeqësie katastrofike.

Ndihem e revoltuar dhe shumë e shqetësuar për situatën, pasi ka ende mijëra familje të lëna në mëshirë të fatit, në harresë totale, pa ndihma, pa çadra dhe nuk janë bërë ende vlerësimet e objekteve.

I bëj thirrje kujtdo që mund të kontribuojë, që të kontribuojë pranë qendrave ku ka më pak ndihma dhe ndihmat të mos centralizohen vetëm në një zonë të caktuar, por të shpërndahen edhe në zonat më pak të prekura apo të mbuluara nga mediet, si: në Manëz, në Bubq, në Sukth, në Ishëm etj.

Nuk duhet të lëmë asnjë në rrugë dhe asnjë fshat pa prekur, ku ndodhen qytetarë të dalë nga banesat e tyre. Gjëja e parë që kërkojnë qytetarët është përsheptimi i procesit të vlerësimit të banesave, ndaj duhet që t'i kërkojmë qeverisë të vërë në dispozicion të gjithë inxhinierët për të ndihmuar inspektimin.

Theksoj se shembja e shpejtë e objekteve është një akt kriminal. Çdo objekt përbën provë materiale për hetime penale. Janë 51 jetë njerëzish, qindra të plagosur dhe mijëra të traumatizuar. Kjo situatë nuk do të tolerohet të kalojë pa u mbajtur përgjegjësitë. Do të ishte po aq kriminale që të mos tregohemi të sinqertë dhe transparentë. Qeveria nuk mund ta anashkalojë transparencën këtë herë.

Përgjegjësia para drejtësisë për ata që kanë ndërtuar kundër ligjit është e domosdoshme.

Transparenca, sa është dëmi në tërësi, sa është dëmi në zonat më të goditura, sa është dëmi shtëpi më shtëpi, është e domosdoshme dhe determinuese për mënyrën se si do të përballohet kjo situatë.

Prandaj, meqenëse jemi në procesin e rishikimit të buxhetit dhe në gjendjen e fatkeqësisë natyrore, duhen përdorur të gjitha fuqitë që jep ligji, duke filluar nga anulimi i kontratave koncensionare dhe fokusimi tek inspektimi i dëmit në çdo fshat e qytet. Duhet të bëjmë ç'është e mundur për t'iu gjendur pranë qytetarëve dhe të lëmë metodat e vjetra të propagandës.

Këtë herë nuk ka më kohë dhe njerëzit nuk do të kenë më mëshirë për ata që do të abuzojnë më këtë situatë. Historia do t'i marrë me vete të gjithë abuzuesit dhe ata që do të vjedhin në kurriz të shqiptarëve.

Duhet të jemi në krye të detyrës dhe qeveria duhet të jetë e përgjegjshme për të mirën e gjithë popullit shqiptar. Nuk pret më koha që të politizojmë çdo gjë dhe të merremi me fjalë e sofizma. Sot nuk ka më kohë për fjalë, por vetëm për vepra. (*Bie gongu.*)

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zonja Hajdari!

Fjala është për deputeten Edlira Hyseni.

Të përgatitet zonja Spiropali.

Edlira Hyseni – Përshëndetje!

Do të përpiqem të jem racionale, por nuk është e thjeshtë.

Nuk kam përgatitur asgjë. I flas... Sot jam politikane, kam një status deputeti, por jam qytetare e Durrësit.

Të flasim për buxhetin, do të ishte më kollaj. Isha përgatitur për buxhetin në draftin e parë. Kishim parë shifra, kishim analizuar dhe sot do ta miratojmë në parim. Mendoj se do të jetë një buxhet që do të rishikohet. Unë nuk e di nëse jemi dakord në parim (pse të mos jemi), por mendoj se ky buxhet ka vend për t'u riparë, sepse kanë dalë emergjenca të tjera dhe jemi në një situatë ndryshe.

A do të ndryshojë e ardhmja që presim? I kishim ndryshe planet, por tani besoj se të gjithë jemi përshtatur me situatën e re.

Durrësi, Thumana dhe vendet përreth, Laçi, Lezha, Kamza e të tjerë kanë përjetuar një ndër

momentet më të vështira në jetën e të gjithëve ne dhe të brezave që kanë qenë më parë. Jemi akoma të trembur, të emocionuar dhe të pasigurt.

Është e vërtetë që duhet pasur kujdes për të mos përhapur panik. Mediet duhet të jenë të kujdesshme.

Unë i falënderoj mediet, sepse kanë dhënë informacion dhe në shumë raste edhe na kanë ndihmuar të marrim vendimet e duhura!

Në medie kemi parë disa specialistë të shkëlqyer. Zonja e nderuar, Luljeta Bozo, më ka qetësuar dhe më ka bërë të fle gjumë më shumë se shumë të tjerë. Kështu që mendoj se media bën një punë të shkëlqyer. Pa dyshim, duhet pasur kujdes me panikun, sepse jo të gjithë jemi të fortë.

Thonë se politikanët apo drejtuesit duhet të kalojnë një test stresi. Unë nuk do ta kisha kaluar. Nuk e di, mbase nuk jam politikane, jam qytetare, por jam edhe prind, jam nënë, jam vajzë e prindërve të moshuar. Të gjithë në këtë situatë patëm emergjencën të kujdeseshim për jetën tonë, të familjarëve, të qytetarëve dhe të gjithë njerëzve që na rrethojnë.

Në orën 04:00 të gjithë kemi marrë telefonat dhe kemi telefonuar njëri-tjetrin për të pyetur si jemi. Nuk kishte përkatësi politike, nuk kishte fare rendësi nëse ishte i djathtë apo i majtë. Ishim të gjithë bashkë dhe të gjithë ishim të trembur.

Pati dëme, pati humbje në njerëz. Pati edhe mrekulli. Zoti bëri edhe mrekulli. Shumë njerëz shpëtuan. Ka dëme materiale pa fund. Njerëzit kanë humbur banesat e tyre. Vazhdojnë të shemben pallate. Njerëzit nuk e dinë se çfarë do të bëjnë nesër. Njerëzit humbën shumë, humbën në të gjitha drejtimet.

Sot Durrësi ka nevojë të rigjejë besimin. Kemi nevojë të besojmë se Durrësi, që sot është ulur në gjunjë, do të ngrihet në këmbë, sepse i ka mundësitë për ta bërë këtë. Forcën e madhe duhet ta gjejim te vetja. Jemi ne ata që duhet t'i japim forcë njëri-tjetrit dhe të themi se do t'ia dalim, por Durrësi ka nevojë për një shtet, për një qeveri që do t'i përgjigjet. Është kjo qeveri sot, e cila duhet të përgjigjet me një plan konkret, të përgjigjet me zemër.

Do të doja që testi i stresit, që duhet të kalojnë politikanët dhe drejtuesit, të ishte një test dashurie. Ka nevojë për dashuri. Ka nevojë që ai komitet, që ka marrë përsipër të bëjë rindërtimin

e Durrësit dhe të gjitha zonave të prekura, ta bëjë këtë me dashuri e ndershmëri.

Unë dua të besoj se nuk do të preket asnjë lek që do të shkojë për ata njerëz, që kanë nevojë për to dhe i presin. Dua të besoj se kjo qeveri do ta bëjë këtë herë punën, ashtu siç nuk e ka bërë asnjë qeveri tjetër në 30 vjet.

Pa dyshim, ka nevojë edhe për të gjetur drejtësi, për të parë se cilët kanë qenë fajtorët, nëse ka. Institucionet do të bëjnë punën e tyre, por prioritet është rikthimi i njerëzve në normalitet, që fëmijët të kthehen në shkolla, që gratë të ridalin dhe të rinisin një jetë normale.

Kemi nevojë të besojmë se Durrësi dhe të gjitha zonat e prekura do t'ia dalin. Për këtë na duhet një qeveri e fortë.

Në komitetin e rindërtimit janë të gjithë ministrat. Unë do t'u lutesha... Ministrja e Infrastrukturës do të punojë për ta rindërtuar Durrësin më mirë se ç'kanë bërë të gjithë ata para jush. Shkollat në Durrës kanë pasur nevojë për rikonstruksion. Shumë shkolla janë të dëmtuara. Prindërit kanë frikë t'i rikthejnë fëmijët në shkolla (mbase fëmijët kuptojnë më pak), por është koha që të gjitha godinat arsimore të rishikohen dhe të ribëhen të forta.

Me këtë rast Durrësi ka nevojë të rindërtohet. Edhe ministrja e Kulturës duhet të shohë të gjitha gjërat që nuk janë parë vitet e fundit për sa i përket trashëgimisë kulturore.

Kanë rënë pallate që janë ndërtuar 10-vjeçarim e fundit. Është e pakuptueshme! Është e rëndë! Duhet të gjendet pse ka ndodhur kjo dhe nuk duhet të përsëriten gabime.

Sot kemi nevojë të besojmë. Besimin do ta gjejmë duke iu lutur Zotit, duke besuar te njëritjetri, do ta gjejmë te familja, te dashuria, por kemi nevojë të besojmë edhe te qeveria.

Prandaj, ju lutem, nëse politika e këtyre 30 vjetëve na ka zhgënjyer, na ka preokupuar, na ka dëmtuar në mënyra nga më të ndryshmet, ju sot keni mundësinë të bëni diçka të mirë jo vetëm për Durrësin dhe zonat e prekura, por për të gjithë shqiptarët, për t'u treguar se ka një të ardhme, që mund të jetë më e mirë dhe këtë herë bëjeni me zemër, mos e bëni as për lekë e as për...

Unë nuk e di se cilat janë motivet që i bëjnë njerëzit të luftojnë, por unë shpresoj mirëqenia.

Unë dua të falënderoj ata që u solidarizuan! Shqipëria e bukur ekziston! Njerëzit janë shumë të mirë!

Është koha që edhe politika të tregojë se është ashtu si të gjithë shqiptarët, si Shqipëria e bukur, që ka zemër, ka dashuri dhe Durrësin e të gjitha zonat do t'i ngrejë në këmbë sërish e sërish dhe do të jemi të gjithë më mirë!

Ju faleminderit!

Gramoz Ruçi - Faleminderit, zonja Hyseni!

Fjala është për Elisa Spiropalin.

Të përgatitet Korab Lita.

Elisa Spiropali – Të nderuar kolegë,

Të dashur qytetarë,

“Shpëtimi nuk gjendet lart në qiellin kombëtar, por fshehur fort dhe thellë në shpirtin kombëtar”, thoshte Branko Merxhani, mendimtar i shquar shqiptar. “Ja, pikënisja, të ndriçojmë shkaqet e thella të anarkisë sonë shoqërore, që na la trashëgim e shkuara, me fenerin e së ardhmes. Ja, pika e drejtimit tonë, përmbi gërmadhat e shqiptarisë të ngrihemi dhe të mbërrijmë për një Shqipëri të nesërme, të ndritur, jo historike, por qytetronjëse”, thotë ai.

Sot nuk e kam aspak të lehtë të flas në këtë foltore, kur ende nuk është zhbërë, dhe besoj se do të jetë e vështirë të zhbëhet, hija e dhimbjes së madhe të tërmetit të 26 nëntorit, një fatkeqësi natyrore, që e liga e desh të çirrej edhe me fatkeqësi njerëzore.

51 jetë të humbura, gra, fëmijë, burra e të moshuar, që do t'i kujtojmë si portrete në zemrat e mendjet tona, në rrokullimën e përditshme!

1 mijë të plagosur, mijëra të pastrehë, 5000 ndërtesa e banesa të shkatërruara, çaste që të mbërthenin, aq sa duhet të prisje deri në pafundësi, derisa të dëgjoje nga mesi i gërmadhave lajmin se në këtë shtëpi ka jetë, ai/ ajo shpëtoi, ky fëmijë doli, e deri te momentet më therëse, kur një jetë flijohej për të shpëtuar një tjetër jetë, si e moshuara nga Thumana, që i bekoj jetën për së dyti nipit, duke e mbajtur në prehrin e saj dhe duke e shtrënguar fort mes krahësh!

Sigurisht, jo të gjithë mbërritën t'i shpëtojnë fëmijët dhe të afërmit e tyre, prandaj të gjithë përjetuam orë tmerri.

Ora jonë nuk duhet të mbetet në ato momente, por duhet të ecë para.

Sërish po i referohem Branko Merxhanit, që, në fakt, i referohet një tjetër mendimtar, Niçes, i cili thotë: “Çdo popull që të rrojë dhe të tregojë veten, në radhë të parë, duhet të organizojë kaosin, që gjendet brenda unit të tij dhe të vërë rend”.

Duke mos qëndruar në këtë gjendje ankthi, duhet të flasim për shpirtin e pamposhtur shqiptar të treguar këtë javë me prova. Jo vetëm institucionet shtetërore u angazhuan të gjitha pa përjashtim për përbalimin e kësaj situatë të fatkeqësisë natyrore (të gjithë në këmbë), por edhe shpirti kombëtar u ngrit, u solidarizua e u bashkua, për të na treguar që ne mund të ngremë nga gërmadhat dhe rrënojat një mundësi e një vizion për të ardhmen. Ky është synimi ynë.

Mbi 2 mijë efektivë të Forcave të Armatosura ishin në gatishmëri që në momentet e para, por edhe miqtë tanë, vëllezërit tanë nga Kosova, të parët iu përgjigjën, jo detyrës, por ndjenjës së tyre kombëtare. Kjo fatkeqësi dukej sikur na kishte rënë të gjithëve bashkë dhe ata ishin të parët që mbajtën peshën e kësaj gjëme. Patjetër, ishin edhe miqtë tanë nga Italia, Greqia, Mali i Zi, Serbia, Kroacia, Franca, Turqia, Zvicra, Rumania, Maqedonia e Veriut, BE-ja, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe forcat e Izraelit, të cilët, në fakt, erdhën pa lajmëruar, duke na kujtuar edhe lidhjen e hershme që kemi që nga Lufta e Dytë Botërore. I vetmi vend në Europë që kishte më shumë hebrenj në përfundim të luftës se në fillim të saj! Duket sikur gjithçka kthehet në fund.

Tani që flasim, të gjitha Forcat e Armatosura janë mobilizuar në terren, së bashku me mijëra mjekë, infermierë, zjarrfikës, punonjës të pushtetit lokal dhe të emergjencave civile, të cilët po menaxhojnë situatën, jo vetëm duke bërë evakuimin e banorëve apo kërkim-shpëtimin në çastet e para, por edhe sistemimin e tyre nëpër çadra.

Janë bërë më shumë se 3 mijë vizita mjekësore e trajtime mjekësore, që janë kryer nga ekipet e posaçme mjekësore për qytetarët e prekur nga tërmeti.

Gjejmë rastin të falënderojmë vullnetarët, qytetarët e thjeshtë, që u janë bashkuar këtyre ekipeve për ndihmë ndaj banorëve!

Institucionet publike kanë përgatitur një sërë masash organizative dhe administrative për përbalimin e gjendjes së fatkeqësisë natyrore

dhe, pa dyshim, buxheti dhe të gjitha aktet që ka miratuar qeveria, synojnë një plan tërësor masash, jo vetëm për emergjencën, por edhe për të ardhmen e këtyre familjeve, duke nisur, së pari, nga familjet që kanë humbur njerëzit e tyre si pasojë e tërmetit.

Këshilli i Ministrave miratoi akte normative pas një analize të imtësishme të situatës, si dhe para për dhurimin e apartamenteve për familjet që kanë humbur të afërmit e tyre nga tërmeti.

Të gjithë familjarëve që kanë pasur viktima në familje, do t'u akordohet një përkrahje financiare prej 1 milion lekësh. Do të përfitojnë bursë në masën 15 mijë lekë në muaj të gjithë studentët dhe fëmijët deri në moshën universitare që kanë humbur familjarët e tyre në Durrës, Tiranë, Lezhë apo kudo tjetër. Të gjithë atyre personave që u janë shkatërruar banesat apo u janë shpallur si të pabanueshme, do të akomodohen në mjedise, si fillim nëpër hotele dhe më vonë nëpër apartamente. Do të trajtohen me ndihmë financiare të posaçme gjithë të moshuarit e familjeve të mbijetuara. Këto janë disa nga aktet e para që qeveria i pa si të arsyeshme t'i miratojë për t'u ardhur në ndihmë të menjëhershme familjarëve.

Projekti i rindërtimit është më pas një çështje shumë më e gjerë, që parashikon një vizion tonin për t'i ndryshuar këto qytete. Nuk kemi ndër mend të bëjmë arrime nëpër pallate apo të krijojmë geto për familjet, të cilat kanë mbetur të pastreha, por do të bëjmë lagje të tëra në Durrës, në Tiranë, si dhe në zonat e tjera të prekura nga tërmeti si Lezha dhe Laçi, të cilat kanë gjithë infrastrukturën e një qendre urbane, si: qendra shëndetësore, shkolla, parqe e kështu me radhë, në mënyrë që këtë fatkeqësi ta kthejmë në një mundësi për të pasur një zhvillim më të qëndrueshëm në të ardhmen.

Duhet bërë një analizë për mënyrën se si është ndërtuar, patjetër për të gjetur edhe faktorë aty ku ka, për pasojat e këtij tërmeti, por edhe për projektin e rindërtimit dhe për të vënë në funksion Komitetin, i cili përbëhet jo vetëm nga anëtarë të qeverisë, por edhe nga shoqata, biznese, banka, inxhinierë, pedagogë e kështu me radhë, si edhe partnerët tanë, të cilët janë ofruar për të qenë pjesë jo vetëm e Komunitetit, por edhe me donacione të rëndësishme, siç ishin ofertat e Bashkimit Europian apo të miqve të

tjera si Franca, Holanda e kështu me radhë, për të ndërtuar disa modele zhvillimi.

Së bashku me ministrin Majko dje ishim në Holandë, pikërisht për këtë çështje dhe ata na treguan një histori që ishte shumë kuptimplotë, e cila i dallon vendet që tragjeditë i kthejnë në përparësi apo krizat i kthejnë në mundësi. Në vitin 1953 një pjesë e mirë e territorit të Holandës u përmyt dhe kjo gjë solli 1900 të vdekur dhe 48 mijë banesa të shkatërruara plotësisht, pamje apokaliptike të gjësë së gjallë të vrarë e kështu me radhë. Holanda vendosi të mos e ulte kokën dhe ta pranonte fatin e saj në një situatë permanente krize, duke vendosur të ngrihej. Tashmë Holanda është vendi numër një në Europë sa i takon inxhinierisë së ndërtimit të digave dhe të të gjitha mjeteve mbrojtëse.

Sigurisht ne kemi më pak mundësi dhe resurse, por nuk na mungon aspak shpirti i solidaritetit, madje këto ditë nuk na ka munguar as fryma e bashkëpunimit, të cilën e kemi gjetur jo vetëm te politika, por edhe te qytetarët, të cilët kanë një dëshirë të madhe për t'u ringritur. Është kjo dëshirë për ripërtëritje, për të vendosur rend në kaosin që na ra mbi kokë nga tërmeti, gjë që më jep mua shpresë se ato jetë të humbura, por edhe ato familje të shkatërruara do të dijnë t'i mbijetojnë...

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zonja Spiropali!

Fjalën e ka Korab Lita.

Të përgatitet Belinda Balluku.

Korab Lita – Të nderuar kolegë,

Fillimisht dua t'u shpreh ngushëllimet e mia të sinqerta të gjithë atyre që humbën të dashurit e zemrës dhe t'u uroj shërim të shpejtë të gjithë bashkëqytetarëve që u lënduan nga ngjarja e 26 nëntorit! Po ashtu t'u shpreh angazhimin dhe solidaritetin tim e të kolegëve të mi opozitarë të gjithë atyre që u dëmtuan nga kjo ngjarje tragjike.

Deputetët e opozitës parlamentare, në këtë ngjarje tragjike që ndodhi, zgjodhën që angazhimin e tyre ta jepnin si bashkëqytetarë, si vëllezër, si baballarë apo si djem të të dëmtuarve pa bërë politikë me fatkeqësinë dhe për këtë u shpreh mirënjohjen time të gjithë kolegëve!

Tërmeti tragjik që ra në vendin tonë nuk la pas vetëm një numër të jashtëzakonshëm viktimash, të plagosurish, banesa të shkatërruara, dëme materiale dhe ekonomike, por ai tregoi

gjithashtu edhe dimensionet e shoqërisë sonë. Kështu, nga njëra anë u vu re solidariteti i jashtëzakonshëm i shqiptarëve me njëri-tjetrin, qofshin këta brenda kufijve të Republikës së Shqipërisë apo edhe jashtë saj, në trojet shqiptare në Ballkan apo më gjerë. Jo vetëm kaq, por në kuadrin e vëllazërisë njerëzore ka pasur iniciativë ndihme edhe nga popujt e tjerë dhe ne duhet t'u jemi mirënjohës atyre. Siç duket, fatkeqësia i bashkon njerëzit dhe siç thoshte presidenti amerikan Abraham Linkoln: "I bën të nxjerrin engjëjt më të mirë të natyrës sonë".

Nga ana tjetër politika edhe këtë herë nuk arriti dot të ngrihet në lartësinë që kërkon situata. Ditën e parë të tragjedisë u duk sikur liderët politikë të pozitës i bashkoi fatkeqësia. Në daljet e tyre në media ata dhanë mesazhe bashkëpunimi për përballimin e fatkeqësisë, por përsëri ditët e fundit janë ripozicionuar në frontet e tyre. Brenda të njëjtit edicion lajmesh shohim dy realitete, njëherë njërin që shkon dhe bën vizitë te një familje që ka strehuar dhe pas 10 sekondash shohim tjetrin që shkon dhe bën vizitë te një familje që ka ngelur në qiell të hapur. E gjithë kjo politikë me fatkeqësinë bëhet në media dhe si shpërblim media merr kërcënimin për mbyllje apo për burgosje. Të dyja këto realitete, si bërja politikë me fatkeqësinë, edhe kërcënimet i medias janë të papranueshme jo vetëm në raste të tilla, por edhe në situata normale. E vetmja shtresë e shoqërisë shqiptare që sot duhet të rrijë kokulur para shqiptarëve është klasa politike e 30 vjetëve. Duhet të rrijë kokulur jo se nuk parashikoi apo nuk ndaloi tërmetin, sepse tërmete, zjarre dhe dukuri të tjera natyrore kanë ndodhur dhe do të ndodhin përsëri dhe për këtë nuk janë fajtorë qeveritë, puna e qeverisë do të fillojë tani të menaxhimi i situatës; klasa politike duhet t'u përgjigjet pyetjeve që bën çdo qytetar dhe të nxjerrë fajtorët: Pse u rrëzua një pallat dhe ai tjetri ngjitur jo, kur ishte e njëjta lëkundje? A ka abuzime me këto leje ndërtimi? Pse u lejuan banorët në ndërtesat e pasigurta nga tërmeti i para 2 muajve?

Qeveria e sotme dhe ato të 30 vjetëve kanë dëshmuar se nuk kanë vizion për të ardhmen, ato qeverisin në momentin e tyre dhe vizioni i tyre është deri te zgjedhjet pasardhëse. Ne të gjithë jemi dëshmitarë që në funksion të zgjedhjeve të radhës janë dhënë leje ndërtimi dhe legalizime në mënyrë krejt arbitrare. Tërmeti i datës 26 nëntor

nuk ishte i pari në vendin tonë, edhe pse uroj të jetë i fundit. Ngrohja globale dhe ndryshimet klimaterike në planet kanë sjellë katastrofa më të shpeshta natyrore dhe tashmë ky është një problem botëror, i cili diskutohet nëpër samite dhe konferenca shkencore në mbarë botën se si duhet t'u përgjigjemi, t'i parandalojmë dhe t'i menaxhojmë këto situata që ndodhin.

Pyetja më e natyrshme që bëhet sot është: po Shqipëria a është e gatshme dhe e aftë për t'i menaxhuar këto situata? Koha ka treguar që jo! Në 15 vjetët e fundit vendi ynë është përballur me situata të shpeshta të dukurive natyrore dhe koha ka treguar që ne kujtohem për këto ngjarje vetëm pasi ato ndodhin. Rasti më i freskët është tani, ku vetëm 3 orë pas ngjarjes vëllezërit tanë kosovarë të përgatitur dhe të pajisur më së miri ishin në vendngjarje dhe për këtë ata kanë falënderimin e të gjithë qytetarëve shqiptarë. Po strukturat tona të ndërhyrjes, shërbimi zjarrfikës dhe ai i emergjencave civile, a ishin në lartësinë e kolegëve të tyre të rajonit? Unë mendoj që jo! Edhe pse gjithkush prej tyre luftoi me vetëmohim për përbalimin e kësaj katastrofe, dhe për këtë duhen falënderuar, u vu re se ata nuk i kishin pajisjet e nevojshme dhe nuk ishin trajnuar. Unë kërkoj që pjesë e paketës së rindërtimit në këtë rast duhet të jetë edhe ngritja e shërbimit zjarrfikës dhe e emergjencave në nivelin e vendeve të Bashkimit Europian.

E para që arriti në vendngjarje nuk ishte struktura qeveritare, por media dhe për këtë duhen falënderuar dhe jo kërcënuar. Raportimi në kohë reale i kësaj katastrofe bëri që të sensibilizoheshin me shpejtësi jo vetëm strukturat përgjegjëse të vendit, por edhe të vendeve fqinje e më gjerë dhe ndihma e tyre ishte vendimtare. Tashmë pas kalimit të fazës së shokut, sistemimit të të gjithë të dëmtuarve, detyra më e madhe është e qeverisë. Gjithashtu, detyrë e qeverisë është të jetë transparente me qytetarët, të cilët duan të dinë se si do të përballohen dëmet e tërmetit. Cila do të jetë zgjidhja e strehimit për të pastrehët? Ku do të gjenden paratë për dëmshpërblimin? Kush do t'i investojë dëmet? Populli kërkon të dijë nëse mund t'i besojë qeverisë për menaxhimin e situatës apo jo. Pse punonjësit e emergjencave civile të shtetit tonë nuk i kishin as mjetet më elementare të punës, ndërkohë që kolegët e tyre

të vendeve të tjera ishin trajnuar dhe pajisur me të gjitha pajisjet?

Këto ditë po shohim qeverinë ta përdorë gjendjen e jashtëzakonshme për të kërcënuar median dhe për të marrë avantazhe të pamërituara ndaj opozitës. Nga ana tjetër as opozita jashtë parlamentit nuk duket se po bën përpjekje reale në funksion të interesit publik. Edhe pse i ka ulur tonet dhe kritikën në kushtet e kësaj gjendjeje katastrofike, opozita nuk po ndihmon në gjetjen e gjuhës së dialogut me qeverinë.

Sot kemi dy pamje, solidaritetin njerëzor përballë fatkeqësisë dhe realitetin politik që vazhdon të jetë i organizuar në fronte që i ndajnë palët. A nuk duhet të marrin shembull edhe politikanët nga ky solidaritet i jashtëzakonshëm popullor dhe të përpiqen të caktojnë disa piketa të përbashkëta për të cilat nuk debatohet, por thjesht bashkëpunohet? Integrimi europian, zhvillimi ekonomik, rendi dhe drejtësia, të gjitha këto janë interesa madhore të vendit, të cilat mund të realizohen vetëm nëse palët politike bashkëpunojnë në vend që të konfliktohen pa fund. Në demokraci ka gjithmonë qeveri dhe opozitë, por ama demokracia nuk nënkupton që të ketë gjithmonë debate, konflikte dhe polemika midis tyre për çdo gjë. Nëse vazhdohet kështu, populli nuk do të shohë te ne shtetin që kujdeset për të, shtetin që i garanton jetën dhe mirëqenien, por shtetin që e lë në mes të katër rrugëve dhe në mëshirë të fatit. Ky rrezik është më i madh sot se kurrë më parë. Njerëzit i kanë veshët dhe sytë hapur prej tragjedisë që i pllakosi, prandaj i takon politikës t'u japë mesazhin e duhur për t'ua ringritur jetën në cilësi njerëzore dhe shoqërinë me drejtësi dhe racionalitet.

Le të shërbejë kjo tragjedi e madhe si një zgjim i madh dhe ne ta kuptojmë se nuk mund të vazhdohet më me falsitet. Ky falsitet na i shembi qytetet, jetët dhe banesat, prandaj nuk duhet të ketë më leje false ndërtimeve jashtë kritereve, mbështetje false elektorale, inxhinierë që nuk janë të tillë, prokurorë që nuk bëjnë punën e tyre, inspektorë që nuk inspektojnë. Ky falsitet duhet të marrë fund një herë e mirë. Vetëm duke bërë këtë më në fund politika do të ngrihet në lartësinë e situatës dhe nivelin që kërkon populli. Ky solidaritet i jashtëzakonshëm popullor bën thirrje për një realitet të ri politik, prandaj tani e tutje politika duhet t'i rikthehet gjenezës së saj,

bërjes së të gjitha përpjekjeve për të sjellë atë që Aristoteli e quante “jeta e mirë”.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti Lita!

Fjalën e ka Belinda Balluku.

Të përgatitet Enver Roshi.

Belinda Balluku – Tërmeti i 26 nëntorit është ngjarja më e rëndë e dekadave të fundit. Nuk kanë kaluar as 10 ditë dhe personalisht, duke qenë e përfshirë në këtë ngjarje që në ditët e para, që në momentet e para, që në orën e parë, nuk jam edhe emocionalisht e gatshme për të filluar për t’iu përgjigjur opozitës dhe deputetit që sapo foli me listën e ankesave dhe të akuzave. Opozita duhet të ketë fytyrën e Edlira Hysenit, së cilës i përulem me respekt shumë të madh, meqë përfaqëson në këtë parlament qytetarët e Durrësit. Ata që kanë ndier në kurrizin e tyre, në zemrën e tyre, në shpirtin e tyre, edhe kur programi ynë i rindërtimit, i cili do të jetë një program i shkëlqyer, një program jo thjesht për të akomoduar njerëz të mbetur pa banesa, por një program për të akomoduar njerëz që kanë nevojë për të harruar dhe për një jetë të re, jam e sigurt që sërish nuk do të arrijnë ta harrojnë as dhimbjen dhe as humbjen, jo vetëm ata që kanë humbur fëmijët e tyre, motrat, nënat dhe baballarët, por edhe ata që kanë humbur komshinë e tyre. Edhe unë që banoj në Tiranë, kam dashur të ndaj me ta momente, të cilat nuk thuhet me fjalë.

Ndaj, i dashur deputet, ka një kohë për mort, një kohë për hidhërim, një kohë për gjithçka. Për listën e akuzave do të jap vetëm një përgjigje. Folët për ndërtimet e pakontrolluara. Edi Rama sot mban me nder një veprim administrativ të jashtëzakonshëm që ka bërë në vitin 2013, ka ndaluar ndërtimet pa leje. Në atë kohë opozita ulërinte dhe thoshte si nuk lejohen të ndërtohen me gjakun dhe sakrificën këto ndërtime dhe pse kërkohen leje dhe akte administrative. Ja pra pse kërkohen. Pra, kjo qeveri dhe Edi Rama personalisht, me mburrje mund të thonë se që nga viti 2013 nuk ka asnjë ndërtim pa leje në zonën e Kënetës. Ato ndërtesa që u rrafshuan dhe shuan familje të tëra para syve tanë, janë ndërtuar pa leje, por jo pas vitit 2013, i nderuar deputet.

Duhet t’i kthehem asaj që ndodhi dhe reagimit të këtij shteti. Shteti shqiptar ka reaguar në mënyrën më ekselente. Ai ka marrë në

kontroll menjëherë situatën në minutat e para dhe këtë e them unë, e thotë kolegu im Klosi, e thotë kolegu im Shalsi, që kemi arritur në Durrës para se të zbardhte.

E dini çfarë, deputetë? Te pallati i rrëzuar, në krah të shkollës “Dy gjelat”, kemi gjetur Dritan Lelin, për çudinë time të madhe, me dy zjarrfikëse të ardhura nga Vlora. Ai kishte arritur njëkohësisht me ne atje. Dua të theksoj, duke mos harruar të falënderoj të gjitha grupet që erdhën nga Kosova dhe e gjithë Europa për të na mbështetur, se asnjëri këtu dhe askush në këtë republikë nuk duhet të harrojë se ata njerëz nga rrënojat, deri në orën 07:30, kur janë shfaqur skuadrat e para të shpëtimit, i kanë nxjerrë zjarrfikësit shqiptarë, i ka nxjerrë Luani nga Vlora, që kishte ardhur me Tan Lelin, që kur po e nxirrnim jashtë për t’i dhënë oksigjen nuk pranonte, sepse kishte zëra që dëgjoheshin aty brenda.

U tha që shteti reagoi vonë dhe po të mos kishin ardhur skuadrat e shpëtimit, këtu s’do të ishte bërë asgjë. E pra, nuk është e vërtetë, sepse, siç ju thashë, shteti ka qenë i tëri në këmbë, dhe jo për shkak të detyrës. Më besoni se nuk ka pasur më lidhje me detyrën, por me detyrën e secilit prej nesh si njerëz.

Unë jam në detyrën e ministres së Infrastrukturës dhe Energjisë, por kam qenë atje si qytetare e Republikës së Shqipërisë. Shalsi nuk e ka për detyrë të jetë në terren, por ishte aty me mua që prej orës 5 të mëngjesit duke u munduar të dëgjonim zërat nën rrënoja.

Është shumë e vështirë emocionalisht të bësh sot një fjalim zyrtar për të dhënë numra dhe shifra, por ato i ka dhënë pa fund media dhe nuk besoj se keni nevojë t’i ridëgjoni. Po shikoj kolegun tim Andrea Marto të përlotur. Me thënë të drejtën, as unë nuk kam dëshirë t’i mbaj lotët në këto momente, por më duhet ta bëj për të vazhduar fjalimin.

Opozita duhet të ketë fytyrën e Edlirës. Duhet ta ketë gjithmonë, sepse opozitat janë aty për të kontrolluar pozitën që të mos abuzojë dhe të mos bëjë gabime, janë aty për të bërë dialog konstruktiv. Nuk është hera e parë e Edlirës, ajo nuk e ka nga tërmeti, as sepse është nga Durrësi, por sepse ajo ashtu është. Ajo del këtu dhe kërkon të bëjë opozitë konstruktive. Është shumë e lehtë që secili prej jush të dalë e të tregojë se çfarë u bë gabim, por nuk e di sa e lehtë do të

ishte për secilin të ishte përballë familjes së shuar të Lalajve e djalit të mbetur të tyre, Ram Lalës, si për t'i treguar vdekjes se prapë jeta dominon mbi vdekjen.

Kanë qenë zjarrfikësit tanë, Policia e Shtetit, ka qenë Aksemi, ata burrat që dinë të nxjerrin njerëz nga minierat, që qëndruan në krah të Sandër Lleshajt e Erion Braçes tek merrnin pjesë të gjithë bashkë për të nxjerrë edhe frymën e gjallë të fundit nga ato rrënoja. Nuk e kemi pritur orën 07.30, jo.

Grupet që kemi pritur kanë qenë të jashtëzakonshme. Italianët, që u isha pranë në Kënetë, ishin një grup i jashtëzakonshëm. Po ashtu edhe francezët, zviceranët. Ata kanë eksperiencën, kanë kapacitetet. Po a e dini si i kanë ngritur? I kanë ngritur për shkak të problematikave që kanë pasur. Italia është një vend ku tërmetet me viktima, siç na ndodhi ne, ndodhin shpesh. Zviceranët kanë ngritur kapacitete, sepse kanë humbur jetë njerëzish çdo vit nga ortekët. Po ashtu edhe vendet e tjera si Turqia, Greqia e të tjerë.

Ky është një vit me tri raste tërmetesh, ku shteti ka reaguar si kurrë më parë. Sot kemi mbaruar shtëpitë në Floq. Sot po mbarohen shtëpitë e goditura nga tërmeti i shtatorit. Ne nuk hahemi dot me fatkeqësitë natyrore dhe as me Zotin. Askush nuk ka të drejtë të merret me detaje kur mortit nuk ka mbaruar. Me ato do të merremi ne. Grupet hetimore janë në terren sot. Nuk do të prishet asnjë ndërtesë pa u marrë kampionet e secilës rrënojë dhe pa u çuar në laboratorët e Institutit të Ndërtimit për t'i krijuar mundësinë prokurorisë dhe Policisë së Shtetit të japin rezultatet dhe për t'i dhënë dënimin e merituar secilit që e meriton.

Kujtohuni edhe një herë! Nëse ka pasur një person, i cili ka bërë luftë në këtë shtet kundër ndërtimeve abuzive dhe ndërtimeve pa leje, ky është Edi Rama, jo thjesht si Kryeministër, por edhe si ish-kryetar i Bashkisë së Tiranës.

Është e lehtë sot të kërkonin fajin dhe fajtorët, por mos vallë është koha që të gjithë së bashku të mendojmë për rindërtimin dhe të ngrihemi nga hiri si Feniksi? Ne si shqiptarë jemi ngritur shumë herë nga hiri dhe këtë dimë ta bëjmë shumë mirë, por këtë mund ta bëjmë vetëm të bashkuar dhe jo duke kërkuar fajtorë aty ku nuk ka. Aty ka vetëm heronj që duhen falënderuar duke filluar nga Emergjencat Civile,

nga Zjarrfikëset, nga Policia e Shtetit deri te Urgjencia, që ka ngritur Ogerta, që as shtetet europiane nuk e kanë të tillë, që nuk munguan as kur dilnin të gjallët dhe as të vdekurit nga rrënojat.

Ne duhet të jemi të gjithë bashkë këtu për të rindërtuar shpirtin e Shqipërisë. Ata që kanë vdekur nuk janë 51 vetë, na është goditur shpirti të gjithëve bashkë.

Gramoz Ruçi - Fjala për Enver Roshin. Të përgatitet Myslim Murrizi.

Enver Roshi – I nderuar Kryetar,
Të nderuar zotërinj deputetë,

Natyrisht, pas fjalimeve të Edlirës, të Belindës e të gjithëve ne, e ndiej obligim moral dhe shpirtëror t'u shpreh ngushëllimet më të thella familjeve që humbën jetë, të plagosurve dhe gjithë të tjerëve që kanë mbetur pa shtëpi, që janë jashtë e sot kërkojnë ndihmë nga ne.

Më tepër se kurrë ky komb në të gjithë historinë e vet e ka treguar solidaritetin në fatkeqësi kombëtare dhe sot e gjatë gjithë kësaj jave politika shqiptare në tërësi e ka treguar veten që është bashkuar për t'iu ardhur në ndihmë njerëzve që kanë nevojë.

Sot është koha që politika të dalë mbi interesat e ngushta personale në shërbim të njerëzve, të atyre që sot janë në ditë të hallit. Unë solidarizohem me të gjithë mbështetjen që ka dhënë populli shqiptar dhe ai i Kosovës, i madh e i vogël, për t'u qenë pranë familjeve në Durrës, Thumanë, Lezhë, Laç, Tiranë e kudo.

Sot është koha t'u shprehim mirënjohjen bluzave të bardha, të cilat orë e pa orë, në shi e dëborë, nën rrënoja e mbi to, u kanë shërbyer njerëzve në nevojë, bluzave të bardha që shpeshherë media i ndjek edhe për një 2-mijëlekësh, dhe pastaj burgosen, bluzave të bardha që kanë sakrifikuar edhe jetën e tyre për t'u ardhur në ndihmë njerëzve. Sot është koha që mjekëve, infermierëve dhe gjithë mjekësisë shqiptare, që ka qenë në ballë të të gjitha emergjencave civile, jo civile dhe të luftës, t'u shprehim mirënjohjen tonë edhe nga foltorja e këtij parlamenti.

Është koha njëkohësisht t'u shprehim mirënjohje të thellë të gjitha vendeve europiane duke filluar që nga Izraeli, Kroacia, Zvicra, Italia e të tjera. Sot është koha për të qenë bashkë të gjithë.

Është koha t'i bëjmë thirrje qeverisë të sjellë këtu një plan të detajuar zë për zë, të zbërthyer teknikisht për të qenë transparente edhe me njerëzit, që të mos thonë se ndihmat vidhen, se kjo është paradigma që i shqetëson ata. Ne duhet ta aprovojmë atë program sa më parë.

Është koha që buxheti i shtetit të shikohet me shpirt, me pasion dhe përkushtim për të ndihmuar njerëzit në nevojë. Është e nevojshme që ky buxhet të rishikohet në detaje për të ndihmuar familjet në nevojë dhe të kursejmë disa gjëra që janë luks e teprime. Ne jemi këtu jo për të bërë politikë, por për t'i shërbyer popullit shqiptar. Të gjithë ndihmat tona shtetërore dhe joshtetërore të shkojnë aty ku duhet.

Kjo kërkon një trajtim të gjerë teknik, por njëkohësisht nxjerr në plan të parë harresën. Ne nuk nxjerrim mësim nga eksperiencia jonë mijërvjeçare, dhjetërvjeçare. Është një thirrje që u bëhet të gjitha organeve të shtetit, bashkive, inspektorateve, inxhinierëve, ndërtuesve e të gjithëve për të vënë shpirtin para babëzisë së tepruar për shtesa katesh, për ndërtime pa cilësi, por njëkohësisht u bëjmë thirrje edhe njerëzve që të nxjerrin mësim, që kur të hyjnë në atë shtëpi, të cilën e kanë blerë me mund e gjak, të kontrollojnë dokumentacionin për ta gëzuar edhe në vitet e tjera të jetës.

Shteti duhet të funksionojë, prokuroritë e gjykatat të kontrollojnë të gjitha dokumentet e ndërtesave në Shqipëri. Kjo është ndihma që duhet t'u japim qytetarëve shqiptarë dhe sot më shumë se kurrë kemi nevojë për mbështetje dhe solidaritet. Atë e kemi këtu, e kemi kudo sot dhe në të ardhmen. Koha për politikë personale besoj se këtij vendi i ka ikur prej 30 vjetësh. Ka vite që ka ardhur koha për të bërë politikë për njerëzit. Le ta bëjmë, sepse nuk është vonë.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti Roshi!

Fjala për Myslim Murrizin.

Të përgatitet Elva Margariti.

Myslim Murrizi – Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar kolegë,

Së pari, si njeri, si qytetar dhe si deputet gjëj rastin t'u shpreh ngushëllimet e mia të sinqerta të gjitha familjeve të viktimave dhe të gjithë fatkeqëve që janë goditur nga tërmeti i 26

nëntorit, të cilët janë pa banesa, enden nëpër spitale dhe jetojnë në mes të katër rrugëve!

Nuk kam dashur, nuk dua të bëj politikë me asnjë fatkeqësi dhe nuk do ta bëj as me ngjarjen tragjike të 26 nëntorit.

Shpreh respekt dhe konsideratë për të gjithë individët, pjesë e strukturave që erdhën nga jashtë dhe pjesë e strukturave të shtetit shqiptar, të cilët bënë të mundur shpëtimin e jetëve nën rrënoja, sikurse shpreh përçmim, përbuzje dhe neveri për çdo klan politik që gjeti ditën më të keqe për të bërë show mediatik, për të bërë estradë në kamera dhe për të treguar se i duan shumë shqiptarët pasi vdesin!

Qeveria nuk është organizatë bamirësie, qeveria nuk është shoqatë, qeveria nuk është Elvis Naçi, për të cilin shpreh konsideratë për çdo gjë që ka grumbulluar dhe për kontributin e tij në ndihmë të fatkeqëve. Qeveria është votuar nga qytetarët shqiptarë dhe ka një buxhet prej 4 miliardë eurosh, që duhet menduar, siç thonë shqiptarët: "Parja e bardhë për ditë të zezë".

A keni menduar ju si qeveri për një ditë të tillë, për një fatkeqësi të tillë, për një katastrofë të tillë? Nuk keni menduar aspak, ndaj lërin qarravitjet, mos bëni si fatorino furgoni dhe mos rrokni qen në qafë sa në Thumanë dhe në Durrës, sepse kanë shpëtuar jetë shqiptarësh! Keni përgjegjësi mbi vete për votat që keni marrë për këtë maxhorancë, për t'iu gjendur shqiptarëve si në ditë të mira, edhe në ditë të këqija.

26 nëntori ishte një ditë e zezë për të gjithë shqiptarët dhe veçanërisht për familjet që humbën 51 të afërmit e tyre.

Paketa e sotme fiskale që doni të prezantoni dhe të kaloni nën nxitimin e tymit të tërmetit nuk është asgjë më shumë se një flluskë sapuni. Nëse doni t'i kushtonit rëndësi 26 nëntorit, atyre mijëra familjeve që jetojnë në çadra, të pastrehëve, të strehuarve nëpër hotele, të cilët nga shteti presin t'i kthejë një ditë në banesat e tyre, duhet të bëni një seancë të jashtëzakonshme të parlamentit, ku të diskutojmë enkas për tërmetin.

Në rendin e ditës keni sjellë me nxitim 18 pika. Shqiptarët duhet ta dinë se çfarë është paketa që prezantoi ministrja e Financave. A ka të bëjë me tërmetin? Nuk ka të bëjë fare me tërmetin.

Aktet normative i keni në pjesën e dytë.

Do t'jua them edhe aty se çfarë keni.

Cila është pika e parë e rendit të ditës? Dhënia me koncesion e shërbimit të faturave tatimore *online* të kompanisë fantazmë prej 17 milionë eurosh. Keni lidhur kontratë, nuk e di se çfarë keni bërë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, Ervin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është pika 3 e asaj që po diskutojmë.

Çfarë keni në pikën 4? I keni hequr tatim-fitimin koncesionarit që sjell makina të reja: nga 15% e bëni 5%. Çfarë ndihme i jep kjo një fatkeqi që ka humbur familjen dhe shtëpinë nga tërmeti?

Pse e bëni këtë? Sepse lobuesit e atyre që sjellin makina ju kanë kapur prej fyti dhe ju thonë t'u hiqni tatim-fitimin, siç keni hequr në këtë sallë, në heshtje dhe në marrëveshje me këta që e bëjnë sot, akcizën e pijeve energjike. Ju hyni nga një derë, ata dalin nga dritarja, ju dilni nga mbrapa hardhisë, këta dalin nga dera përballë, duke bërë sikur jeni të zemëruar.

Çfarë ka në pikën 5 të paketës? Është ligji organik për të rregulluar atë që do t'u jepni 109 mijë bizneseve shqiptare, të cilët duhet të blejnë një kasë fiskale tjetër, sepse kasën e parë e kanë blerë në vitet 2013–2014.

Në pikën 6 është heqja e taksës 10% për makinat e luksit, ku thoni: “10% normë amortizimi për çdo vit që kalon”.

Pika 7 është buxheti në parim.

Shqiptarët duhet ta dinë se ju, zotërinj, pas deklaratës së Kryeministrit tuaj thoni: “Nuk do të ndërhyjmë në buxhet, sepse duhet të bëjmë çfarë kemi planifikuar dhe lekët për tërmetin do t'i gjejmë me donatorë”.

Në buxhetin tuaj për vitin 2020 janë planifikuar 2,6 milionë euro për emergjencat civile. A e zgjidh kjo shumë fatkeqësinë që u ra shqiptarëve më 26 nëntor? Jo.

Para pak kohësh në këtë sallë kemi miratuar ligjin për të detyruar pushtetin vendor që 4% të buxhetit ta përdorë për emergjencat civile. I gjithë buxheti i pushtetit lokal është rreth 440 milionë euro. 60 bashki së bashku kanë 18 milionë euro. Nëse i bashkoni me fondin prej 2,6 milionë eurosh për emergjencat civile, shkojnë 20 milionë euro. Këtë ka menduar kjo qeveri për një katastrofë natyrore, siç ishte 26 nëntori.

Dëmi i llogaritur, me atë që kemi parë në media, sepse unë nuk marr përsipër të bëj

inxhinerin apo supervizorin, është mbi 500 milionë euro. Ku do t'i gjeni paratë?

A do t'ia hiqnit portalit të famshëm “E-qeverisje”, për të cilin keni planifikuar jo pak, por 40 milionë euro për vitin 2020, nga 30 milionë euro që kishit planifikuar në vitin 2019? Jo. Pse? Sepse portali është vjedhje e hapur. Janë 180 mijë veta në administratë, por ne duam edhe një portal për të qeverisur Shqipërinë që duam. 40 milionë euro keni planifikuar për atë portal.

Ngrihuni mbi tallavatë mediatike! Mjaft bëtë estradë! I thoni të parit tuaj të mos marrë përsipër të bëjë Santa Klausin dhe me shkop magjik të shkojë në spital të dy fëmijët fatkeq duke i pyetur: “Çfarë fanelle dëshiron ti?” “Të Ronaldos”- i thotë fëmija. “Do ta sjell unë fanellën e Ronaldos”.

“Po ti tjetri?” “Dua kapelen e Trampit”.

“Po ti?” “Dua fanellën e Mesit”.

Mjaft me këtë gallatë! Mjaft me *show*! Mjaft me njerëz teveqelë nga trutë e kokës, që thonë: “Më ka humbur gruaja”. “Mjaft” thojni edhe atij tjetrit! E keni harruar tërmetin! Aq shumë e keni harruar tërmetin, sa po bëni serenatë për së dyti. Ne jemi duke ju lutur me zemër në dorë, aman, të keqen, hajdeni.

Një ish-kolegu im, që ne e quajmë ish-opozitar, jashtë parlamentit, ishte kënaqur shumë. Ai nuk ishte kënaqur me gatishmërinë e atyre që erdhën për të ndihmuar, për t'ua zbutur shqiptarëve sadopak fatkeqësinë e 26 nëntorit. Ai ishte kënaqur se Rama kishte shpërndarë në *facebook* çfarë kishte thënë Basha. Rama kishte shpallur gjendjen e jashtëzakonshme në Laç se e kërkoi Basha. Ky i bënte thirrje: “Bravo, që po e kërkoni ti! Tani, avash-avash, hap krahun të vujmë ne”. Halli i madh i grupit të kaçakëve, që ky i thotë “kçk”, është të ikin 20 kaçakë dhe të vijnë 20 kaçakë të tjerë.

Mjaft bëtë politikë me fatkeqësitë e këtij populli! Të gjitha qeveritë kanë përgjegjësi, sepse e keni kthyer INUK-un në IKMT, nga një polici ndërtimore. Lloj-lloj emrash. Në të vërtetë, çfarë e keni kthyer? Si celulë kamikazësh dolën 4 xhenierë me tritol në dorë.

Lërimi hipokrizitë, sepse për 6 vjet keni prishur më shumë se tërmeti. Pse kur i prishni ju, qeshni, dhe kur i prish i madhi Zot qani? Pasuri shqiptarësh është edhe ajo që keni prishur ju. Me plot sadizma, nga rotondoja e Pilo Lalës në

Dushk, te Astiri, në Shkozë, në Pogradec, ku keni mundur, ka qenë pasuri shqiptarësh.

Nga ndryshojnë fatkeqët që u është prishur shtëpia nga Perëndia nga ata që ua kanë prishur kamikazët e qeverisë?

Po, keni, sepse ka qenë i pari juaj kryetar bashkie për 11 vjet. 12 vjet ai i Durrësit, 4 ky tjetri që kërkon konsensus me ju. Sa leje ndërtimi keni dhënë? Më gjeni një leje shfrytëzimi të pallateve që ka një procesverbal ekzakt brenda të gjithë parametrave që kërkojnë konstruktorët, inxhinierët për lejet e ndërtimit? Nuk ka asnjë. E quani të ezauruar çdo gjë me ndërtimin ditën që falen dhe japin bakshish kur firmoset leja e ndërtimit tek ai që ka në dorë të firmosë lejen e ndërtimit dhe thoni se kemi kryer punë me detyrimin qytetar.

Pakësoni luksin nga buxheti i vitit 2020. Mjaft me PPP-të e famshme. Hiqni disa miliona nga portali i famshëm, se e keni për galletë dhe nga tenderët sekretë, që keni me AKSHI-n, se nuk është koha të blihen kasa fiskale për 109 mijë biznese, sepse 2 vjet kanë që i kanë blerë. Mjaft me kushërinjtë e asaj që ishte këtu për t'u dhënë firmë fantazmë, sepse do të monitorojë dhe do të nxjerrë faturat *online* tatimore. E ka bërë Italia, ka dështuar dhe është lëmsh. Ka dy vjet që nuk e merr vesh i pari të dytin.

Pakësoni koncesionarët dhe makinat e luksit. Çfarë keni bërë për tërmetin te pjesa e dytë e aktit normativ? Keni hequr TVSH-në e ushqimeve që do të vijnë nga emigrantët shqiptarë apo nga shoqatat bamirëse në doganë. Pse, kjo është arritje? Mes tyre keni future edhe pikën se do t'u hiqni edhe TVSH-në atyre që do të ndërtojnë bazën e NATO-s.

Keni thënë se do t'u lidhet pension familjeve të viktimave dhe keni parashikuar që sponsorëve t'u hiqet tatimi 3%, që ka qenë nga tatimi bruto, të shkojë 8%, por jo kur sponsorizon me shpirt aty ku është dëmi, por kur i derdh në arkën e qeverisë. Pra, ai duhet t'i çojë te kryetari i komitetit të përgjithshëm të shtabit, tek i plotfuqishmi juaj. Pra, do t'i çojë tek arka që komandohet nga zoti Ahmetaj, sepse ndryshe nuk njihet si sponsor.

Faleminderit!

(Drejtimin e seancës e merr zonja Vasilika Hysi.)

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Murrizi!
Fjalën e ka ministrja Elva Margariti.

Elva Margariti – Të nderuar kolegë,

Të nderuar të pranishëm,

Fjalët e ngushëllimeve dhe të hidhërimeve nuk janë asnjëherë të mjaftueshme për situatën që gjendet vendi ynë, por jemi sot këtu që përtej tronditjes t'u japim një mesazh optimizmi dhe shprese të gjithë atyre që kanë humbur pjesëtarë të familjes, por mbi të gjitha për t'u dhënë një mesazh shprese dhe optimizmi të gjithë të rinjve, që këtë do ta përjetojnë si një moment historik të jetës së tyre.

Të nesërmen e tronditjes së madhe, jo vetëm fizike, të tokës nën këmbët tona, por edhe të tronditjes së madhe psikologjike dhe humane, shumë prej nesh u gjenden para faktit që duhet të qëndronim në të ftohtë. Ndërkohë që grupe të tëra ecnin përpara për kërkimin e personave të humbur nën gërmadha, disa prej nesh morën detyrën e vështirë për të krijuar një vizion më të mirë, një vizion shprese për rimëkëmbjen, sepse shumë shpejt do të vinte dita që njerëzit do të fillonin ta kërkonin me ngulm këtë vizion. Kjo nuk ka lidhje vetëm me solidaritetin, me faktin që është një detyrë e qeverisë, por vizioni i një zgjidhjeje në momente të tilla është kyç i hapave të shëndoshë dhe shpresës jo vetëm për komunitetet e prekura, por për të tërë kombin. Vendosëm të mos humbim asnjë minutë dhe filluam të ndërtonim shpejt rrugën e duhur, hapat e parë që duhet të ndërmerrem.

Për këtë kam një falënderim të veçantë për të gjitha vendet fqinje, jo vetëm për ekspertët lokalë në Shqipëri, të cilët na kanë ndihmuar për të krijuar një rrugëtim të shëndoshë dhe për të mos humbur asnjë moment kohë.

Vendet fqinje, të cilët në eksperiencën e tyre kanë kaluar tërmete të tjera jo shumë vite më parë, na kanë këshilluar menjëherë se rrugëtimi i duhur ishte krijimi i vizioneve afatgjata dhe jo vetëm një rimëkëmbje e përkohshme.

Ky ka qenë fokusi ynë këto ditë, këtë javë fatkeqësie, për të krijuar një rrugëtim të shëndoshë, i cili nuk duhet të ndalet vetëm me shërimin e plagës, por duhet të krijojë një moment të artë zhvillimi të komunitetit dhe të të rinjve.

Pas kalimit të fazës së parë dhe imediate të akomodimit të familjeve, të cilat nuk mund të kthehen në banesat e tyre, fillon një fazë tjetër e rëndësishme, që ka nisur tashmë, për evidentimin e dëmeve dhe nevojave, por kjo duhet

mirëmenduar, të jetë afatgjatë, që të ofrojë një të ardhme jo vetëm për Tiranën, Durrësin, Thumanën, Lezhën dhe Laçin. Nuk duhet të shërojmë një plagë sot duke krijuar një plagë sociale më vonë. Të gjithë të prekurit nga tërmeti duhet dhe meritojnë një të ardhme më të sigurt, më të mirë, më të shëndetshme, por, siç kemi thënë dhe përsëritur këto ditë, jo me vulën e të prekurve nga tërmeti. Që të arrijmë aty nevojitet një hartë e qartë e nevojave, nevojitet të kalohet në mënyrë imediate në fazën e dytë. Ky është një rrugëtim, i cili në stacionin e parë ka evidentimin e dëmit, ndërsa në stacionin e dytë, ku ne ndodhemi, është hartimi i projekteve konkrete afatmesme dhe afatgjata për këtë rimëkëmbje.

Kemi koordinuar punën në terren në mënyrë të përditshme me qendrën operacionale të emergjencave, ku përditësohen të gjithat të dhënat për banesat që ndodhen në rrezikshmëri në fazën drejt shembjes dhe në banesat që janë të rikuperueshme dhe mund të rikonstruktohen. Në ndalesën e dytë është shumë e rëndësishme të evidentojmë sa më parë zonat reale të rimëkëmbjes.

Eksperiencia e vendeve fqinje ka treguar se jo gjithmonë rimëkëmbja bëhet pikërisht në të njëjtën hapësirë ku është krijuar dëmi. Ky ka qenë fokusi ynë. Ne kemi bërë një hulumtim të gjerë dhe kemi evidentuar dy realitete: urban dhe rural. Me përgjigje konkrete: në Tiranë dhe Durrës kemi evidentuar zonat më të mundshme me potenciale të larta zhvillimi, jo vetëm si shërimi i një plaje, por edhe si një mundësi e mirë për të bërë të mundur zhvillimin social dhe ekonomik.

Në hapësirën e fundit të evidentuar te zona "5 Maj" kemi menduar që rehabilitimi të shkojë përtej faktit rezidencial, me ndërthurjen e nevojave për një zhvillim drejt inovacionit dhe realiteteve të reja të start *up*-ve teknologjike, përtej nevojave bazike të qendrave shëndetësore, përtej nevojave të shkollave dhe kopshteve të reja, sepse Tirana dhe Durrësi kanë një dinamizëm të ri, ndryshe nga hapësirat e tjera urbane, si Lezha dhe Laçi. Këtu flas pikërisht për nevojat, që janë evidentuar gjatë këtyre viteve, për të çuar të rinjtë tanë drejt të ardhmes, drejt bashkëpunimit profesional dhe përforcimit të mundësive ekonomike lokale.

E di që sot këto duken si fjalë të mëdha, si vizione shumë të largëta, por realiteti i vendeve

fqinje, në rastet e tërmeteve si në Aculla në vitin 2009 dhe në Emilia në vitin 2012, kanë operuar, së pari, duke ndërtuar banesa të përkohshme, të cilat sot janë kthyer në plagë sociale, në realitete që njerëzit i shikojnë ende si traumatike dhe evidentohen ende si zona të krijuara vetëm për personat e tërmetit, ku ata vazhdojnë dhe ndihen të marginalizuar.

Ky nuk do të jetë rasti ynë. Ne kemi evidentuar zonat në Tiranë dhe në Durrës, ku ka një dinamizëm tjetër, dhe të rinjtë duhet të ndërthuren në këtë zhvillim, duke u dhënë një mundësi më shumë, ku do të ndërthuren realitete të përditshme të personave të prekur nga tërmeti.

Më pas do të kalojmë në Laç, ku shumë banesa individuale dhe apartamente prej kohësh e kishin tejkaluar afatin e amortizimit. Sot, ato zona, së bashku me nevojat e tjera, si rikuperimi i shtretërve për përmytjet, rikuperimi i hapësirave publike të munguara, do t'i japin një pamje të re Laçit. Nuk po flasim vetëm për hapësirat urbane, por edhe për ato rurale, ku nevojat janë të një natyre tjetër, pasi banorët janë tërësisht të lidhur në jetesën e tyre të përditshme me tokën e tyre, me gjënë e gjallë, pra zgjidhja do të ketë tjetër mënyrë rimëkëmbjeje, por një kusht i padiskutueshëm do të jetë standardi antisizmik i ndërtesave. Ajo çfarë ka ndodhur në zonat rurale është pasojë e një standardi të ulët dhe jo të mirëkontrolluar.

Sot është momenti për t'u dhënë këtyre njerëzve një mundësi të re ndërgjegjësimi dhe rimëkëmbjeje. Zgjidhjen për nevojat e banorëve të zonave rurale duhet ta kërkojmë aty ku ata kanë jetuar deri tani. Po fillojmë punën në terren me të gjitha hapësirat e mundshme. Kemi një mbështetje të madhe nga arkitektët dhe inxhinierët lokalë, të cilët i falënderoj për angazhimin, jo vetëm në evidentimin e dëmeve, për mbledhjen e informacioneve, por mbi të gjitha, për gatishmërinë maksimale në hartimin e projekteve të para dhe materialeve që na nisin me ide të reja zhvillimi!

Siç e thashë, po shfrytëzojmë eksperiencën e vendeve fqinje, mënyrën e trajtimit dhe të zgjidhjeve të duhura.

Gjej rastin të falënderoj të gjithë ekspertët e huaj që për herë të parë iu ofruan Shqipërisë me nevoja konkrete për rimëkëmbje! Ne duhet të rindërtojmë shtëpi, jo thjesht banesa, duhet të ndërtojmë një të ardhme të re më të sigurt dhe jo

vetëm një vragë në faqet e qyteteve. Është momenti t'i bëjmë gjërat siç duhet, të rregullojmë gabimet e së shkuarës, jo vetëm në mënyrën e ndërtimit, jo vetëm në estetikë, jo vetëm në nevojat bazike të të përditshmes, por është momenti për të ndezur shpresën dhe jo për ta shuar atë me polemika dhe politika të kota të rrugëve që po ndiqen, nëse janë të shëndosha apo jo. Nëse të gjithë do t'i bashkohemi kësaj ideje dhe do të kuptojmë se sot nuk është vetëm një tragjedi, por një mënyrë shumë e mirë dhe një moment ideal për të parë një të ardhme me investime të qëndrueshme, atëherë do të bëjmë gjënë e duhur për të gjithë ata që u dëmtuan dhe për të gjithë të rinjtë që u bënë pjesë e kësaj tragjedie.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Margariti!

Fjalën e ka deputeti Lefter Maliqi.

Të përgatitet ministrja Besa Shahini.

Lefter Maliqi – Faleminderit, zonja drejtuese e seancës!

Të nderuar shqiptarë, ju që po na ndiqni,

Sot nuk është koha për lot qeveritarë apo për fjalime të bukura, por është koha për forcë, për kurajë dhe për drejtësi.

Bashkimi i shqiptarëve është vetëm për drejtësi ndaj viktimave të 26 nëntorit, ndaj familjeve të dëmtuara dhe jo për fjalime dhe për këtë seancë parlamentare të përbuzur, ku vetë pikat e rendit të ditës janë për të vënë duart në kokë.

Më 21 shtator ne u mbledhëm në seancë vetëm për tërmetin dhe pamë *show* me ministrat dhe deputetët, të cilët me përparësi dhe garazhde u shërbyen familjeve të dëmtuara dhe nuk bënë asgjë për të vlerësuar siç duhet dëmet apo për t'u thënë banorëve të familjes Lala, me origjinë nga Hasi, mbi 9 persona, apo edhe të tjerëve në Thumanë, se nuk duhet të hynin në ato pallate, pasi qëndruan 1 muaj në çadra pas 21 shtatorit.

Kush është përgjegjësi, me gojë apo me shkrim, që u tha se duhet të banonin sërish atje? Ne duhet të ishim mbledhur urgjent në një seancë të jashtëzakonshme, por jemi mbledhur pas 10 ditësh. Turp dhe skandal! Shqipëria është republikë parlamentare, që do të thotë se parlamenti vendos për gjithçka, parlamenti krijon qeverinë, institucionet e të gjitha me radhë. Por parlamenti, për shkak të sistemit të korruptuar, i

ka kthyer njerëzit në dele. Në dele janë kthyer edhe kryebashkiakët e dalë nga zgjedhjet moniste, me të cilët Kryeministri tallet: “Jeni bërë për gomarë dhe për kuaj”, ndërkohë që ata fatkeqë vuajnë, qajnë dhe vajtojnë ende sot e kësaj dite.

Kush do ta mbajë përgjegjësinë për këtë tragjedi? Kryeministri e të tjerë kërkojnë miell hua nga shtetet e Europës dhe kudo, ndërkohë që parlamenti duhet të ishte mbledhur. Në buxhetin e vitit 2020 janë 300 milionë dollarë për investime në rrugë, në PPP apo të tjera. Kryeministria ka 10 milionë euro më shumë, siç e tha edhe kolegu Murrizi, ose investime të tjera për zyra dhe për jetë luksi. Por nuk është vetëm kjo, është babëzia.

A e dini ju se pjesa më e madhe e këtyre që janë këtu prapa dhe një pjesë e ish-ministrave kanë aq shumë lekë, kanë aq shumë të ardhura, sa dalin jo vetëm për 5 mijë apartamente që u dëmtuan, por edhe për 10 mijë. Ky është hetimi, që nuk bëhet kurrë. Ky është vetingu, që nuk bëhet kurrë. Kjo është ndjeshmëria e madhe e Amerikës dhe e Bashkimit Europain për formimin e SPAK-ut.

Të hetohen dhe do ta shikoni se ku i kanë pasuritë e padeklaruara. Shikoni lejet e ndërtimit! Kaloni tek ish-Parku i Autobusëve. Firmat po bëjnë mbi 3 mijë ndërtesa. Kaloni më tej. Janë mbi 3 mijë të tjera. Kaloni në qendër. Kaloni nga kodrat e Liqenit. Janë mbi 3 mijë ndërtesa. Leje, babëzi. Kush mban përgjegjësi për këto leje të ndërtimit? Po për kolaudimin e tyre? Po për lejet e shkollave që u prishën? Po për shtesat e shkollave “Sami Frashëri” dhe “Emin Duraku”, ku u prenë shiritat? Kush i mban përgjegjësitë? Të pastrojë shkallët lali Eri, sepse nëse do të binin muret e parlamentit, dhe mirë do të ishte të binin..., sepse shumë veta thonë: “Tërmeti dhe fatkeqësia u ra njerëzve të vuajtur, nuk i ra parlamentit dhe qeverisë”. Kot nuk është shprehja: “Nuk bie rrufeja në ...”, por bie tek ata njerëz, sepse po të ishte shembur një pjesë këtu, do të bëhej estradë tjetër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ngrijeni zërin gjithë ditën, sepse jeni të babëzitur dhe e keni shkatërruar këtë vend!

Nëse Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Europian e duan këtë vend dhe investuan për reformën në drejtësi, SPAK-u duhet të fillojë menjëherë. Le të mblidhen të

gjitha dosjet dhe të mos pengohen hetimet e Prokurorisë së Durrësit, të Prokurorisë së Tiranës dhe të Lezhës, sepse kjo është vrasje me paramendim dhe krim i organizuar. Të lirohen nga burgjet njerëzit që janë kapur me 30 gramë drogë, njerëzit që janë dënuar për vjedhje energjie, fukarenjtë dhe të mbushen me oligarkët e lejeve të ndërtimit, që kanë dhënë leje kudo këtu, edhe në Durrës, që fshihen dhe që Shtetet e Bashkuara të Amerikës i kanë nxjerrë *non grata*. Nuk është vetëm një për *non grata*, por janë shumë. E rropën këtë popull, e shkatërruan këtë vend, nuk fryhen, janë të babëzitur.

Vijnë këtu dhe derdhen lot. Pse, për lot është sot? Unë vetëm të jap shpirtin, por këta kanë shumë pasuri. Nuk është problem vetëm një rrogë imja, por këta kanë aq shumë pasuri, sa nuk ua merr mendja gjithë shqiptarëve. Të hetohen! E them me përgjegjësi të madhe: këta kanë mbi 1 miliard dollarë pasuri; të hetohen të gjithë ku i kanë fshehur. Kjo është politika e qelbur dhe ne sot bëjmë *show*-n.

Kryeministri shkon, mbledh fëmijët, ngre fëmijët në ajër, merr lodra, merr një top, i thotë zëvendësit të tij: "Bëj prapa, largohu!". I jep dorën me ironi zëvendësit të përgjithshëm të Policisë, bën ironi me qytetarët, bën sikur vdes me atë mjekër. Nëse ky ka moral dhe dinjitet, lagjeve të Rilindjes të mos u vihen ato emra, sepse është turp! Ç'është kjo rilindje?! Çfarë rilindi në Shqipëri? Rilindën fatkeqësitë? Rilindi shpopullimi? Rilindi droga? Rilindi krimi? Rilindi korrupsioni? Rilindi varfëria? Çfarë rilindi këtu? Çfarë prunë këta? Këta bllokuan edhe negociatat. Nëse ky ka dinjitet dhe moral, të japë dorëheqjen! Për hiçgjë e dha dorëheqjen ai i Maqedonisë, i Greqisë apo i Kosovës, sepse u thirrën si dëshmitarë. Ky nuk ikën. Ky, po nuk i ra tërmeti në kokë, nuk ikën. Nuk pyet ky për tërmetet. Ky bën vetëm *show*.

Tani ka çuar zëvendësministra për të drejtuar shtabet, për propagandë. Ndërkohë që shefi i shtabit, ministrat e suksesshëm rrinë. Çfarë bën tjetër ky? Ka çuar ministrin e Bujqësisë të drejtojë të gjithë shtabin. Pse, çfarë ka rënë? Pulari apo blegtori ka rënë? Është përmbetur ndonjë serë? Ku janë ish-ministrat, zyrtarë të lartë që dinë të drejtojnë operacione? Pse tallen me këtë vend? Është turp! Është bërë për të ikur ky vend. Unë u bëj thirrje të gjithëve. SPAK-u duhet ta ketë detyrë të parë këtë gjë,

vetëm urgjencat. Dëmet janë kolosale. Këta sërish do të vjedhin. Do ta shikoni kush do t'i bëjë ndërtimet.

U bëj thirrje të ndërgjegjshme të gjithëve: u prefshin në paqe familjarët dhe mos paçim më dëme të tilla, por tersin e keni këtu prapa. Ky është kryeoligarku që e shkatërroi këtë vend, e vodhi i babëzitur, prandaj duhet çuar prapa hekurave. Duhet të hetohet! Unë kam qenë oficer policie që 25 vjet. Hetojeni! Bëni vetingun! Shikojani pasuritë, që nuk e dimë ku i ka mbyllur, në Qipro, në Zvicër dhe kudo. Shikojini apartamentet që po bëjnë jashtë vendit. Çfarë bëjnë këta? Bëjnë *show* sot.

Sot na thonë se, midis të tjerave, do të shtyjme edhe Komisionin Hetimor për Presidentin e Republikës. Kërcënime, shantazhime dhe fyerje. Ndërkohë, e dinë shumë mirë që këta bënë tërmet në drejtësi, në gjykata dhe kudo. Këta nuk mbahen. Kjo është e vërteta si drita e diellit.

Kurrë mos paça të ardhme politike, por të ardhme të ketë populli shqiptar! Nuk dua të jem deputet si këta. Kjo është e vërteta. Ky është skandal. Për këtë duhet të qash. Jo të qash për vjedhjet dhe babëzinë e tyre. Këta qajnë pasi ndodhi ky tërmet, sepse i quajtën pa bazë fjalët e Presidentit për parashikimet që bëri greku dhe ua dha institucioneve të shkencës. Disa të tjerë e quajtën të çmendur, disa të marrë. Çfarë bën? Mbyllën disa portale, fyen disa gazetarë. Ç'është ky turp? Ç'është ky skandal? Mirënjohje për vëllezërit kosovarë, që shkuan pas 2 orësh. Këta nuk kishin asgjë, 1,2 milionë euro buxhet. Mësuesin e shkollës e kanë hequr nga puna dhe Shërbimin Sizmologjik, nga inxhinieria, e kanë çuar në Tufinë. Nuk mbahen. Nuk e kanë mendjen te populli. Këta çfarë nuk po bëjnë, por ende nuk po e kuptojnë. Tallen, bëjnë *show*, bëjnë sikur u dhimbsen, bëjnë sikur kanë nga një pagë, 20 apo 100 paga të japin. Unë mund të jap vetëm një garsonierë, por këta, e dini sa mund të japin?

Nuk e kam për Pandin, nuk e kam për Musain apo për ndonjë tjetër të ndershëm, sepse ata janë jashtë, njëri është ministër pa portofol dhe tjetri deputet për të ndenjtur aty si i ndershëm e me radhë, por e kam për shumë të tjerë të babëzitur që e shkatërruan këtë vend. Prandaj, ky të japë dorëheqjen. Boll në vitin 2020 me mjekër; boll me çitjane dhe me mbathje të

shkurta, se latë kokrrën e namit. Shkon me çitjane në festat e të rënëve, të dëshmorëve, atyre që kanë dhënë jetën për lirinë dhe për pavarësinë e këtij vendi. Ky është një turp. Ky është fatkeqësi kombëtare, prandaj ky Kuvend duhet të mblidhet në një seancë të jashtëzakonshme vetëm për këto probleme.

Uroj që Shtetet e Bashkuara të Amerikës...

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Maliqi!

Të nderuar kolegë, jemi në një seancë ku diskutohet një projektligj shumë i rëndësishëm dhe paketa për projektbuxhetin pas një ngjarjeje shumë të rëndë që ka goditur Shqipërinë, por kjo nuk do të thotë që të shkelim etikën. Çdo deputet ka të drejtë të trajtojë pa diskriminim dhe me humanizëm çështjet e zgjedhësve, por, kurrsesi, duke përdorur fjalor fyes dhe denigrues. Ndaj, do t'ju lutesha të diskutojmë dhe të japim sugjerime se si mund ta bëjmë më mirë këtë paketë për t'u ardhur në ndihmë të dëmtuarve dhe familjeve të viktimave, por kurrësesi për të fyer dhe denigruar me këtë fjalor, që nuk është aspak i hijshëm. Faleminderit!

Fjalën e ka ministrja Besa Shahini.

Të përgatitet ministrja Anila Denaj.

Besa Shahini – 8 nxënës humbën jetën si pasojë e tërmetit të javës së kaluar, 4800 nxënës janë prekur nga ky tërmet në forma të tjera, kanë shtëpi të dëmtuara apo të pabanueshme, si dhe 650 mësues janë në një situatë të ngjashme. Kemi 31 shkolla jashtë funksionit, të dëmtuara plotësisht apo të dëmtuara rëndë, që nuk mund të hapen gjatë këtij viti shkollor. Kjo ishte edhe arsyeja pse vendosëm ta shtyjmë fillimin e mësimi dhe t'i rihapim shkollat gradualisht, duke u siguruar që shkollat, të cilat do të hapen, na japin sigurinë se infrastruktura e tyre është në rregull dhe nxënësit aty janë të sigurt.

Në 9 qarqet e Shqipërisë, ku nuk e shpallëm gjendjen e jashtëzakonshme, mësimi filloi më 2 dhjetor. Në qarkun e Durrësit, në Bashkinë e Tiranës, në Bashkinë e Kurbinit dhe në Bashkinë e Vorës mësimi do të fillojë në datën 9 dhjetor, ndërsa në të gjitha bashkitë e tjera, në të cilat nuk filloi mësimi më 2 dhjetor, filloi dje.

Nga data 26 nëntor kemi bërë një kontroll të detajuar të të gjithë infrastrukturës në të tria qarqet, ku kemi shpallur gjendjen e jashtëzakonshme. Inxhinierët e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, që nuk janë shumë

në numër, inxhinierët që erdhën nga Kosova, një grup prej 40 inxhinierësh që erdhën përsëri edhe sot, si dhe inxhinierët e bashkisë, të gjithë janë duke punuar nën ombrellën e Institutit të Ndërtimit, bënë verifikimin e të gjitha shkollave publike dhe jemi në përfundim të verifikimit të të gjitha shkollave dhe kopshteve private.

Për 31 shkollat publike, të cilat janë komplet jashtë funksionit, kemi bërë një plan të detajuar të zhvendosjes së nxënësve në shkolla pritëse. Mësuesit kanë dalë në punë që në datën 2 dhjetor për të bërë dy punë shumë të rëndësishme.

Së pari, për të zbatuar udhëzimin e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë për emergjencat. Kemi bërë një udhëzim që do t'ju vijë në ndihmë të gjithë mësuesve që të bëjnë planin e mbrojtës fillestare të nxënësve, në rast se ka lëkundje në të ardhmen, si dhe planin e detajuar të daljeve emergjente, të cilat janë dalje emergjente klasore, të cilat më pas rakordohen në nivel shkolle që të mos kemi lëndime të nxënësve gjatë daljeve emergjente, në rast se ka lëkundje.

Së dyti, që të krijojnë një ambient të ngrohtë për të mirëpritur nxënësit, si ata të shkollës ku shkojnë në mësim zakonisht, si dhe ata nxënësit që nuk shkojnë në shkollat e tyre, por duhet të zhvendosen në shkolla pritëse.

Masat për rastet emergjente nuk i kemi marrë sepse priten lëkundje të tjera të mëdha, por besoj se duhet të jemi, gjithsesi, të përgatitur për çfarëdo emergjence që mund të ndodhë në të ardhmen.

Shërbimi psiko-social ka qenë në gatishmëri që në ditën e parë. Edhe pse shkollat nuk ishin hapur, i organizuam të gjithë psikologët dhe punonjësit socialë që të gjenden pranë familjeve të prekura, të cilat ishin strehuar në kampe apo në hotele. Tani që shkollat janë hapur, shërbimi psiko-social është duke punuar me nxënësit që janë kthyer në mësim që dje dhe po përgatisin shkollat e tjera me një grup vullnetarësh, që po i vijmë në ndihmë shërbimit psiko-social, që të mirëpresin nxënësit, të cilët do të kthehen në mësim të hënën. Është shumë i rëndësishëm, dhe e kemi cekur disa herë, fakti që jemi duke punuar edhe me 3 udhëzime të ndryshme që mësuesit, psikologët dhe punonjësit socialë duhet t'i lejojnë nxënësit që të flasin për eksperiencën e tyre gjatë kohës së tërmetit dhe

gradualisht të fillojë procesi normal mësimor. Ditën e parë të gjitha shkollat kanë pasur një fleksibilitet në zbatimin e planit mësimor, në mënyrë që tranzicioni nga mosshkuarja në shkollë në kthim nëpër shkollat të jetë sa më i lehtë për të gjithë nxënësit.

Në hotelet ku janë strehuar qytetarët kemi themeluar shkolla të përkohshme. Besoj se kjo është e domosdoshme që nxënësit, të cilët janë strehuar aty, nuk mund të transferohen diku tjetër me lehtësi për shkak të moshave të tyre, të mos humbasin më shumë mësim. Ndaj i kemi grupuar hotelet ku janë strehuar nxënësit, ku kemi edhe numrin më të madh të familjeve. I kemi grupuar në një hotel më të madh, ku do të organizohet shkolla për atë grup hotelesh. Kështu, kemi dy apo dhe tri shkolla të përkohshme në hotelet përgjatë bregdetit, ku kemi vendosur pjesën më të madhe të familjeve të prekura nga tërmeti.

Opozita i quajti komunikimet tona publike si pallavra medietike. Dua të them se këto janë përpjekjet tona për të informuar qytetarët, duke luftuar dhe të gjitha lajmet e rreme që janë shpërndarë në këtë kohë, kanë hapur panik dhe kanë keqinformuar qytetarin në një kohë kur nuk duhet keqinformohet askush. Ndaj, ne do të vazhdojmë të bëjmë këtë informim në rrjetet sociale dhe përmes medieve më tradicionale, derisa ta mbyllim këtë fazë emergjente, të cilën nuk e kemi kaluar ende.

Ata që kanë humbur jetën ne nuk mund t'i kthejmë, por ne mund dhe duhet të kujdesemi për të gjithë nxënësit e tjerë dhe të sigurohemi që shkollat, ku ata vijnë mësimin, të jenë të sigurta dhe mësuesit dhe shërbimi psiko-social të jenë në shërbim të të gjithë nxënësve, në mënyrë që ta bëjnë kthimin në mësim sa më të mirë për të gjithë nxënësit, sidomos të atyre që janë prekur nga tërmeti.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Shahini!

Fjalën e ka ministrja Anila Denaj.

Anila Denaj – E nderuar zonja drejtuese e seancës,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Është shumë e rëndësishme të rifokusohe mi te çështjet kryesore të rendit të ditës, në veçanti te buxheti. Si detyrë funksionale, por edhe për arsye të disa diskutimeve të deritanishme, kam të

jap disa informacione shumë të rëndësishme se çfarë përfaqëson ky buxhet dhe çfarë dimension i po merr ky buxhet i vitit 2020, sidomos në aspektin e reflektimit që po ndodh, si në aspektin e qeverisë, ashtu edhe të Komisionit të Ekonomisë dhe Financave për të adresuar në mënyrën e duhur, të drejtë dhe për të ruajtur parametrat makro-fiskalë për vitin 2020.

Sigurisht, tërmeti i datës 26 nëntor dhe fatkeqësia natyrore që preku vendin tonë krijon një ridimensionim të projektbuxhetit të diskutuar në komisionet parlamentare. Ne, jo pak here, kemi diskutuar ditët e fundit nëse diskutimi i buxhetit do të duhej të ridimensionohej me ndryshime, të cilat, sikurse janë propozuar në media apo edhe këtu pak më parë, do të duhej shkurtonin apo do të duhej të ridimensionin marrëdhëniet kontraktuale të shërbimeve për qytetarët.

Dua të theksoj se për buxhetin e vitit 2020 qeveria dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë mendojnë se është një buxhet, i cili në këtë ridimensionim ka dy elemente shumë të rëndësishme për t'u bërë të qartë dhe për t'u sqaruar më pas në diskutimet nen për nen në komisionet parlamentare.

Së pari, diskutimi që lidhet me faktin se brenda buxhetit të vitit 2020 është menduar dhe do të krijohet një fond për rindërtimin e infrastrukturës së strehimit, e cila, së pari, do të ketë si burim financiar për vitin 2020 nga buxheti i shtetit 0,4 % të produktit të brendshëm bruto, që do të bashkohet me fondet e mbledhura nga donacionet në portalin *e-albania* dhe në llogaritë e thesarit të qeverisë. Një shumë e konsiderueshme është duke u vlerësuar së bashku me Komisionin e Ekonomisë dhe Financave për t'u vendosur në këtë fond të veçantë që në fillim të vitit, në mënyrë që të vlerësojmë edhe nevojën për likuiditet dhe për rritje të borxhit.

Sigurisht, është shumë e rëndësishme të theksojmë që parametrat makro-fiskalë, të cilët gjatë 5-vjetëve të fundit kanë qenë treguesit kryesorë pozitivë të financave publike, do të vazhdojnë të jenë të qëndrueshme edhe për vitin që vjen dhe balanca primare pozitive do të vazhdojë të qëndrojë pozitive në nivelin e 0,25%.

Megjithatë, është shumë e rëndësishme që t'i shikojmë si dy procese, të cilat do të shkojnë dhe do të vlerësohen në nivel të informacionit

dhe të transparencës, paralelisht, si buxheti i diskutuar në parlament, ashtu edhe elementi shtesë, ai i fondit që përmenda pak më parë.

Para se të shkoj te buxheti i vitit 2020, i cili është për diskutim dhe aprovim, dua të falënderoj, së pari, të gjithë qytetarët shqiptarë, të gjitha bizneset shqiptare, të gjithë bashkëkombësit shqiptarë në të gjitha vendet e botës, të cilët kanë dhuruar si në platformat qeveritare, ashtu edhe në platforma të tjera. Pra, është një shenjë shumë e lartë solidariteti. Është e sigurt që ky financim do të ndihmojë jo pak të gjitha familjet në nevojë dhe rindërtimin pas kësaj fatkeqësie natyrore.

Njëkohësisht, më lejoni të falënderoj të gjithë bashkëpunëtorët dhe institucionet ndërkombëtare, të cilat, në një komunikim të drejtpërdrejtë që kam bërë si ministre e Financave dhe Ekonomisë në ditët që pasuan këtë fatkeqësi, kanë shprehur gatishmërinë për të mbështetur dhe për të ndihmuar në disa aspekte. Të gjithë janë të gatshëm për të ndihmuar dhe për të mbështetur Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për të realizuar objektivat e saj madhorë.

Më lejoni të theksoj se në buxhetin, që është sot për miratim në parim në këtë seancë dhe para jush, të nderuar deputetë, është e rëndësishme të theksojmë disa elemente shumë të rëndësishme, për të cilat ne kemi diskutuar në komisionet parlamentare, si ruajtja e indikatorëve të financave publike, duke mbajtur investimet në nivelin e 4,7% të produktit të brendshëm bruto dhe duke u fokusuar në sektorët prioritarë, të cilët janë theksuar edhe në komisionet parlamentare, siç është: arsimi, shëndetësia dhe bujqësia, për të cilët ne kemi diskutuar në zëra të veçantë se çfarë nënkupton rritja e investimeve në këta sektorë.

Është e nevojshme të theksohet një informacion, në kuadër edhe të transparencës: asnjë nga këto investime nuk do të preket dhe është e rëndësishme të themi se të gjitha këto investime mbështesin sektorin e arsimit.

Së pari, mbështetje e vazhdueshme për studentët në kuadër të “Paktit me Universitetin”.

Së dyti, tekste shkollore falas për rreth 230-250 mijë nxënës.

Së treti, ndërtime të reja apo rikonstrukcione për mbi 180 objekte arsimore (po flasim vetëm për buxhetin që kemi diskutuar

në parim, që e kemi për aprovim sot, nuk po flasim për fondin e ndërtimit, i cili do të jetë në zhvillim i detajuar, por do të jetë përtej këtyre shifrave që po flasim).

Së katërti, transportin e 28-30 mijë nxënësve, djem dhe vajza, që i kanë vendbanimet mbi 2 kilometra larg nga shkollat.

Së pesti, 1300-1400 nxënës, djem dhe vajza, të arsimit parauniversitar nga shtresat sociale në nevojë me kuotë ushqimore.

Së gjashti, uljen e madhësisë së grupeve të fëmijëve në kopshte, nga raporti aktual mesatar 18 fëmijë për një edukatore, në raportin 15 fëmijë për një edukatore, duke siguruar 440 edukatorë shtesë për vitin 2020.

Sektorit i shëndetësisë.

Së pari, rikonstrukcionin e 120 qendrave shëndetësore për vitin 2020.

Së dyti, ilaçe të rimbursuara për 1000 pacientë më shumë sesa vitet më parë, një efektivitet të shtuar në shërbimet shëndetësore, rritjen e numrit të pacientëve, të cilët do të vijnë të marrin kontrollin bazë, *check-up* falas, nga më shumë se 475 mijë pacientë në vit, si dhe një shërbim cilësor dhe gjithëpërfshirës për më shumë se 50% të nënave të reja dhe mbi 80% të foshnjave, vajza e djem.

Bujqësia do të jetë po ashtu një prioritet i shtuar, ku një vëmendje të veçantë ka pasur dhe do të ketë, edhe pas diskutimeve që jemi duke bërë, siguria e digave dhe baseneve ujore, për të cilat jo vetëm për situatën aktuale, që na ndërëgjegjëson edhe më shumë, por edhe në projektbuxhetin e vitit 2020 kishte një vëmendje shumë të rëndësishme, me gati 1 miliard lekë investime vetëm në këto formate investimesh për të mundësuar që programi i infrastrukturës, ujitjes dhe kullimit të jetë i mundur të parandalojë fatkeqësi dhe të mos reagojmë vetëm pas fatkeqësive.

Në infrastrukturën rrugore për periudhën 2020 e më tej synohet kompletimi i disa segmenteve rrugore me financim të brendshëm, si: Kardhiq – Delvinë, Elbasan – Banjë, bajpasi Shkodër, bajpasi Tepelenë dhe një pjesë e mirë e Unazës së Tiranës, të cilat në dy vjetët e ardhshëm shihen të kompletuara. Në aspektin e infrastrukturës rrugore synohet rritja e sigurisë rrugore në të gjithë akset kombëtare, ulja e numrit të aksidenteve me pasojë humbje jete

njerëzish, si dhe numri i pikave të zeza me 23%, sipas strategjisë kombëtare të transportit.

Buxheti i vitit 2020 do të plotësojë, gjithashtu, të gjitha nevojat financiare të institucioneve të reja të krijuara nga paketa e reformës në drejtësi. Më lejoni të theksoj se vetëm në vitin 2019 fondi për të realizuar ngritjen e këtyre institucioneve, në aspektin e fondeve të pagave dhe gjithë infrastrukturës për këtë qëllim, ka qenë 2,6 miliardë lekë dhe së bashku me 1,3 miliardë lekë të vitit tjetër, ky fond merr një vëmendje të shtuar me një vlerë prej 3,9 miliardë lekësh. Është e rëndësishme të theksojmë se ky është një parakusht për të realizuar një reformë të suksesshme në drejtësi, me një strukturë të plotë në të gjitha elementet e saj.

Shpenzimet e fondeve speciale, që përfshijnë shpenzimet totale për fondet e sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe kompensimin në vlerë të ish-pronarëve, nuk preken dhe për vitin 2020 vijnë të planifikohen në vlerën prej 188,6 miliardë lekësh. Niveli i shpenzimeve për skemën e sigurimeve shoqërore për vitin 2020 parashikohet në masën 137,5 miliardë lekë ose 7,7% e PBB-së, raport pothuajse i njëjtë me atë të vitit 2019, nga e cila për indeksimin e pensioneve është parashikuar një fond prej 2,5 miliardë lekësh.

Duhet të theksoj se kjo skemë i rëndon më pak buxhetit të shtetit dhe është një element i rëndësishëm i zhvillimit të 5-6 vjetëve të fundit si pasojë e dy faktorëve kryesorë: së pari, uljes së nivelit të informalitetit në tregun e punës dhe, së dyti, rritjes së nivelit të punësimit dhe kontribuesve. Kjo skemë mbështetet me më shumë fonde nga kontributorët sesa nga buxheti i shtetit. Gjithashtu, për vitin 2020 kjo skemë në buxhetin e saj përfshin mbulimin e efekteve financiare të skemave të reja të përfitimeve, për naftëtarët dhe minatorët, të cilat pas rishikimit parashikohet të sjellin një efekt financiar të harmonizuar prej rreth 1,45 miliardë lekësh dhe mbështetjen me të ardhura mesatarisht të 744-792 mijë personave, që kanë përfituar dhe përfitojnë pensione publike, pensione suplementare, si dhe një sërë të ardhurash të tjera të parashikuara me ligje dhe vendime të veçanta, si dhe vendime kompensuese të Këshillit të Ministrave. Numri mesatar i kontribuesve në skemën e sigurimeve shoqërore parashikohet mbi

820 mijë persona, me një rritje në masën 4% më shumë se i pritshmi i vitit 2019.

Në skemën e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2020 janë parashikuar rreth 44 miliardë lekë ose 2,5% e PBB-së, nga rreth 42 miliardë lekë të parashikuara në fund të vitit 2019. Edhe për vitin 2020 për skemën e rimbursimit të barnave parashikohet një tavan prej 11 miliardë lekësh për të mundësuar një efektivitet të këtij shërbimi, sikurse edhe një përdorim aty ku është nevoja.

Fondi për kompensimin në vlerë të pronarëve parashikohet në total rreth 4,5 miliardë lekë. Nga rreth 1,9 miliardë lekë që fondi ishte në vitin 2013, ky fond, i cili është rritur nga viti në vit, sipas projeksioneve të bëra në nivel afatmesëm, parashikohet që në vitin 2022 të shkojë në 5,5 miliardë lekë. Rritja e fondit të kompensimit në vlerë të pronarëve bëhet në mbështetje të reformës së ndërmarrë nga qeveria për trajtimin e ish-pronarëve, pjesë e së cilës është edhe kompensimi në vlerë për t'u realizuar brenda periudhës 10-vjeçare, të parashikuar edhe në ligj.

Shpenzime të tjera sociale janë programuar në masën 24,6 miliardë lekë, të cilat përfshijnë shpenzimet për pagesën e papunësisë, në nivelin 600 milionë lekë. Dëshiroj të theksoj këtu se shpenzimet për këtë zë kanë ardhur në rënie të vazhdueshme që prej vitit 2014, kur shënuan vlerën prej 900 milionë lekësh. Është e rëndësishme të theksohet se ky është një rezultat pozitiv jo në kontekstin e efektit buxhetor, por në aspekt të shifrave, që janë të dukshme drejt elementit pro-punësim, ku ne kemi regjistruar nivelin më të ulët të papunësisë në vitin korrent, i cili parashikohet të jetë po aq pozitiv edhe vitin e ardhshëm.

Shpenzimet për pagesën e ndihmës ekonomike dhe personave me aftësi të kufizuar janë parashikuar në nivelin 21 miliardë lekë. Për rritjen e eficiencës dhe efektivitetit të këtyre dy skemave, të cilat zënë një pjesë të konsiderueshme të shpenzimeve totale buxhetore, aktualisht po bashkëpunohet me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në mënyrë që të kemi një kalim efektiv të personave nga njëra skemë, ajo e mbështetjes sociale, te skema e mbështetjes me punësim dhe integrimin në tregun e punës në mënyrë të plotë. Ne besojmë se ky bashkëpunim dhe të gjitha

politikat për të adresuar këto nevoja kanë realizuar një mbështetje të të dy komponentëve.

Niveli i fondit rezervë për vitin 2020 planifikohet në masën 1,7 miliardë lekë, ku përkatësisht 1,4 miliardë lekë fond rezervë në Këshillin e Ministrave dhe 300 milionë lekë fond kontigjence për financimin e reformës në sistemin e drejtësisë.

Te buxheti i pushtetit vendor për vitin 2020 dua të ndalem shumë pak, por është një pjesë e rëndësishme e buxhetit, e cila në vite ka treguar se e gjithë reforma ka filluar të japë frytet e saj, sepse parametrat e eficiencës dhe rritjes së të ardhurave janë pozitive. Këta parametra janë të pandryshuar për vitin 2020, duke shënuar një nivel total prej 57 miliardë lekësh ose rreth 5,7 miliardë lekë më shumë sesa fondet që ishin për vitin aktual, vitin 2019.

Njëkohësisht, dua të ftoj të 61 bashkitë të miratojnë buxhetet e tyre, të miratojnë njëkohësisht edhe të gjithë paketën që ndihmon në procesin e vendosjes së kadastrës fiskale në rrugën e operacionalitetit të plotë, si dhe marrjen e masave, që në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë të realizojmë zbatimin e një projektligji, i cili, në afatmesëm, do të krijojë jo pak fonde për pushtetin vendor dhe efektivitet më të lartë të shpenzimeve buxhetore.

Siç e thashë edhe në fillim të diskutimit në prezantimin e buxhetit, ky prezantim në të gjithë komponentët e tij, të cilat i përmenda më sipër, nuk është aspak i ndryshëm në vlera nga ai që kemi diskutuar në komisionet parlamentare. I vetmi ndryshim që ne do të diskutojmë në komisionet parlamentare nen për nen është zëri i projekteve të reja. Pse do të diskutohet?! Sepse mendojmë se projektet e reja përpara tërmetit kanë pasur një adresim nevojash jashtë kësaj situatë dhe, aktualisht, të gjitha projektet e reja do të duhet të ridiskutohen në Komisionin e Financave dhe Ekonomisë për t'u riadresuar aty ku është e nevojshme që të përmirësohen si masa parandaluese për situatë të ngjashme ose fatkeqësi të tjera natyrore, ashtu edhe për të ndihmuar institucione të caktuara, të cilat do të kenë nevoja imediate. Theksoj edhe një herë që fondi do të jetë më vete, do të ketë një moment tjetër për të sqaruar për fondet që mbledhen nga donacionet në momentin aktual, ashtu edhe për fondet në vijim.

Transparenca është një element shumë i rëndësishëm çdo ditë, jo vetëm në momentet e kësaj situatë. Ministria e Financave dhe Ekonomisë për portalin e-albania dhe për të gjitha donacionet që merren nëpërmjet llogarive të thesarit dhe ato në Bankën e Shqipërisë ka në faqen e saj të internetit një rubrikë të veçantë, ku informacioni përditësohet çdo ditë për donacionet e mbledhura, si edhe për shpenzimet që kanë ndodhur deri tani. Shpenzimet që kanë ndodhur deri tani nuk janë mbështetur nga fondet e këtij donacioni, por ato që do të prezantoj në vijim janë pjesë e pikave 9-12 të rendit të ditës dhe janë aktet normative, që qeveria i ka miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, i ka sjellë në parlament për aprovim, janë me mbështetje buxhetore dhe janë pjesë e një pakete të plotë, që mendohet të konsolidohet gjatë këtyre javëve, përveç akteve normative që kemi sjellë sot për miratim. Pse?! Sepse janë akte të emergjencës, të mbështetura totalisht me mbështetje buxhetore, ku ne çdo javë jemi duke parashikuar akte të tjera, të cilat do të mbështesin faza të dyta dhe të treta të kësaj situatë.

Më lejoni të kaloj te pikat 9 dhe 12 e rendit të ditës për të saktësuar disa informacione për aktet normative, të cilat kanë ardhur në mbështetje të fatkeqësisë natyrore. Pak më parë zëvendëskryetari përmendi disa nga këto ndryshime ligjore, siç janë: e drejta për pension të posaçëm për qytetarët pensionistë, që kanë humbur të afërmit nga tërmeti; e drejta për trajtim financiar të veçantë për të mbijetuarit e familjeve me humbje fatkeqe në njerëz; e drejta për ndihmë financiare për familjet e të gjithë viktimave në masën një milion lekë; e drejta për mbulimin e shpenzimeve funerale për të gjithë viktimat e këtij tërmeti; e drejta për bursë, në masën 15 000 lekë në muaj, për nxënësit, të cilët ndjekin arsimin parauniversitar dhe arsimin e mesëm profesional në institucionet arsimore publike, banesat e të cilëve janë shpallur të prishura apo të pabanueshme në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë.

Përtej këtyre masave, janë marrë edhe disa masa të tjera, konkretisht:

Së pari akti normativ “Për disa shtesa në ligjin nr.92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”, i cili ka për qëllim përjashtimin nga detyrimi i pagimit të tatimit mbi vlerën e shtuar për mallrat dhe për

pajisjet e projektuara posaçërisht, ose të përshtatura për qëllime ushtarake dhe që përdoren si armë, municion apo bazë materiale për luftë dhe që janë projektuar, zhvilluar, prodhuar, montuar apo janë modifikuar për përdorim ushtarak, përfshirë ato të cilat importohen në emër të Ministrisë së Mbrojtjes. Qëllimi kryesor i aktit normativ është edhe përfshirja në përjashtimet nga pagesa e TVSH-së e mjeteve dhe pajisjeve, të cilat përdoren për të rindërtuar zonat e prekura nga fatkeqësitë. Këtë përjashtim ne e kemi kufizuar vetëm në rastet dhe afatet e shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore.

Së dyti akti normativ “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar”. Përmes këtij akti normativ Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka mundësuar rritjen e nivelit të njohjes së shpenzimeve të zbritshme nga 3% në 8%, për donacionet të bëra nga bizneset. Pra, siç e tha edhe zoti Murrizi, është e vërtetë që shpenzimet e zbritshme në masën nga 3% në 8% do të mund të përfitohen vetëm nëse donacioni do të adresojë llogaritjet e vëna në dispozicion nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, sepse për këto donacione qeveria do të jetë duke adresuar nevojat dhe do të duhet që këtë informacion ta kanalizojë respektivisht për të gjithë të interesuarit. Është shumë e rëndësishme të mendohet se si ky incentiv i rritjes së donacioneve të mos përdoret në kontekstin negativ, por të përdoret në atë pozitiv. Ky akt nuk është vetëm për ndihmat monetare financiare, por edhe për ato që kanë të bëjnë me pasuritë e paluajtshme.

Së treti akti normativ për dhurimin e 17 apartamenteve në pronësi të Bashkisë së Tiranës për familjet e viktimave të tërmetit të datës 26.11.2019

Së katërti akti normativ “Për disa shtesa në ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar” i cili synon shtimin e një dispozite me efekt të menjëhershëm dhe të përkohshëm, i cili parashikon trajtimin e veçantë financiar të personave që kanë humbur familjarët e tyre si pasojë e tërmetit. Kjo dispozitë, për trajtimin e veçantë financiar, krijon mundësinë ligjore për dhënien e një ndihme me karakter të përhershëm për të gjithë personat që kanë humbur pjesëtarët

e familjes së tyre nga fatkeqësia natyrore. Këto trajtime sigurohen nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe do të ndiqen me vendime nominale të Këshillit të Ministrave.

Më lejoni që në fund të fjalës sime të shpreh falënderimet për të gjithë ata që kanë dhuruar e vazhdojnë të dhurojnë! Ndërkohë, çdo informacion që lidhet me këto shuma, merret në portalin e-albania, sikurse edhe informacionet që lidhen me shpenzimet e bëra deri tani nga buxheti i shtetit, janë online dhe do të jenë edhe për aspektin buxhetor, një detyrim për të raportuar në kohë reale çdo zë shpenzimi dhe çdo zë që merret në formën e donacioneve, por edhe fondi i veçantë, i cili krijohet brenda kuadrit të buxhetit 2020, do të ketë një ndjekje rigorozë si në raportin e të hyrave, që është zëri i burimit të të ardhurave, ashtu edhe në zërin e shpenzimeve, duke adresuar në mënyrë të drejtpërdrejtë kërkesën e domosdoshme dhe të mirëkuptuar për një transparencë të plotë.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Denaj!

Fjalën e ka deputeti Nimet Musaj. Të përgatitet deputeti Kostaq Papa.

Nimet Musaj – Faleminderit, e nderuar zonja drejtuese e seancës!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Në mënyrë të veçantë, të dashur qytetarë të Durrësit, të Thumanës, të Laçit, të Lezhës dhe të Tiranës, që ndjetë në shtëpitë tuaja të dridhurat pak ditë më parë, kur tërmeti ju preku jo vetëm shtëpitë dhe familjet, por më keq akoma, jetën e familjarëve, të miqve dhe të afërmeve tuaj.

Unë e di mirë se sot politika është e fundit që ju doni të dëgjoni, por di edhe që politika ose thotë sot atë që ju doni të dëgjoni, ose nuk duhet të flasë më kurrë. Sot politika po flet më shumë se kurrë. Unë e di mirë se sot politikanët janë të fundit që ju doni të shihni, por sot mundësi tjetër të dytë nuk ka: ose ne politikanët e shohim jetën me sytë tuaj, ose nuk na duhet besuar më; sot është e kundërta. Unë e di mirë, edhe prej përvojës si prind, edhe prej një përvoje të gjatë në politikën lokale, se jeta shpesh të sjell mundësi të dyta.

Në datën 26 nëntor, në portën tonë perëndimore, në Durrësin tonë, që na lidh me detin dhe Europën, na ra një fatkeqësi e madhe, e cila mori jetë shqiptarësh. Ajo fatkeqësi solli

rrënim. Ajo fatkeqësi solli shkatërrim. Ajo fatkeqësi na gjeti në pabesi dhe ra mbi të gjithë ne pa dallim. Ndaj asaj fatkeqësie nuk hakmerremi dot, por mundësia që kemi na vjen vetëm një herë në jetë.

I nderuar Kryeministër i vendit tim,

Kemi mundësinë për t'u ringritur, kemi mundësinë për t'u rimëkëmbur, kemi mundësinë për t'u ringjallur, kemi mundësinë për të rindërtuar, kemi mundësinë për t'u ringritur fizikisht, edhe pse jetët e humbura ne nuk i rikthejmë dot. Por në këto ditë të vështira për vendin tim, si deputet, e kam detyrim moral dhe qytetar të jem në krah të të gjithë të prekurve nga kjo fatkeqësi e madhe.

Unë e di që qeveria shqiptare ka një plan të shkëlqyer, ndaj unë do ta mbështes. Qeveria dhe ju, zoti Rama, u keni dhënë shqiptarëve mesazhin e sigurisë, mesazhin e qetësisë dhe të durimit, por, mbi të gjitha, mbështetjen e pakufizuar për zgjidhjen e këtyre problemeve të mëdha që na la tërmeti.

Kam detyrimin moral të mbështes Kryeministrin e vendit tim, sepse e shoh praninë e tij aty ku duhet: në Durrës, në Thumanë, në Laç, në Lezhë dhe kudo tjetër.

Gjithashtu, dua të vlerësoj dhe të përshëndes atë që deri dje ne, deputetët e këtij krahu, na quante të paligjshëm dhe jokushtetues, kryetarin e opozitës, zotin Basha. Kam detyrimin e moralit prej kombëtaristi, ndryshe nga sa instinkti i politikanit më thotë, që ta përshëndes dhe ta mbështes pajtimin dhe afrimin e kryetarit të qeverisë sonë me kryetarin e opozitës.

Rrënimet mund të jenë të pjesshme, por ringritjet e pjesshme janë rrënime të ardhshme, ndaj për ringritje të plota duhet të jemi bashkë: opozitë dhe maxhorancë; patjetër që këtu kam parasysh edhe opozitën jashtëparlamentare.

Është koha për t'u ringritur, përndryshe çdo vonesë na mbyt dhe na asfikson. Është koha për një plan konsensual të menaxhimit të territorit. Është koha për një plan kombëtar kontrollues dhe rindërtues të banesave të shqiptarëve. Është koha për një plan kombëtar të menaxhimit të fatkeqësive natyrore. Është koha të ulim gjakrat. E ardhmja na dënon ta bëjmë këtë gjë.

Ndaj në këtë foltore po dal kundër instikut tim prej politikanit, vetëdija e të cilit nuk është një takim i opozitës jashtëparlamentare me

Kryeministrin Rama. Pra, ç' hyjnë instinktet e politikanit, kur unë pashë në Vlorë dhe në Fier të majtë e të djathtë, që ishin bashkë dhe në gatishmëri për vëllezërit e tyre në nevojë?! Vetëm ta shihnit si rrinte pezull shpirti i ndjeshëm i vlonjatëve, që prisnin mbarimin e lajmeve të këqija nga Durrësi, ku edhe në datën 28 Nëntor, në Ditën e Flamurit, në festën e Çlirimit, Kryetari i Kuvendit, zoti Ruçi, kryetari i bashkisë, prefekti, kryetari i qarkut dhe deputetët e këtij qarku, të cilët ishin kthyer nga sistemimi që u kishin bërë natën qytetarëve në hotelet përkatëse për t'u ardhur në ndihmë.

Sa për Fierin, qytetin nga unë vij, biznesmenë të fushave të ndryshme dhe kryetari i Dhomës së Tregtisë u solidarizuan menjëherë dhe, përveç kontributeve në ushqime dhe veshmbathje, i ndihmuan edhe financiarisht banorët e zonave të dëmtuara.

Si deputet i Kuvendit, ju inkurajoj për këtë nismë dhe për gjithçka që po bëni, të nderuar biznesmenë të qytetit të Fierit, madje roli im i dorës së parë do të jetë që çdo qindarkë juaja të menaxhohet dhe të kontrollohet nga qeveria në mënyrë korrekte dhe me transparencë, siç ju e kërkuat në takimin e zhvilluar në Fier së bashku. Pa dyshim që Kryeministri dhe qeveria do ta bëjnë këtë gjë në ditët në vazhdim.

Të nderuar biznesmenë, faleminderit për gjithçka që po bëni dhe që po tregoni se sipërmarrja ju ka afruar dhe nuk ju ka distancuar nga rrënjët popullore!

Por sot, të majtë dhe të djathtë, në Veri, në Lindje, në Shqipërinë e Mesme dhe kudo, të gjithë janë bashkë dhe gati për ringritjen kombëtare.

Solidariteti i vëllezërve të Kosovës, i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, i Bashkimit Europian dhe i të gjithë miqve ndërkombëtarë na mësoi se sa i madh është njeriu, por edhe sa e vogël dhe sa shpërblyese duhet të jetë politika përpara këtij njeriu. Kjo energji e solidaritetit duhet të jetë historia jonë e ardhshme.

Edhe një herë, e përsëris, përshëndes qëndrimin dhe punën e Kryeministrit, punën e qeverisë; përshëndes qëndrimet e kryetarit të opozitës dhe e inkurajoj që në të njëjtën linjë të ulet për të shkruar historinë e rimëkëmbjes!

Tani, të nderuar kolegë, jemi edhe në prag të buxhetit, ku rikontrolli dhe rindërtimi i këtij buxheti duhet të jenë kryefjala jonë. Ju

kërkoj ndjesë, sepse dola edhe nga rendi i ditës, edhe nga rreshtimit politik që kemi?! Por më duhet ta them, të nderuar kolegë, ç'hyjnë instinktet e politikanit kur unë, si djalë i komunitetit çam nga vij, e respektoj ngrohtësinë e shqiptarit vëlla, që të pret në shtëpi, që të hap shtëpinë, të ngroh zemrën e shpirtin, por kurrë nuk e zëvendëson shtëpinë që ta shkatërroi Zoti ose, në rastin e komunitetit nga unë vij, njeriu?!

Shkatërrimi i gurëve të shtëpisë është çarja e shpirtit dhe qeveria, të nderuar qytetarë, do t'i rindërtojë shtëpitë e dëmtuara nga tërmeti. Në fakt, ne duhet ta bëjmë të gjithë së bashku Shqipërinë e ngrohtë për këta shpirtra të lënduar, pasi humbja e të afërmit është trazim dhe turfullimë e shpirtit. Ndaj ne duhet ta bëjmë Shqipërinë një shtëpi të ngrohtë për t'i shëruar këto plagë, pasi kjo ngrohtësi e zbut dhe e mbush me dashuri njeriun. Për këtë na duhet bashkimi dhe bashkëpunimi që nis nga sot, nga këtu.

Dua t'ju përshëndes dhe t'ju vlerësoj të gjithë ju, të nderuar kolegë, të majtë dhe të djathtë, që në këto ditë të vështira u ndodhët prezentë dhe mbështetët në çdo shtëpi, në çdo familje, në të gjitha zonat dhe i ndihmuat sadopak këta banorë, duke u qëndruar pranë dhe duke bërë atë që na takon të bëjmë.

Dua të përshëndes nga zemra kolegen time Edlira Hyseni, një qytetare të Durrësit, që me zemrën e saj foli sot këtu në këtë sallë dhe premtoi se të gjithë së bashku ne, të nderuar deputetë, qeveria po e po, nuk do të bëjmë vetëm Durrësin, por të gjitha zonat e dëmtuara.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Musaj!

Fjalën e ka deputeti Kostaq Papa. Të përgatitet ministrja Ogerta Manastirliu.

Kostaq Papa – E nderuar zonja drejtuese e seancës,

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur motra dhe vëllezër shqiptarë,

Në radhë të parë, më lejoni që në emër të familjes sime, në emrin tim personal, në emër të emigracionit dhe të diasporës shqiptare, të shpreh ngushëllimet për viktimat e familjeve shqiptare nga kjo tragjedi e madhe e fenomenit natyror! Jemi me ta, do të jemi me ta në vitin 2019, në vitin 2021, në vitin 2025 dhe në vitin 2030, derisa të mbarojë rimëkëmbja e tyre

familjare dhe ekonomike; do të jemi me ta gjithmonë të mbështetur në devizën se emigracioni dhe diaspora nuk do t'i lërë kurrë vetëm Shqipërinë dhe shqiptarët!

Në fjalën time do të ndalem në buxhetin që ka lidhje me tërmetin, sepse për buxhetin në përgjithësi ne kemi folur nëpër komisione, i kemi shqyrtuar dhe do të vazhdojmë t'i shqyrtojmë.

Ashtu siç edhe për buxhetet e viteve 2018, 2019 dhe për atë të vitit 2020, unë ngelem më kritikë, jo për faktin e kundërshtisë politike apo të opozitarizmit, por për arsye të shumta, sidomos pas arsyes madhore tronditëse të fatkeqësisë natyrore të 26 nëntorit, që e bën shqyrtimin e buxhetit të vitit 2020 t'i kalojë në lupë të gjithë treguesit dhe për të krijuar mundësinë që gjendja e jashtëzakonshme e tërmetit të dalë nga amullia dhe jeta e banorëve të qarqeve Tiranë, Durrës, Lezhë e të tjera të dalë nga ankthi dhe të lëvizë në kahun e përmirësimit, sepse me solidaritetin kombëtar ndër shqiptarë, por edhe me solidaritetin ndërkombëtar dhe me ndihmat janë të gjitha mundësitë që çdo qindarkë të përdoret me nikoqirllëk dhe planifikim që ndihma, kontributi dhe donacioni të arrijnë te qytetari i dëmtuar, te përmirësimi i institucionit publik, sidomos në qarqet me gjendje të jashtëzakonshme.

Duke qenë se ngjarja e jashtëzakonshme e fenomenit natyror, pra tërmeti, na kapi në momentin e përgatitjes së buxhetit të vitit 2020, duhet të tregohemi të kujdesshëm në planifikimin dhe në përmirësimin e tij.

Duke qenë se gjendja e shkakuar nga tërmeti dhe pasojat e tij në jetën e qytetarëve nuk zgjidhen brenda një pesëvjeçari, brenda një afati të shkurtër, por për një periudhë mbi pesë vjet apo edhe më shumë, buxheti i vitit 2020 mund të trajtohet në disa variante lidhur me ndërhyrjen në të për tërmetin. Kështu, mund të ishte më mirë planifikimi i një buxheti më vete për tërmetin, me shtrirje disavjeçare, i pavarur, por në ndërthurje me buxhetet e viteve 2020, 2021 e në vazhdim, pra krijimi i një buxheti suplementar, shtesë për problematikën e tërmetit. Ky buxhet të jetë i shtrirë në kohë dhe në hapësirë, pra të ketë një shtrirje në vitet 2020, 2021, 2022 dhe më tej. Buxheti për tërmetin të ketë të përfshirë të gjithë treguesit (do t'i përmend më poshtë); duhet të ketë një tregues financiar, pavarësisht se ne këtu bëjmë një shprehje politike të problematikave që

kanë lidhje me buxhetin. Buxheti për tërmetin, gjithashtu, duhet të përfshijë: asistencën direkte familjare të familjeve me viktime, të familjeve të pastreha nga tërmeti dhe të familjeve me objekte të riparueshme; asistencën mjekësore në vazhdimësi të zonave dhe të vendbanimeve, qyteteve dhe fshatrave, të banorëve të prekur nga tërmeti dhe asistencën e sëmundjeve kronike të tyre; asistencën e akomodimit hotelierik dhe trajtimin ushqimor të familjeve dhe individëve; asistencën tekniko-inxhinierike për objektet që i takon shtetit të kontribuojë; shmangien e kontributit shtetëror apo të parave buxhetore në favor të bizneseve të ndërtimit dhe kushtëzimin që objektet e tyre të dëmtuara firmat dhe investitorët e ndërtimit t'i vetërregullojnë me financat e tyre dhe të ketë kontroll teknik publik mbi ta; asistencën e materialeve të ndërtimit për objektet që i takon shtetit të kontribuojë; asistencën e organizimit të administrimit qendror dhe lokal për koordinimin e të gjitha veprimeve fizike në terren, e përkthyer kjo në fonde nga buxheti. Buxheti për tërmetin të ketë për përdorimin e fondeve përcaktimin e një shtrirjeje kohore të asistencës që mëkëmb, mbështet dhe çon drejt normalitetit jetësor, familjar dhe shoqëror të të prekurve nga tërmeti, që duhet të jetë mbi pesë vjet deri në dhjetë vjet (periudha bazë) dhe elementet e asistencës të vazhdojnë për të gjithë jetën për familjet e viktimave apo të dëmtuarve rëndë nga tërmeti, por si të drejta të patransferueshme tek të tjerët. Buxheti për tërmetin të ketë shtrirje hapësinore për financimin nga vatra bazë e tërmetit në rast ciklik dhe centrik, me drejtim jashtë kësaj zone (pra vatrave bazë, pra edhe jashtë qarqeve me gjendje të jashtëzakonshme, pra edhe jashtë këtyre qarqeve), sepse, siç u pa, pati dëmtime edhe në qarkun e Elbasanit, edhe në qytetin e Lushnjës, që i përket qarkut të Fierit.

Buxheti për tërmetin duhet të ketë edhe një përhapje selektive të veprimeve teknike, në bazë të rëndësisë për shembjen, pastrimin, ndërtimin dhe përmirësimin e objekteve. Pra, nëse financohen objekte në zonën e prekur të Kënetës, Durrësit dhe Thumanës, në të njëjtën kohë me to mund të financohen edhe objekte në Shijak, Lezhë dhe Elbasan, duke i selektuar objektet për nga rëndësia publike, shoqërore, humane, shëndetësore, arsimore e të tjera. Buxheti për tërmetin duhet të përmbajë asistencën e

infrastrukturës për zhvillimin e jetës së përditshme familjare, shkollë, të punësimit dhe pushimit, pra, fonde për transportin për të shkuar në punë, shkollë, fond për zhvillimin familjar apo edhe linja për lëvizje të përbashkëta. Buxheti për tërmetin duhet të përmbajë asistencën e antikorupsionit për mbrojtjen e fondeve për të rifituar besimin e humbur te qytetari.

Nëse buxheti i tërmetit është buxhet suplementar, pra, i shkëputur nga buxheti i vitit 2020 (ashtu duhet të jetë, sepse do të veprojë edhe pas vitit 2020), ai mund të përfshijë në përbërjen e tij, shtrirë në kohë dhe hapësirë, donacionet e FMN-së. Sasia vjetore që i përket Shqipërisë është rreth 87 milionë dollarë, nëse nuk gaboj. Po ashtu mund të përfshijë edhe donacionet e SHBA-së, BE-së, donacionin 15 milionë euro nga Europa, që u shpall dje nga zonja Ursula von der Leyen, që është hapi i parë i saj (ky fond do të pasohet nga fonde të tjera në ditët që do të vijnë), pra, mund të përfshijë fondet shtetërore, përdorimi i të cilave duhet të jetë i pasqyruar grafikisht në kohështrirje dhe hapësirë dhe i lexueshëm gjatë përdorimit.

Buxheti i tërmetit nuk duhet të përfshijë donacione, financime private e të solidaritetit komunitar, të cilat duhet të shkojnë direkt tek të dëmtuarit, për të ndikuar në kthesën jetësore pas goditjes fatale që pësuan. Mirë do të ishte t'i bëhej shtesë buxhetit të vitit 2019 për fazën e parë humanitare dhe stabilizimin e situatës deri në fund të vitit.

Fondet që do të alokohen për veprimtarinë e planifikuar të zhvillimit, për kthimin në normalitet të jetës në vtrat e dëmtuara në Durrës, Kënetë, Thumanë, Shijak, Tiranë, Vorë, Laç, Lezhë, Kavajë e të tjerë, duhet të përfshihen në buxhetin suplementar. Përcaktimi i buxhetit suplementar për tërmetin do të ndikonte që buxheti i vitit 2020 të mos shikohej si buxhet pa investime për veprat e infrastrukturës strategjike e me rëndësi kombëtare, që buxheti i vitit 2020 të mos shikohej si siamezi i 19-ës dhe 18-ës, që të mos pengohen korridoret rrugore në Rrugën e Arbrit drejt Peshkopisë dhe Dibërës, të rrugës Qukës – Qafë Plloçë drejt Korçës, të rrugës dhe tunelit të Qafë-Skërficës drejt Delvinës, Sarandës dhe rrugës bregdetare tej Orikumit.

Që Shqipëria të mos vonohet në ngritjen e saj, të mos vonohet dalja nga gjendja e jashtëzakonshme, përmes buxhetit të vitit 2020

dhe buxhetit të tërmetit duhet të tregojmë seriozitet për daljen nga situata, mbështetje humanitare, por edhe vizion në planifikimin hapësinor, urban, bashkëkohor dhe perspektivë që shërbimi njerëzor dhe vlerat e ndërtimit urban t'i përkasin shoqërisë, t'i rezistojnë kohës dhe t'i vlejnjë historisë.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Papa!

Fjalën e ka ministrja Manastirliu. Të përgatitet deputetja Fatjona Dhimitri.

Ogerta Manastirliu – Ndoshta nuk është vendi për të shprehur përjetimet personale, por besoj se ngjarja dhe fatkeqësia, që na preku të gjithëve në shtëpitë tona, na ka bërë të ndjeshëm, solidarë, por edhe na ka forcuar.

Ndaj, më lejoni që në fjalën time të ditës së sotme të ndaj me ju ato çfarë kanë përjetuar këto ditë ekipet e shëndetësisë, ekipet e mbrojtjes sociale dhe punën e madhe që të gjithë bashkë kanë bërë për t'u kujdesur për çdo të lënduar dhe për të shpëtuar jetët që ishin në rrezik.

Para pak minutash u ktheva nga Spitali i Traumës ku vizitova të lënduarit, të cilët ende po marrin shërbim dhe kujdes shëndetësor në këtë spital. Takova Lindita Carën, e cila është më mirë; takova Manjola Cakonin, e cila është më mirë. Manjola është mamaja e Alesios, i cili tashmë ka dalë nga spitali dhe pret të kthehet në shkollë. Takova Aurelin, i cili edhe ai ka dalë nga spitali dhe pret të kthehet në shkollë me shokët e tij dhe është në pritje që të bashkohet me familjen e tij në një shtëpi të re.

Të gjithë jemi të prekur, por të gjithë sot kemi më shumë forcë për të shkuar drejt një plani për rindërtimin jo vetëm të banesave, shkollave dhe spitaleve, por në fokusin tonë është plani për rimëkëmbjen dhe shërimin. Kemi nevojë të shërojmë edhe shpirtrat e prekur, të trazuar, ata që janë përballur me dhimbjen e madhe të këtyre ditëve, por që për fat të mirë të gjithë jemi bashkë me njëri-tjetrin dhe solidariteti ka qenë maksimal brenda dhe jashtë kufijve.

Ndaj, më lejoni që sot të falenderoj të gjitha ekipet e shpëtimit, të gjitha strukturat e shtetit, që ishin në këmbë me gatishmërinë e tyre maksimale, me përgjigjen e tyre të shpejtë! Gjithashtu, më lejoni që, në veçanti, të falenderoj mjekët dhe infermierët! Më besoni, për mua personalisht kanë qenë ditët më të gjata të jetës

sime. Ditën kur media lajmëroi se tërmeti kishte dëmtuar aq shumë spitalin e Durrësit sa mund të dëmtonte edhe pacientët që po merrnin shërbime aty, më bëri të nisesha në një kohë rekord nga Thumana drejt Durrësit. Rruga për të shkuar në spital m'u duk udhëtimi më i gjatë i jetës sime. Ajo çfarë pashë aty më dha më shumë forcë: mjekët dhe infermierët në shërbim. Edhe pse në panik dhe në ankth, ata nuk e lanë për asnjë sekondë detyrën e tyre. Shumë më shumë solidarë dhe humanë kanë qenë në këto kohë mjekët dhe infermierët. Një punë fantastike, e jashtëzakonshme, e bërë me zemër, por edhe me shumë profesionalizëm nga Shërbimi Kombëtar i Urgjencës Mjekësore, që në çdo moment, me ekipet e shpëtimit, me emergjencat civile, me policinë, me të gjitha strukturat e angazhuara, për të shpëtuar 47 jetët, që sot, fatmirësisht, janë mirë dhe në gjendje të stabilizuar.

Por nuk mbaron me kaq. Kur kalon faza e parë e krizës, vjen faza e dytë post traumë, e cila ka një rëndësi shumë të veçantë për të gjithë ne, sepse tani kërkohet shumë më shumë solidaritet, kthjelltësi dhe maturi në të gjitha veprimet tona, sidomos në artikullimin publik.

Sot qytetarët kanë shumë nevojë për t'u qetësuar dhe siguruar, prandaj qeveria është e angazhuar në planin e rindërtimit dhe në planin e rimëkëmbjes të të gjitha familjeve të prekura nga kjo tragjedi. Mbi 10 mijë persona sot vuajnë pasojat e tërmetit katastrofik, të cilët ne jemi të vendosur t'i mbështesim jo vetëm nëpërmjet fazës së parë me strehim të përkohshëm, por, gjithashtu, në fazën afatmesme edhe me strehim adekuat.

Ndërkohë, jemi të angazhuar për t'u ofruar të gjithë kujdesin social-shëndetësor, psikologjik dhe shëndetësor aty ku ata sot janë të strehuar. Sot ne kemi në terren më shumë se 570 trupa mjekësh dhe infermierësh, të cilët janë 24 orë në 7 ditë të javës të dedikuara për të ofruar kujdesin shëndetësor për të gjithë ata që kanë nevojë dhe që janë të strehuar, qoftë në subjektet akomoduese, qoftë në strukturat e tjera të përkohshme.

Më shumë se 340 të sëmurë kronikë po trajtohen me terapi mjekësore dhe mjekë të posaçëm të familjes po kujdesen për shëndetin e tyre.

Fëmijëve u është dedikuar një program i posaçëm me punonjës socialë dhe psikologë. I

rëndësishëm është kthimi në normalitet në shkollë, kopsht, çerdhe dhe sigurimi afatmesëm dhe afatgjatë i mirëqenies së tyre.

Buxheti i vitit 2020 për shëndetësinë dhe mbrojtjen sociale nuk do të preket. Është një buxhet i konsoliduar, është buxheti i qytetarëve, i cili planifikon që edhe qytetarët e dëmtuar nga pasojat e tërmetit, të mbështeten nëpërmjet shërbimeve sociale dhe shëndetësore; është buxheti i qytetarëve, pasi garanton akses dhe cilësi në shërbime. Nuk mund t'u mohohet qytetarëve kujdesi shëndetësor bazë, nuk mund t'u mohohet qytetarëve dializa, nuk mund t'u mohohet qytetarëve të realizojnë interventet kirurgjikale me instrumente për të siguruar shëndetin e tyre, nuk mund t'u mohohen qytetarëve analizat laboratorike falas, nuk mund t'u mohohet qytetarëve që plani i rindërtimit për kujdesin parësor për 300 qendrat shëndetësore të shkojë përpara, ashtu siç do të shkojë përpara nëpërmjet programit të rindërtimit, një program paralel me buxhetin e vitit 2020, programi për të rindërtuar të gjitha strukturat e prekura dhe të gjitha strukturat e banimit për ata që vuajnë pasojat e këtij tërmeti.

Sigurisht që kjo ngjarje ka prekur edhe disa nga strukturat tona të shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale. Fatmirësisht, nuk vërehen dëme strukturore në strukturat spitalore apo qendrat shëndetësore dhe sigurojmë qytetarët se, ashtu siç bëmë me Durrësin, që e rehabilituam në një kohë shumë të shpejtë, do të bëjmë edhe me të gjitha këto struktura, për të vijuar kujdesin shëndetësor për qytetarët dhe për të mos lënë asnjë qytetar pa shërbim shëndetësor afër vendbanimit.

Kjo kohë është një sfidë e madhe për qeverinë, por edhe për shoqërinë tonë, ndaj duhet të jemi të gjithë bashkë, të kthjellët dhe mirëkuptues. Çfarë ka thënë qeveria, do të bëhet, sepse plani tashmë ka nisur dhe është i kristalizuar. Bashkë me ndihmën dhe solidaritetin e vendeve europiane dhe të gjitha shteteve që na përkrahin sot, ne do të arrijmë ta çojmë përpara në një kohë shumë të shpejtë. Nga ana tjetër, buxheti i vitit 2020 do të vijojë konsolidimin e programeve dhe do të hapë programe të reja për shëndetësinë, në mënyrë që ne të vijojmë me shërbimin shëndetësor universal dhe të vijojmë t'u sigurojmë qytetarëve

një shëndetësi të aksesueshme dhe cilësore për të gjithë.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Manastirliu!

Fjalën e ka deputetja Fatjona Dhimitri. Të përgatitet deputeti Ralf Gjoni dhe më pas deputeti Taulant Balla.

Fatjona Dhimitri – Të dashur shqiptarë,

Sot nuk është dita të flasim ne, por ata të cilëve u ka rënë halli dhe tragjedia që ka mbuluar vendin tonë. Sot ne duhet të dëgjojmë inxhinierët që nuk i dëgjuam kurrë, arkitektët që morëm për të zbuluar shtëpitë që të ishin sa më komode, por jo për të parë strukturat e komoditetit tonë. Kemi 30 vjet që flasim dhe nuk lejojmë të flasë ai apo ajo që duhet të flasë.

Sot Luljeta Bozo ulërin, por askush nuk e dëgjon. Po ashtu ulërijnë edhe shumë kolegë të saj, të cilët po ashtu, nuk i dëgjonin. Flet shefi i urbanistikës, kur kërkon ekspertizë më të thelluar, për të garantuar jetën e njerëzve, por ministri i maxhorancës i thotë të heshtë, sepse e quan panik.

Jam e bindur se sot vetëm Kryeministri do të flasë, siç ka bërë gjithë këto ditë, i gjithëdijshmi, i madhërishtë, vetëm ai. Dhe ne prapë jemi të detyruar ta dëgjojmë, sepse ai nuk lë gojë të pipëtijë, sepse ai i di të gjitha.

Sot jam e detyruar të flas dhe t'u kërkoj të gjithëve të mos flasin, kur të shkojnë te njerëzit e lënduar, kur t'i dëgjojnë ata dhe kur të kuptojnë se si është situata në të vërtetë.

Zoti Kryeministër,

Më duhet të flas sot, sepse mua nuk ma heq dot të drejtën e fjalës. Mund të më censurosh në medie, por tani jemi drejtpërsëdrejti dhe nuk mund të më fusësh në burg, siç bëre me median e lirë.

Për cilin buxhet të diskutojmë ne sot? Për falimentin e rilindjes dhe paaftësinë për të menaxhuar tragjedinë që Shqipëria po kalon sot, kur dëshmohet qartë se gjatë gjithë këtyre viteve të keqkqeverisjes së kësaj maxhorance, shumë shqiptarë kanë banuar në ndërtesa kartoni.

Për cilin buxhet të diskutojmë ne sot? Për arkën që mbushet e zbrazet nga oligarkët e qeverisë? Për fondin rezervë të shtetit, që boshatiset nga vjedhjet e rilindjes, dhe kur vendin e kaplon fatkeqësia natyrore, Kryeministri propagandon për fatet e njerëzve si të jetë e shkruar. Kryeministri i maxhorancës, i

zhytur në bunkerët e errësirës moniste, po mendon t'u japë koncesionin e radhës oligarkëve të tij, po rrëzon banesat e vdekjes, që vetë banditët e babëzitur të rilindjes kanë ndërtuar në kurriz të shqiptarëve, dhe nuk ka kurajë të ulët e të marrë përgjegjësitë për fatin e vendit të vet, për identifikimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësia natyrore, apo të negociojë sa më shpejt të jetë e mundur me ekspertët më të mirë vendës e të huaj.

Ku i shihni ju, zotërinj deputetë, përmasat njerëzore të Kryeministrit tuaj.? Edi Rama ka frikë prej së vërtetës, trembet, bllokohet në përgjegjësitë e tij dhe lëshon tërë urrejtjen ndaj medias së lirë. Cili lider europian vendos censurë në medie dhe injoron median e vendit të vet, duke i quajtur gazetarët skandalozë, duke cunguar fjalën e lirë, duke përndjekur penalisht portalet online, deri në mbylljen e tyre? Ai e ka frikë përballjen me mendimin kritik ndaj rilindjes së tij. Arreston një femër, qytetare të ndershme e të pafajshme të këtij vendi, kur i vetmi përgjegjës për krizën është ai dhe vetëm ai. Përmes forcës shtrënguese të urdhrit monist të censurës ndaj medias, shqiptarët duhet të shurdhohen, sipas tij, të qorrohen në terrin informativ dhe të mjaftohen me sloganet që përhap Kryeministri juaj, se ne do ta bëjmë rindërtimin.

Përballë kësaj tragjedie që po kalon sot Shqipëria, vetvetiu shtrohet pyetja: si do të realizohet rindërtimi? Përmes planit fantazmë të mbështetjes dhe mbrojtjes së koncesioneve? Apo të vazhdojnë të gllabërojnë oligarkët tuaj, ndërkohë që familjet në Durrës, Thumanë, Ishëm, vazhdojnë të qëndrojnë nën qiell të hapur?

Aq i errët shfaqet plani i rilindjes, sa edhe buxheti për vitin 2020, i urdhëruar me shpejtësi, po kalon në komisionet e parlamentit shqiptar.

Arsimi zhgënjën përsëri. Ndërkohë që në vitin 2015 jemi renditur në vendin e 52-të, PISA 2018 e ka mbetur në klasë arsimin shqiptar. Rezultatet e PISA 2018 e rendisin Shqipërinë në vendin e 61-të, mes 79 vendeve që morën pjesë në këtë testim.

Kjo renditje tregon shumë qartë se strategjia e arsimit parauniversitar 2014-2020, e cila i orientoi politikat e saj afatmesme e afatgjata për përsosjen e arsimit parauniversitar, sipas vizionit të qeverisë, rezultoi një dështim i

vërtetë. Jo vetëm që ky vizion nuk e çoi arsimin në drejtimin e duhur, por edhe niveli i ulët i buxhetit, që qeveria ka treguar gjatë gjithë këtyre viteve, i bën të rinjtë të pashpresë për të vijuar studimet në Shqipëri. Ata mezi presin të trokasin dyerve të ambasadave, për të marrë një vizë studimi jashtë vendit.

Po çfarë na tregoi PISA 2018? Në aftësi për lexim, pesëmbëdhjetëvjeçarët nuk arritën të kenë asnjë përmirësim nga rezultatet e arritura në vitin 2015. Në shkencë, ndërkohë që pritej një rritje nga viti 2015, në rezultatet e këtij viti Shqipëria ka marrë dhjetë pikë më pak.

Orientimi i karrierës është një tjetër problem, i cili i shqetëson vazhdimisht nxënësit sot. Në rezultatet e PISA 2018 nxënësit kanë evidentuar që nuk ka një person përgjegjës, i cili të mund t'i orientojë ata drejt karrierës. Pjesa më e madhe e tyre, rreth 72 %, i drejtohen kërkimit në internet për të marrë informacione rreth arsimit dhe karrierës.

Gjithashtu, nxënësit kanë raportuar se vetëm 46 % e pesëmbëdhjetëvjeçarëve kanë ndjekur një panair edukimi apo janë përfshirë në aktivitete vullnetare.

Investimet në arsim, përmes treguesve të paraqitur në projektbuxhetin e vitit 2020, janë degraduese, referuar standardeve europiane të arsimit.

Buxheti 2020 nuk ka një shpërndarje të drejtë të investimeve në arsim, në gjithë territorin e Republikës, në përputhje me kërkesat. Buxheti 2020 nuk sjell përmirësime për pagat e mësuesve, nuk siguron pajisjen e shkollave me laboratorë, sistem ngrohjeje, biblioteka, mjete didaktike, nuk u jep zgjidhje klasave kolektive. Në buxhetin e shtetit mungon fondi i parashikuar për transportin e nxënësve që ndjekin arsimin parashkollor dhe arsimin bazë, të cilët mësojnë në një distancë prej më shumë se dy kilometrash nga vendbanimi i tyre i përhershëm, si dhe mësuesve që banojnë në distancë prej më shumë se pesë kilometrash.

Përse nuk plotësohen nevojat e sistemit arsimor me këto shërbime? Përse nxënësit detyrohen të braktisin bankat e dijes, ndërkohë që qeveria e rilindjes zhytet në shpenzime luksi, me hotele e makina luksoze për të babëziturit e pushtetit?

Buxheti 2020 nuk realizon parashikimet e Paktit për Universitetin, nuk sjell rritjen e

buxhetit të arsimit në 5 % të GDP-së, të propaganduar nga qeveria. Nuk investohet në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe infrastrukturës në universitete.

Buxheti 2020 nuk realizon mbështetjen e studentëve për kërkime shkencore, arkivimin dixhital të doktoraturave, burimet njerëzore të trajnuara për këtë qëllim, nuk sjell përmirësimin e kushteve të konvikteve të universiteteve, si dhe nuk sjell pajisjen e të gjithë studentëve me kartën e studentit. Nuk ka një parashikim për mbështetjen e studentëve, projektet për laboratorët, praktikat profesionale.

Për sa i përket kulturës, investimet e parashikuara në buxhetin 2020 në kulturë, janë të papërfillshme, referuar nevojave për rehabilitim, që kanë sot shumë monumente të kulturës, objekte të kultit në shembje, lagje historike që po bien në zona të mbrojtura nga UNESCO.

Në komisionin e Edukimit dhe Mjeteve të Informimit Publik u quajt irritues fakti se në Gjirokastrën historike po humbet historia. Sërish frika e rilindjes prej së vërtetës. Në lagjet historike si në Dunavat, në Manalat, po rrëzohen banesat historike, ndërkohë që maxhoranca hesht sërish. Do t'i bëjmë, propagandojnë ata si gjithmonë.

Në relacionin e buxhetit për vitin 2020 nuk i kushtohet rëndësi skemës së pavarur të kulturës, duke mos i dhënë prioritet mbështetjes së projekteve të pavarura.

Buxheti 2020 i alokuar për Akademinë e Shkencave, është pamjaftueshmëri ekonomike për të garuar në nivelin e dijes. Për cilën Akademi Shkencash të flasim? Për azilin politik në të cilin është kthyer kjo Akademi Shkencash, ku kryetari i vetëshpallur i qeverisë moniste tallet në Komisionin e Edukimit, na reklamon se do të bëjë shpikje në robotikë, në nanoteknologji.

Të mos lëmë nam para qytetarëve shqiptarë, të nderuar deputetë! Zgjohuni dhe reagoni ndaj hallit të familjeve, që po vuajnë pasojat e tërmetit!

Faleminderit!

(Drejtimin e seancës e merr zoti Ruçi.)

Gramoz Ruçi – Fjalën e ka Ralf Gjoni. Të përgatitet Taulant Balla.

Ralf Gjoni – Faleminderit, zoti kryetar!

Në fakt, si të gjithë ne bashkërisht, edhe unë e përjetova tërmetin në mënyrë shumë emocionale, sepse pas goditjes së madhe në

Durrës e në Tiranë, jam nisur me urgjencë në Durrës, dhe në orën shtatë të mëngjesit kam qenë tek pallati i shembur, ku forca të ndryshme, me mjete rrethore po mundoheshin të gjenin një mundësi për të shpëtuar Dienën e shkretë, e cila ishte bllokuar nga muret, me të bijën e vdekur në krahët e saj.

Për një baba që ka një vajzë, ishte shumë e dhimbshme të qëndroja pranë atyre gërmadhave, pranë atyre rrënojave. Më duhet ta them se jam mahnitur nga shpirti i solidaritetit të vullnetarëve e të forcave të ndryshme të shpëtimit, të zjarrfikësve, të ambulancës, të mjekëve, të forcave xhënierë, forcave të ushtrisë, të forcave italiane gjithashtu, që gjendeshin atje.

E kam thënë edhe më parë, gjatë këtyre ditëve, se ky nuk është momenti të bëjmë politikë. Në fakt, ky nuk është momenti të bëjmë politikë të pistë, nuk është momenti të bëjmë populizëm, sepse unë mendoj se tërmeti, një forcë kaq e tmerrshme natyrore nuk pyet as për të majtë e as për të djathtë.

E kam frenuar veten nga çdo lloj sulmi apo kërkimi llogarie ndaj qeverisë, në këto ditë të vështira për të gjithë qytetarët e Durrësit, Thumanës, Tiranës, për shkak se mendoj që energjia dhe fokusi ynë duhet të jenë të shpëtimit i jetëve, të menaxhimit të krizës dhe të ndihmës për qindra e mijëra qytetarë që kanë ngelur pa strehë.

Mendoj se situata do të agravohet në ditët, javët e muajt në vazhdim, sepse dimrin e kemi përpara dhe duhen trajtuar shumë problematika. Nga ana tjetër, të nderuar kolegë, unë mendoj se po vjen momenti kur ne duhet të fillojmë të kërkojmë edhe përgjegjësit. Ne nuk mund të kërkojmë përgjegjësi nga qeveria apo nga Edi Rama se përse ra tërmeti, por ne mund të kërkojmë llogari pse u shembën disa godina e disa pallate, ndërsa shumë të tjerë nuk u shembën. Pse? Ne si deputetë, kemi detyrim institucional e moral që ta bëjmë këtë pyetje.

Gjatë ditëve në vazhdim, ne duhet të jemi shumë të vëmendshëm ndaj të gjitha masave të marra ose të pamara nga ana e ekzekutivit, nga ana e autoriteteve lokale për të menaxhuar krizën dhe situatën e tmerrshme, të krijuar menjëherë pas goditjes së tërmetit. Njerëzit thonë: “në dorën e Zotit”, po përse duhet të jemi vetëm në dorën e Zotit? Pse të mos jemi edhe në dorën e qeverisë, edhe në dorën e shtetit? Njerëzit thonë: “në dorën e Zotit”, por nga ana tjetër, po të

shkosh lart e poshtë e të flasësh me qytetarët, thonë se nuk ka shtet. Të them të drejtën, atë ditë kam parë heronj, qytetarë në detyrë shtetërore, por shtetin nuk e pashë.

Nga momenti kur kam mbërritur në Durrës, u desh një orë e gjysmë për të gjetur një matrapik. Ulërinin policët e shkretë, të cilët ishin pa kaska dhe futeshin mes mureve të rrënuara të ndërtesës, për të shpëtuar Dienën dhe vajzën e saj. Nuk kishte matrapik, nuk kishte krik për të mbajtur muret. Erdhën ca njerëz nga një gomisteri private në Durrës, që të sillnin dy krikë për të ngritur dhe mbajtur traun kryesor, me qëllim që të futeshin forcat emergjencës.

Nuk kishte doreza, nuk kishte kaska, nuk kishte asnjë lloj mbrojtjeje, prandaj ata njerëz, të cilët lanë familjet e tyre dhe shkuan atje për t'iu gjendur viktimave të tërmetit, janë heronj të vërtetë. Shteti nuk ishte, por heronjtë ishin atje.

Vlen të lavdërohet solidariteti mahnitës që unë kam parë nga qytetarët e Shqipërisë në momentet pas tërmetit, sidomos natën e parë, në kampin kaotik, të ngritur në stadiumin e Durrësit, ku mungonin batanijet. Nuk mungonte ushqimi, por mungonin çadrat. Nuk mungonin ditën e dytë çadrat dhe batanijet, por ditën e parë mungonin.

Pra, vlen të bëhet pyetja: pse kishte mungesa në organizim dhe në përgjigjen e shtetit ndaj qytetarëve, në një nga ditët më të vështira të jetëve të tyre? Të nderuar kolegë, vlen të ngrihet pyetja: çfarë masash janë marrë nga autoritetet përkatëse qendrore, por edhe vendore, edhe nga bashkitë, për të inspektuar, për të evaluar dhe për të mbrojtur qytetarët pas tërmetit të shtatorit? A është në gjendje Kryeministri Rama, që të na e thotë sot në parlament se çfarë masash ka marrë kjo qeveri pas shtatorit, për të evaluar godinat dhe për t'iu siguruar se shërbimi i emergjencave të ishte i gatshëm brenda disa minutash, brenda një ore, që të përgjigjej me të gjitha mjetet e duhura? Njerëz kishte, por nuk kishte mjete. Njerëz kishte, por nuk kishte organizim.

Zoti Rama, unë nuk dua t'ju sulmoj dhe nuk dua të bëj politikë të pistë me ju sot, pa kaluar kjo vala e parë, por ama shteti ishte rrumpallë, me sa pashë unë. E ke thënë një ditë se Shqipëria është rrumpallë, por më rrumpallë se kam parë unë këto ditë, nuk kam parë në njëzet vjet shtet në Shqipëri.

Kështu, të nderuar kolegë, ne si parlament nuk mund të kalojmë një buxhet pa marrë në konsideratë nevojat e qytetarëve e të shqiptarëve në këto kohë të vështira të pastërmetit. Ne nuk mund të kalojmë këtu projektligje korporatash. Ne nuk mund të kalojmë asnjë projektligj, në qoftë se vëmendja dhe energjia jonë nuk është e përqendruar 100% te qytetarët dhe në këtë kuadër dhe në këtë kontekst ne kemi detyrimin që t'i kërkojmë llogari qeverisë, jo ta sulmojmë qeverinë. Ne duhet t'i kërkojmë llogari se pse qeveria nuk u gjend pranë qytetarëve, se në dorën e Zotit ishim, në dorën e shtetit nuk ishim, por në mungesë të Zotit dhe të shtetit shohim se kemi vetëm Edi Ramën.

Të na rrojë sa malet Edi Rama! Në çdo ekran televiziv shohim vetëm Kryeministrin. Pse duhet të dalë Kryeministri sikur është heroi i ditëve tona, shpëtimtari i madh, Mesia i shekullit XXI, që do të vijë këtu dhe do të shpëtojë qytetarët?

Kryeministri duhet të jetë në punë me qeverinë e tij dhe t'i japë llogari këtij parlamenti pse Shqipëria nuk ka një shërbim emergjencash në gatishmëri dhe në vigjilencë të plotë për t'iu përgjigjur një fatkeqësie natyrore në momentet e para, atje ku ka nevojë.

Mund të kishin vdekur shumë më tepër njerëz, por unë mendoj që edhe disa jetë të tjera mund të ishin shpëtuar nëse shërbimet e emergjencave do të ishin më të shpejta dhe më profesionale.

Ndaj, të nderuar kolegë, sidomos ju të PS-së, ju ftoj t'i thoni Kryeministrit Rama që të mos bëjë populizëm në këto momente se është shumë e shëmtuar. Populizmi me fatkeqësinë natyrore, personalizimi i dramës kombëtare dhe profilizimi i tij si shpëtimtari i popullit, sinqerisht, është shumë i shëmtuar.

Në këto momente ne duhet t'iu gjendemi pranë qytetarëve dhe duhet të japin llogari të gjithë ata njerëz që janë përgjegjës për pallatet që ranë, përfshirë njerëz në ekzekutiv apo në bashki. Duhet parë të gjithë kryetarët e bashkive që kanë dhënë leje ndërtimi, të gjithë ndërtuesit dhe inxhinierët që kanë projektuar godinat që ranë, të gjithë ata maskarenj ndërtues që kanë ndërtuar kate sipër, të gjitha ata kryetarë bashkish, që kanë miratuar leje ndërtimi në ato zona ku nuk duhej ndërtuar në ato lloj kushtesh. Duhet parë reagimi i qeverisë dhe pse Shqipëria nuk ka një

shërbim emergjencash të standardeve europiane, siç kanë Greqia, Italia apo Franca.

Ne jemi zonë sizmike dhe duhet të ishim më të përgatitur për të përballuar një tërmet të tillë, sepse qytetarët duhet ta dinë se tërmeti 6,4 i shkallës Rihter, që përkthehet diku te 8,3 ballë lëkundje, nuk hyn tek tërmetet shkatërruese, por tek tërmetet e forta, por jo shkatërruese.

Kanë vdekur njerëz dhe disa njerëz të tjerë këtu pas meje duhet të fillojnë të japin llogari.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Fjala për Taulant Ballën.

Taulant Balla – Miqësisht, i them çdo kolegu të ri, se në Shqipëri nuk bëhet korbi në ditë zie, as vaji i korbit.

Shqipëria prej 26 nëntorit po kalon një nga momentet më të vështira të tri dekadave të fundit. Tërmeti i fuqishëm që goditi Shqipërinë, fatkeqësisht, u shoqërua me një bilanc tragjik, me 51 jetë të humbura dhe qindra të lënduar. Nga ana tjetër, ky tërmet shkatërrimtar dëmtoi me mijëra banesa, shkolla dhe biznese të qytetarëve shqiptarë, duke përbërë një sfidë që shkon përtej mundësive të qeverisë apo kombit tonë.

Për ata që ende nuk e dinë, vijojnë të marrin ndihmë shëndetësore 29 motra dhe vëllezër me një kujdes të veçantë, 22 persona në Qendrën Spitalore të Traumës, 4 në spitalin e Durrësit dhe 3 të tjerë të transferuar jashtë vendit për kurim të specializuar, falë gatishmërisë së qeverisë italiane. Kryeministri Rama dhe Kryeministri Konte kanë qenë çdo ditë në kontakt të vijueshëm edhe për këtë dimension të rëndësishëm të kujdesit që qeveria ka ndaj shtetasve të vet.

Sipas sizmologëve situata është në qetësim e sipër, edhe pse deri tani janë regjistruar rreth 1400 pasgoditje. Duhet t'u japim një mesazh kuptimplotë vëllezërve dhe motrave që na ndjekin se nuk jemi as të parët, as të fundit që kemi kaluar situata të tilla. 8 vjet më parë në Zelandën e Re, një tërmet 6,3 i shkallës Rihter shkaktoi rreth 190 të vdekur dhe pothuajse një qytet të tërë e shkatërroi. Të mos bëjmë këtu sizmologun, por t'u referohemi fakteve konkrete.

Ishte një tërmet shkatërrimtar dhe na la pasoja të rënda, 1183 shtëpi të shembura, shtëpi të dëmtuara rëndë 5514, ndër to në Durrës 3838, në Tiranë 1311, në Lezhë 168, si dhe në disa rrethe të tjera të Shqipërisë, që nuk i kemi

përmendur për arsye se nuk kanë qenë në fokus në fillim, sepse nuk kishte njerëz nën rrënoja (të tilla ka në Kukës, në Dibër, në Elbasan). Shtëpi të dëmtuara lehtë janë 3569, ndër të cilat 3248 janë në Tiranë, kurse në Dibër 73. Pallate të dëmtuara rëndë janë 558, në Durrës 35, në Tiranë 461, kemi të tillë në Lezhë, në Kukës e të tjera.

Pallate të dëmtuara lehtë janë 337 në Tiranë, në Durrës e gjetkë.

Ju dëgjova me vëmendje, zotërinj deputetë të opozitës. Ndonjëri, ndoshta për efekt të karriges, ka trashëguar fjalorin e opozitës së vjetër në këtë parlament.

Për t'i shpjeguar gjithë popullit shqiptar që na ndjek me vëmendje, se jemi përfaqësuesit e tij, kjo seancë është një seancë solemne, me vëmendjen e plotë për ata që nuk kanë shtëpi, për ata që kanë humbur të afërmit dhe ky Kuvend sot mbështet të gjitha aktet që bëri qeveria menjëherë për t'i mbështetur.

E para, unë nuk e kuptoj, të marrësh fjalën në Kuvendin e Shqipërisë dhe të jesh kundër dhurimit të banesave familjeve të viktimave...

E dyta, besoj se do të reflektoni deri në fund që ne t'u garantojmë pension të posaçëm të gjithë atyre që mbijetuan, por që humbën familjen e tyre.

Ne duhet t'ua japim këtë, dhe po ua japim me aktin normativ që solli qeveria me urgjencë e që Kuvendi sot ka detyrën ta miratojë.

Buxheti i shtetit ndryshon duke krijuar një kapitull të veçantë për rimëkëmbjen, për rindërtimin, pa prekur gjithë pjesën tjetër që lidhet me funksionalitetin normal të jetës ekonomike dhe të shtetit në çdo cep të vendit.

Kjo është e vërteta. Mjaft më me tonet e Albana Vokshit, që gjoja janë PPP, PPP, PPP! S'ka PPP fare, as bëhet fjalë. Këtu ka çështje konkrete, të japësh pension, të japësh shtëpi për ata që sot janë pa shtëpi. Sa për PPP-të, të jeni të sigurt se gjithçka kemi bërë, e kemi bërë me bindjen për t'u shërbyer njerëzve.

Në rendin e ditës së sotme është edhe zgjedhja e prokurorit të Përgjithshëm të vendit dhe brenda këtij viti, sikurse e kishim thënë, do të ngrihet Prokuroria Speciale Antikorrupsion dhe kush ka ankesa, kush ka denoncime, të shkojë t'i bëjë.

Unë kam qenë në opozitë si ju dhe kam bërë 107 kallëzime në prokurori. Mos u merrni

me lloqe, por shkoni atje dhe bëni atë që duhet të bëjë çdo njeri normal!

Megjithatë, pavarësisht panoramës së zyrtë, fill mbas tërmetit e gjithë struktura e shtetit ishte në këmbë, nga Kryeministri dhe anëtarët e Këshillit të Ministrave deri te përfaqësuesit e Kuvendit (gjej rastin të falënderoj një për një çdo deputet të Grupit Parlamentar të PS-së, por edhe deputetët e opozitës se kemi qenë bashkë).

Ishim të gjithë atje për të parë protokollin e ndërhyrjeve që ndiqet në këto raste. Nuk është aspak e vërtetë që s'kishte pajisje.

(Ka ndërhyrje nga salla.)

Të lutem, se ti ndoshta nuk e di se për çfarë përdoret matrapiku, por unë po të them se nuk mungonte asnjë gjë (ja ku e ke deputetin e opozitës, pyete se kemi qenë bashkë), dhe për herë të parë ka qenë i menjëhershëm edhe solidariteti i të gjitha forcave zjarrfikëse dhe të kërkim-shpëtimit nga shumë vende, pa dyshim më të specializuar, por kini parasysh se në një vend normal numri i forcave të kërkim-shpëtimit në dispozicion i tillë është. Për të qenë korrektë, po ju them se kam ndenjur nonstop me një prej grupeve të forcave të vendeve partnere që erdhën për ndihmë, të cilët sapo ishin kthyer nga Portugalia me një mision të ngjashëm, jo tërmeti, por një tjetër fatkeqësi natyrore. Pse, Portugalia nuk kishte mundësi ta bënte vetë? Është normale që kishte thirrur në ndihmë forcat rumune.

Në tërmetin e Kilit, të njëjtat forca rumune që ishin këtu, kanë shkuar për të ndihmuar edhe atje dhe ky nuk është turp, por është solidaritet normal në një fatkeqësi kaq të madhe natyrore.

Dua të falënderoj Policinë e Shtetit, FA-të, zjarrfikësit dhe Urgjencën Shëndetësore Kombëtare!

Dua të falënderoj vëllezërit tanë nga Kosova, që ishin të parët që mbështetën forcat tona në misionin për shpëtimin e sa më shumë jetëve që ndodheshin nën rrënoja.

Pa dashur të vendos radhë dhe përparësi dua të falënderoj dhe t'u shpreh mirënjohjen e thellë të gjitha shteteve, të cilat i janë gjendur vendit tonë në momentet e para pas tërmetit. Siç e kam nënvizuar disa herë gjatë kësaj jave, miqtë e vërtetë janë ata që të ndodhen pranë në momente të vështira dhe fqinjët tanë, si dhe partnerët tanë strategjikë e dëshmuar këtë që në orët e para mbas tragjedisë.

Është koha të reflektojmë edhe ne si politikanë dhe thirrja e Kryeministrit për opozitën jashtë parlamentit vlen edhe për ju, për të qenë bashkë në këtë moment, siç e do zakoni i shqiptarit.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti Balla!

Fjala për Kujtim Gjuzin.

Kujtim Gjuzi – Mirëdita, qytetarë të Republikës së Shqipërisë!

Ne mbajmë një minutë heshtje për viktimat e tërmetit. Pyetja është: A ishte tërmet natyror apo artificial? Pse është tërmet artificial?

Sipas nesh, që kemi studiuar në Universitetin Bujqësor Tiranë, në sizmikë, në atë që quhet evapotranspirim, bllokimi i vijës bregdetare nga betoni, sidomos në Lalëz, filloi kur Ilir Meta ishte kryeministri i vendit dhe një biznesmen, i cili vazhdon të ndërtojë atje.

Pikërisht një muaj më parë kam dalë në Lalëz në një foto dhe kam pyetur pse vazhdoni ta betonizoni këtë zonë, e cila është zonë kënetore deri në grykëderdhje të lumit Ishëm.

Lumi Erzen, lumi Lana, lumi i Tërkuzezës, lumi i Zezës dhe të gjitha këto bashkohen pikërisht pikërisht atje që quhet gropa e zezë, me të vjetrën. Unë jam 60 vjeç. Kryeministri është 55 vjeç. Është 5 vjet më i ri sesa unë. Ndoshta Kryeministri nuk e di mirë se ajo është zona ku shkarkojnë të gjitha prurjet e reshjeve, që janë fiks 60 ditë në prefekturat Tiranë-Durrës.

(Ndërhyrje nga salla)

Zoti Kryeministër, ndonjë nga deputetët e PS-së që qesh është injorant, me sa duket. Mundohu të mos e vendosësh në listën e vitit 2021.

Këto prurje të vargmalit Dajt, mali Skënderbej ose i Krujës, siç i thonë, sjellin të gjitha këto që quhet zona e përmbytur e Albanopolisit. Ju që nuk keni studiuar mirë, shkoni dhe shikojeni pak!

Të gjitha këto prurje shkojnë atje poshtë. Pikërisht ne jemi në zonën qymyrbajtëse të minierës së Kasharit, për ata që nuk e dinë Valias dhe Manzë. I gjithë ky aks ka poshtë qymyre. Të gjitha këto sjellin atë që në gjuhën e rëndomtë quhet llorbë. E gjithë zona poshtë ka krijuar një digë me 4 metra thellësi, ku ujërat nëntokësore derdhennë Adriatik, ato mbitokësore krijojnë evapotranspirim.

Drejtojuni sizmiologëve! Shkoni tek ata që kanë studiuar toka, po ku keni kohë ju të studioni! Ju e keni mendjen të bëni ndonjë PPP, të merrni ndonjë lekë dhe të shkoni gjithandej. Megjithatë, Taulanti tha këtu: “Jemi në ditët e zisë”. Dita zyrtare e zisë një ishte. 7 ditë është me të drejtën tonë zakonore, është e vërtetë se kur vdesin njerëz ne mbajmë zi, por nuk jemi në ditën e shtatë.

Zoti Kryetar, pse parlamenti mblidhet me vonesë?

(Ndërhyrje nga salla)

Ju vjen për të qeshur, sepse nuk ju ka vdekur njeri në shtëpi. I keni vilat këtej nga kodrat, nuk i keni atje poshtë. Prandaj do t’ju lutem shumë juve, deputetëve të Partisë Socialiste, mos u zgërdhini! Boll u zgërdhitë!

Tani të themi një gjë tjetër. Atë natë isha në zyrë dhe prej gati 7-8 ditësh, përjashto 2 ditë kam ndenjur *nonstop* në zyrë. Kam dalë edhe në terren, i kam parë të gjitha. Ka dalë edhe Kryeministri. Shumë mirë ka bërë, por nuk mundet Kryeministri, megjithëse është i ngarkuar, pa gjumë...

(Ndërhyrje nga salla)

E ndjekim Kryeministrin. Çfarë detyre kemi ne të opozitës?! Të ndjekim Kryeministrin. Çfarë pune kemi tjetër? T’ju ndjekim ju sesi zgërdhieni, sesi shkoni diku, sesi futni apo nxirrni njerëz nga puna?!

Zoti Kryeministër, shkëlqesi ministra, unë do t’ju kërkoja që të jeni *nonstop* me qytetarët. Ju e kishit sinjalin për pallatet me tulla silikate që janë atje. Në fund fare ka dhënë një sinjal Presidenti, i cili paska parashikuar që do të bjerë tërmeti, apo jo?! I bëj pyetje Presidentit: jua tha dikush, pagove dikë në Athinë? Zotëri President, jua thanë se mund të ketë tërmete dhe ju i thatë Edi Ramës që të bëjë gati buxhetin? Ti e dije që ka tërmet. Je ekonomist. I di se si shprehen llogaritë e qymyreve atje poshtë kur mbushen me ujë.

Ju garantoj një gjë: me konsulencë të shumë ekspertëve, tërmeti vjen me amplitudë në rënie, nuk mundet dot në këtë tokë, të paktën të ketë tërmete që kapin 6,1 apo 6,2 të shkallës Rihter. Qytetarët nuk duhet ta lëshojnë më vendin, po të jemi të gjithë së bashku, bashkë me Kryeministrin, megjithëse unë nuk kam qejf që të jetë Kryeministër fare, se për 6 vjet nuk ma ka mbushur mendjen se ka bërë punë të mira, me

ndonjë përjashtim retushimi. U them të gjithë qytetarëve, të jemi të gjithë bashkë. Pagën time në muajin janar nuk do ta marr, por do ta jap për viktimat.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Fjalën e ka Zef Shtjefni!

Zef Shtjefni – I nderuar, zoti Kryetar,

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Të dashur qytetarë,

Po diskutojmë sot për projektligjin “Për buxhetin e vitit 2020”. Natyrisht, ai është i pamjaftueshëm për hallet dhe problemet që ka Shqipëria, por edhe mund të ndryshojnë destinacionin disa zëra për të përballuar situatën e vështirë që kalon vendi. Do të diskutoj më vonë për tragjedinë e ndodhur në Shqipëri,

Buxheti i vitit 2020 duhet të përqendrohet kryesisht te pensionet e shumë shqiptarëve, që nuk kanë mundësi të kalojnë muajin me familjet e tyre. Buxheti i vitit 2020 duhet të përqendrohet te shtesa e pagave për punonjësit e Policisë së Shtetit, të Gardën e Republikës, të emergjencave civile, që janë në krye të detyrës natë e ditë në shërbim të vendit.

Buxheti i vitit 2020 duhet të kishte përparësi arsimin e mesëm dhe të lartë, pasi duhet të krijojmë kushte më të mira për studentët dhe për arsimin profesional. Kërkohej një shtesë buxheti pasi duhet të përgatisim brezin e ri për t’i dalë zot vendit edhe nga ana profesionale, për rininë studentore duhen kushte më të mira në auditorë, por edhe në qendrat studentore ku ata jetojnë.

Buxheti i vitit 2020 duhet të ishte më i plotë për sektorin e shëndetësisë, pasi për sëmundje të ndryshme t’u shërbejmë shumë shqiptarëve të sëmurë me pajisje, medikamente në spitalet tona. Është bërë një punë e madhe, por kërkohet edhe më shumë, sepse sëmundja e dializës, po marr një shembull, kërkon një përkujdesje më të madhe, sepse ka mosha shumë të reja me këtë sëmundje dhe duhet që shteti t’i vlerësojë qoftë edhe me punë, me gjysmë orari, sepse ajo pagesë që marrin nuk u mjafton. Kërkojmë që Ministria e Shëndetësisë t’i shikojë si prioritet këto lloj sëmundjesh dhe shumë të tjera.

Buxheti i vitit 2020 duhet të prekte shumë shtresa të shoqërisë. Personat me aftësi të kufizuara duhet të kishin një prioritet më të madh, pasi gjendja e tyre është e mjeruar. Në këtë buxhet që vjen sot besoj se duhet të

korrigjime shumë zëra, pasi duhet që të përballohet fatkeqësia që i ka ndodhur Shqipërisë nga tërmeti i 26 nëntorit.

Buxheti i vitit 2020 ka një rritje të vogël për bujqësinë nga ai i vitit 2019, por përsëri është i pamjaftueshëm për të ringritur bujqësinë shqiptare. Ai duhet t'i ishte shumë më i madh sesa ky që na paraqitet. Ai duhet t'i ndihmonte fermerët shqiptarë, madje kërkohet një menaxhim më i mirë i prodhimeve bujqësore, pasi shumë nga prodhimet e tyre shkojnë dëm, kalben, sepse nuk kanë treg shitjeje. Unë kam folur gjithmonë për bujqësinë, pasi e shikoj si një sektor të rëndësishëm për fshatin dhe për qytetin. Jemi të paorganizuar për t'ia ndryshuar faqen fshatit shqiptar, sepse kërkohet një organizim tjetër për mbledhjen e produkteve ushqimore, marrjen e masave për shitjen e prodhimeve. Pastaj çdo gjë do të shitej dhe nuk do të kalbej gjë. Bujqësia duhet të jetë prioritet i çdo qeverie në këtë vend, pasi garantojmë fshatin dhe qytetin me prodhimet, me kontrollin e vazhdueshme të të gjithë fermerëve që përdorin pesticide të dëmshme për shëndetin e njeriut. Agjencia Kombëtare e Ushqimit, si dhe çdo institucion tjetër duhet të mbajë përgjegjësi për shëndetin e qytetarëve tanë. Ky buxhet duhet të ishte shumë më i mirë edhe për vetë AKU-në, se mund të ketë shumë mungesa në organikë apo në paga për të bërë punën e saj sipas ligjit.

Këto ditë kemi kaluar edhe ligjin "Për disa ndryshime në Kodin Penal", ku flitet për sigurinë ushqimore. Ai duhet të vlerësohet dhe të zbatohet me përpikëri. Ky buxhet duhet të ishte edhe më i mirë për të vënë në zbatim sigurinë ushqimore të qytetarëve tanë. Ne duhet të garantojmë jetën e qytetarëve tanë. Kjo është detyra jonë dhe prandaj jemi këtu, ta mbrojmë nga çdo e keqe që mund t'i ndodhë popullit tonë. Këto janë punët e qeverisë, të parlamentit dhe të çdo institucioni në këtë vend: të bëjnë detyrën e tyre për një Shqipëri më të mirë sesa deri më sot.

Buxheti i vitit 2020 do të ishte buxhet edhe më i mirë edhe për ata punonjës, drejtues që largohen nga puna për arsye politike dhe duhet t'u kthehen paratë, sepse çdo qeveri që vjen në këtë vend heq njerëz nga puna, pa asnjë faj. Në pjesën më të madhe atyre duhet t'u kthehen paratë sipas vendimeve të gjykatave të këtij vendi.

Buxheti i vitit 2020 duhet të ishte një buxhet, ku çdo shtresë shoqërore e këtij vendi të gjente veten aty. Tani që bashkitë e vendit i drejtoni ju, shpresoj të ndryshojë jeta e qytetarëve nëpër zonat e vendit.

Po me pastrimin e zonave të Shqipërisë, çfarë do të bëni? Duhet fonde për *landfill-e* nëpër bashki, sepse mbeturinat janë rrugëve nëpër përrrenj, lumenj. Tani që çdo gjë e drejtoni vetë mund të bëni ndonjë gjë për gjendjen që kanë qytetarët.

Ky buxhet duhet të kishte më shumë investime në sistemin e energjisë elektrike. Duhet të heqim shtyllat e kalbura dhe telat, të investojmë te kablloret, me qëllim që energjia elektrike të mos vidhet dhe të mos fiket dritat. Në zonën e Shkodrës ka shumë zona me tela dhe shtylla të kohës së Enverit. Duhet të dalim nga kjo gjendje, sepse një erë të fryjë ikin dritat në të gjithë zonën. Prandaj merrni masat dhe i dilni zot vendit.

Ka shumë sektorë ku ky buxhet është i pamjaftueshëm. Ne do të vazhdojmë që gjithmonë të japim ndihmesën tonë për këto shtresa që kanë nevojë dhe për një përkujdesje më të madhe.

Në buxhetin e vitit 2020 duhet të kishte një shtesë fondi për specialistët e sizmikes me qëllim mbulimin e të gjithë Shqipërisë me specialistë, sepse shkurtimi i shumë strukturave duke i quajtur të panevojshme na ka kushtuar shumë ne shqiptarëve.

Në fund të fjalës sime dua të bëj një falënderim, në fshatin Barbullush në Shkodër u dogj një shtëpi. Herën e kaluar kam folur në parlament, por sot dua të falënderoj ata që bënë të mundur ndërtimin e saj: hoxhë Elvis Naçin, gazetarin Saimir Kodra dhe këngëtarin Sidrit Bejleri që bënë të mundur ndërtimin e një shtëpie të një zonje me 5 fëmijë, që kishte mbetur pa strehë. Mirënjohje dhe falënderim për këta njerëz kaq humanë. Është fat që vendi ynë i ka dhe vazhdojnë të kontribuojnë çdo ditë në shërbim të njerëzve në nevojë.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi - Fjalën e ka Artur Roshi,
Artur Roshi- Zoti Kryetar,
Zonja dhe zotërinj deputetë,

Sigurisht që fjalët e para janë për të shprehur ngushëllimet për familjet, të cilat humbën të afërmit e tyre nën rrënojat e tërmetit.

Por diskutimi i buxhetit të vitit 2020 që kemi në rendin e ditës duhet të shkojë përtej populizmave për të ruajtur kontrollin e pushtetit.

Në relacionin mbështetës të projektbuxhetit të vitit 2020 shpreheni që në hyrje se rritja ekonomike do të jetë 4,1%. Ky parashikim, po ashtu edhe llogaritja e tij në buxhetet faktike janë përlogaritje që përshtjellohen për të fshehur realitetin. Pra, në të vërtetë kjo shifër është e paracaktuar politikisht për të treguar se jemi nisur dhe do të shkojmë diku për disa vjet që mbrapa fshehin disa dekada.

Perceptimi për rritjen ekonomike në sytë e qytetarëve është një shifër statistikore që kalon tangjent me buxhetet familjare të tyre dhe nuk ndikon aspak tek ato.

Pra, rritja ekonomike në xhepat e qytetarëve dhe në buxhetet familjare është zero pikë përqindje, sepse kjo rritje e supozuar ekonomike nga qeveria nuk përkthehet në të ardhura në lekë për frymë. Të ardhurat për frymë për vitin 2020 rriten me zero lekë.

Atëherë, buxheti në këtë rast tejkalon kuptimin e tij dhe kthehet në një nocion abstrakt. Ky buxhet nuk do të jetë i aftë të neutralizojë tundimin e largimit të shqiptarëve për mbijetesë dhe jo për një jetë më të mirë. Deficiti buxhetor i vitit 2020 parashikohet të jetë 1,6%. Një shifër e ekzagjeruar emocionalisht nga dëshira e qeverisë për të qenë e tillë. Ulja e borxhit të parashikuar për vitin 2020 edhe pse e papërfillshme është thjesht një kontroll shifrash, sepse nuk i kemi llogaritur borxhet e prapambetura, të papaguara dhe borxhet e fshehura. Nën këtë frymë ecin dhe bankat e nivelit të dytë me interesa të fshehta në kredihënie për qytetarët.

Ky projektbuxhet nuk ka investime të reja në infrastrukturë, por thjesht vazhdimësinë e projekteve të rrugëve në proces e sipër, pra kemi një hap pas të qeverisë në turrjen e investimeve. Ai është një projektbuxhet nën moton zhargon "Llogaritë nuk të dalin ndonjëherë", prandaj lëre në gjendje të lirë dhe mbyll sytë kur të fundosesh. Është projektbuxhet i ankthit për pasigurinë e të ardhurave që do të gjenerojë ekonomia, i paradepresionit ekonomik që reflekton uljen e shpenzimeve të konsumit dhe mungesën e dukshme të investimeve.

Papunësia parashikohet të bjerë në 10,6%. Ky parashikim është llogaritur në proporcion me

largimin e të rinjve ose nga një imagjinatë ekonomike.

Ky projektbuxhet thuhet se do të mbështesë sektorin e ujit. A nuk do të ishte më mirë të mbështeste infrastrukturën energjetike për të integruar rrjetin tonë energjetik në rrjetin energjistik europian, ku çmimi i blerjes dhe i shitjes do të kishin diferenca të theksuara nga çmimet që kanë operuar gjithë këto vite me linjat e amortizuara të rajonit, si ajo e Beogradit e të tjera?

Mbështetja e reformës në drejtësi është e vetmja që do të ketë efekt të padukshëm, por të përherëshëm në një masë të caktuar në zhvillimin ekonomik. Investimet e huaja janë të papërfillshme për vitin 2020, pra në kufijtë e inekzistencës. A është ky një defekt i politikave të qeverisë për mungesën e stabilitetit në biznes për shkak të korrupsionit të sistemit fiskal dhe të mungesës së sigurisë e të tjera?

Sektori i ndërtimit, që është në kufij të poshtëm, krahasuar me historinë e 30 vjetëve të fundit, tregon se qeveria nuk ka asnjë ide që ta kthejë atë në tonusin e zhvillimit. Rënia e kursit të euros, që ndikon dukshëm në përkeqësimin e eksporteve, nuk është shqetësuese për qeverinë, pasi mendon se me informalitetin e trafiqeve mund të jetë pjesë integrale e ekonomisë. Kreditë me probleme kanë filluar të ulen në numër, por bie në sy se ka rënë ndjeshëm niveli i kreditimit. Kjo tregon se biznesi është në fazën e tërheqjes dhe turrjes ndaj investimeve. Bankat e huaja e kanë kreditimin në kufirin 0,8% apo 1,2%, gjë që tregon frikën dhe pasigurinë e likuiditetit të biznesit. Bizneset e regjistruara për vitin 2019 janë biznese të vogla për vetëpunësim, ndërsa regjistrimi i biznesit të mesëm dhe atij të madh janë kthyer në legjenda urbane.

Rritja e pagave dhe e pensioneve e tremb qeverinë të thotë qoftë dhe një shifër simbolike, apo për të indeksuar liberalizimin e çmimeve.

Fondin për shpenzimin e ish-të përndjekurve politikë e kemi 0,05% të PBB-së, një marzh vjetor që i garanton ata se do të likuidohen përafërsisht për 35 vjet. Këtu qeveria tregon se është në nivelet e përcimit dhe jo të dëmshpërblimit.

Efkti i trafiqeve të drogës në ekonomi dëmton thelbin e tregtisë së shkëmbimit të mallit pronë me paratë, mirëpo qeveria lundron në kufijtë e besimit ndaj tyre.

Të ardhurat nga doganat këtë vit kanë rënë, gjë që tregon ngarkesën e lartë fiskale të bizneseve. Rrugët Kardhiq-Delvinë, Elbasan-Banjë, bajpasi i Shkodrës, bajpasi i Tepelenës financojnë limitet më të ulëta që mund të perceptojmë, kështu që mendoj se do të krijojnë detyrime të prapambetura.

Ky buxhet është i paaftë të rikuperojë si duhet pasojat e tërmetit, prandaj them se duhet të ketë një shpërndarje tjetër të të ardhurave, që të tentojë drejt metodave, për një zhvillim të qëndrueshëm të ekonomisë.

Ju faleminderit!

Gramoz Ruçi – Fjalën e ka Erion Piciri.

Erion Piciri – Do ta nis fjalën time me një ngushëllim të sinqertë për familjet e viktimave. Është një tragjedi e madhe të humbasësh familjarët për paaftësi të shtetit, për papërgjegjshmëri të institucioneve lokale dhe qendrore. Shumë specialistë kanë nënvijëzuar faktin se nuk vret tërmeti, por institucionet e shtetit me paaftësinë e tyre.

Do të doja t'i bëja thirrje parlamentit për shkarkimin e Kryeministrit të vendit, si përgjegjësi politike dhe moral i nivelit më të lartë, se është ai bosi i madh që qeverisi pushtetin vendor dhe atë qendror në Durrës e në Tiranë për një periudhë të gjatë kohe dhe tani është në krye të qeverisë shqiptare.

Kuptohet që nuk do ta gjej një mirëkuptim të tillë me parlamentin shqiptar, por dua t'ju them se 4 vjet më parë, 64 viktima dhe 106 të rinj u lënduan në një diskotekë në Bukuresht, qindra e mijëra qytetarë tronditën Rumaninë dhe e detyruan Kryeministrin e vendit të jepte dorëheqjen për 12 orë. Vrasja e njerëzve, rënia e godinave dhe tronditja e madhe, që kemi përjetuar në Tiranë e në Durrës, janë faji i politikës dhe kjo duhet nënvijëzuar.

Shpresoj shumë që qytetarët shqiptarë ta tundin nga themelet këtë ngrehinë të tranzicionit, që ka brenda korrupsion, krim dhe gjithçka që dëshironi në këta 30 vjet. Unë nuk them dot se sa miliona euro janë dhënë bakshish në këto vite për ato ndërtesa me leje bashkiake.

Nuk dua ta zgjatem, por shpresoj shumë në një reagim të madh qytetar! Këta lotë krokodili, që pamë në sytë e ministrave e të Kryeministrit i vendit, nuk i bëjnë nder një

qeverie, mund të jenë për familjarët, por jo për shtetin që garanton siguri.

Unë dua të flas edhe për diçka në lidhje me buxhetin e shtetit, se aty mund të gjejmë përgjigje për atë që ndodhi, për paaftësinë tonë, për politikën preventive.

Mbaj mend kohë më parë, kur ndiqja një master dhe një përfaqësues i Ministrisë së Mbrojtjes thoshte se kemi 3500 skenare në raste krizash. Duheshin reagime të menjëhershme të qeverisë, kohë më parë, që të mos vinte një ditë e tillë.

Nëse më lejoni dua të shtoj edhe diçka për buxhetin e shtetit, që duhet nënvijëzuar fort dhe që lidhet edhe me tërmetin. Buxheti për arsimim është nga më të turpshmit në historinë e Ballkanit, të Europës dhe të vendeve të OECD-së.

2,5% është turp i Zotit. Çfarë do të bëni me 2,5% për arsimin?! A e dini sa e kanë vendet e tjera të Ballkanit? 4,5%, vendet e BE-së 4,7%, vendet e OECD-së 5%. Ky është tërmeti më i madh që mund t'i ndodhë një vendi, goditja që ne i japim shkollimit të fëmijëve tanë dhe po e ndaj në tri dimensione: të marrim testin e fundit, testin PISA të 2018-s, që është një katastrofë. Jemi ende në 1/3-n inferiore të kësaj bote. Kur një i ri shqiptar mbaron shkollën e mesme ka përgatitjen e 8-vjeçares, nivelin e klasës së tetë. Është një gjë e turpshme nëse krahasohemi me më të zhvilluarit e kësaj bote. Ne investojmë 570 dollarë, sipas UNICEF-it, për një nxënës, në një kohë kur vendet e OECD-së investojnë 10 mijë e 500 dollarë në mesataren e tyre. 80% e nxënësve tanë janë në nivelet 1 dhe 2, nga më të ulëtit e kësaj bote. Shumë pak kemi në atë që quhet "ekselencë" në arsim.

Diçka tjetër për universitetet shqiptare, ato janë më të dobëtat në Ballkan: Universiteti i Athinës është në nivelin 600 deri në 800; Universitetet e Beogradit, Bukureshtit dhe Sofjes janë nga 800 deri në 1000; Universiteti i Malit të Zi, i krijuar në vitin 1974, ish-Universiteti i Titogadit, është në nivelin 1000 plus. A e dini ku është Universiteti i Tiranës, që shumica juaj keni marrë diplomat? Në nivelin 7 mijë e 300. Universiteti i Arteve, nëse ka ndonjë që ka mbaruar atje, është në nivelin 11 mijë. Nëse i lidhim të dyja sistemet bashkë, Kryeministri i vendit del me shkollë të mesme, nga më të humburat e kësaj bote.

A e dini sa keni dhënë për universitetet shqiptare? Keni dhënë 0,55%. Vendet e OECD-së e kanë 1.5%. Duke marrë edhe diferencat e GDP-së për banorë, jemi shumë larg.

Këto ditë që ra tërmeti, doli një lajm se izraelitët do të parashikonin kur do të bjerë tërmeti i ardhshëm. Nuk e di nëse e kanë gjetur, por ndoshta do ta gjejnë në të ardhmen. Ka një diferencë të madhe mes asaj që investojmë ne dhe Izraeli.

Kohë më parë Netanjahu mbante një fjalim në OKB dhe krenohet për inovacionin, për teknologjinë e informacionit dhe për kërkimin e vendit të tij. Po ne me çfarë mund të krenohemi?

A e dini sa e kemi zërin për shkencën? E kemi 0,036%. Izraeli e ka 4,7%, 130 herë më shumë si përqindje e GDP-së dhe 3250 herë. Nuk e kanë fajin shqiptarët. Ne ende nuk e kemi parë potencialin tonë kombëtar, që të investojmë siç duhet për shkollën tonë shqiptare. Ky është ndryshimi që duhet të bëjmë.

E fundit, do ta kuptojmë ç'do të thotë masa preventive, të parandalosh dhe të ndërtohet sisteme që të rezistojnë godinat. Të gjitha elementet bazike, që bëjnë diferencën në këtë botë, kanë të bëjnë me sigurinë: sigurinë e jetës, sigurinë e pronës dhe me nivelin e lartë të arsimit. Prandaj ikën rinia shqiptare. Në këto vite ka rënë me 35 mijë numri i studentëve shqiptarëve, 30 mijë prej të cilëve i kemi në Europë, nga të cilët 94%, sipas një informacioni socialdemokrat, nuk do të kthehen më në Shqipëri. A e kuptoni se çfarë humbje kemi ne si komb me ikjen e potencialeve më të mira njerëzore?

Ne jemi republika e krizës. Kemi qenë në krizë në këta 30 vjet, në mos në 75 vjet. Ky është ndryshimi i madh që duhet të bëjmë. Buxheti për arsimin duhet të jetë, më e pakta, 6,5%, dhe jo diferenca historike që kemi me vendet e Ballkanit dhe vendet e Europës, 2% e të cilave duhet të jenë në drejtim të kërkimit shkencor.

Një qasje tjetër duhet të jetë edhe për qeverisjen e vendit, sepse nuk duhet të udhëhiqemi nga populizmi, nga marketingu politik, nga aftësia për të bërë gallatë dhe për t'ua hedhur njerëzve.

Po jap një shifër tjetër. Në shkollën e lartë vijnë 65% nga të pasurit dhe 35% nga njerëzit e varfër. Ata thonë se janë fëmijë njerëzish të punës, që e kanë ndërtuar me shumë vështirësi

jetën, nuk janë të majtë e të djathtë. Ju e keni shkatërruar konceptin bazik të mundësive që i jepet njeriut, që të kultivojë aftësitë dhe talentin e tij.

Thirrini mendjes! Shpresoj që në këto 23 sekonda t'u bëj një thirrje qytetarëve shqiptarë: t'i jepet një goditje e madhe ngrehinës korruptive autoritare dhe kriminale të tranzicionit!

Dilni në rrugë, sepse nuk keni çfarë të humbni! Po shkojmë në një drejtim të gabuar prej 30 vjetësh dhe kemi mundësi t'i japim vendit një tjetër perspektivë.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Fjala për Blendi Klosin.

Blendi Klosi – Të nderuar kolegë,

Pa dyshim që 26 nëntori ka qenë një nga ditët më të vështira të gjeneratës sonë. Gjenerata jonë u sprovua më 26 nëntor, por u sprovua edhe mënyra sesi e menaxhojmë ne shtetin shqiptar në regjime të ndryshme, jo për një dekadë, jo për një forcë politike. 26 nëntori kishte më shumë se 50 vjet që nuk ndodhte dhe është një dramë e madhe, një krizë e rëndë.

Mënyra si reagojmë karshi kësaj date për gjeneratën tonë shërben për të verifikuar se sa e gatshme është kjo shoqëri, populli shqiptar, njerëzit e thjeshtë, njerëzit e zakonshëm të hapin zemrën, të pranojnë dhe të përballojnë fatkeqësitë si humbja e 51 bashkëqytetarëve tanë, mes të cilëve mund të ishte viktimë secili prej nesh, siç ishin ata njerëz të thjeshtë, që atë ditë ishin përgatitur për të vazhduar jetën në shumë drejtime.

Si reagoi shoqëria në datën 26 nëntor? Si po reagon shoqëria shqiptare këtë javë dhe si do të reagojë në muajt në vazhdim? Kjo është një nga pikëpyetjet e mëdha të identitetit tonë, të sakrificës sonë, të mënyrës si do të jemi të gatshëm për të ndërtuar mbi këtë shqetësim dhe fatkeqësi të madhe që na ra. Sa të gatshëm do të jemi t'i japim energji popullit shqiptar, kombit shqiptar dhe të ardhmes sonë?

Kjo ditë, edhe për ne që kemi eksperiencë në parlament, është një nga ditët më të shënuara të parlamentit shqiptar. Gjithmonë kemi diskutuar për detajet e buxhetit me orë të gjata, për mënyrat sesi politikën financiare apo politikën buxhetore ndikojnë drejtpërsëdrejti në mirëqenien dhe në jetën e qytetarëve.

Sot ky debat është kthyer, pothuajse nga të gjithë kolegët, në një homazh për viktimat, për

familjet e dëmtuara, në një kërkesë emergjente për ata njerëz që kanë humbur të afërmit e tyre, si dhe të shohim familjet e dëmtuara dhe sektorët që ndikohen drejtpërdrejt nga kriza e datës 26 nëntor.

Të nderuar kolegë,

Spektori i turizmit është pa dyshim një ndër sektorët që tragjedia e datës 26 e ka prekur drejtpërsëdrejti. Ne duhet ta kuptojmë se si duhet të ndikojmë nëpërmjet politikave buxhetore dhe administrative që ky sektor kaq i rëndësishëm i ekonomisë së vendit tonë të marrë mbështetje dhe të rigjenerojë për vitin që po mbyllim, ashtu si edhe vitin e kaluar, mbi 2 miliardë euro të ardhura të drejtpërdrejta për mijëra familje të shoqërisë shqiptare.

Data 26 nëntor, siç edhe jua thashë, ishte një sfidë e madhe, ku ne e kuptuam sesa të gatshëm dhe humanë jemi të hapim zemrën dhe shtëpinë për ata njerëz që kanë më shumë nevojë. Pa dyshim, si një administrator që ka fatin të punojë me komunitetin e hotelierëve shqiptarë, nuk mund të rri pa përmendur këtu, nga kjo foltore e nderuar, kontributin e jashtëzakonshëm që dhanë hotelierët shqiptarë që në datën 26. Pikërisht që nga kjo datë Kryeministri Edi Rama i thirri ata në takim dhe u kërkoi mbështetje dhe ata i hapën hotelet e tyre që ditën e parë të dramës, pasi pothuajse të gjithë i kishin të mbyllur, sepse ishin jashtë sezonit, por megjithatë ata arritën t'i siguronin stafet, ushqimin dhe ambientet e ngrohta.

Sot, 1 javë nga dita kur ne iniciuam këtë aksion nën drejtimin e Edi Ramës, për t'i stabilizuar njerëzit nëpër këto godina, kemi 4100 qytetarë që janë akomoduar në 16 hotele të vendit, 3 prej të cilave ndodhën në zonën e Shëngjinit, si dhe duke garantuar sistemim për 4 bashkitë më të prekura në zonën veriore Krujë, Laç, Kurbin dhe Lezhë, të mbi 1100 banorëve të këtyre zonave. Gjithashtu, në 13 hotele të tjera në zonën e Golemit është garantuar sistemimi i mbi 3000 banorëve të zonës së prekur që përfshin tri bashkitë Durrës, Shijak dhe Kavajë.

Kjo është një ngjarje e madhe humane e realizuar nga këta hotelierë për të përballuar sfidën më të madhe, atë të datës 26. Por sfida më e madhe, e cila vazhdon edhe sot, është që asnjë person të mos mbetet pa çati. Kjo është ajo çfarë na u kërkua: organizim, zhdërvjelltësi, mobilitet, komunikim dhe veprim të shpejtë direkt me

njerëzit. Besoj se u angazhuan të gjithë, si qytetarët, administratorët, por edhe çdo punonjës administrate, gati 8000 ishte numri i njerëzve, të cilët e ndërmorën këtë veprim për të ndihmuar dhe asistuar njerëzit në nevojë që në datat 26 dhe 27 nëntor. Nuk kishte ndodhur kurrë më parë një mobilizim i tillë. Përveç komunitetit të hotelierëve, do të ishte mirë t'i përmendja të gjithë, por në radhë të parë dua të falënderoj dy shoqatat që na ndihmuan në këtë drejtim, Unioni Ndërturistik dhe shoqata "ATA", të cilat na ofruan disa mijëra vende, duke na treguar që kjo industri përsëri arriti t'ia dilte duke përballuar një sfidë të madhe.

Kjo industri dëshmoi se është e përgatitur jo vetëm për të pritur dhe për të sistemuar turistë të huaj dhe vendas, por në një kohë rekord, brenda 24 orëve, arriti të sistemonte një numër të konsiderueshëm banorësh, të cilët nuk kishin nevojë vetëm për akomodim dhe ushqim, por për të siguruar një jetë normale komunitare. Në këto hotele ata do të kishin 100% të sigurt shërbimin shëndetësor, shërbimin e kujdestarisë nga ana e psikologëve, si dhe shërbime që kanë të bëjnë me jetën e përditshme. Pra, 4000 banorëve që ishin sistemuar aty nuk u munguan këto shërbime, duke i parë ata jo si njerëz që kanë nevojë për të gjitha këto shërbime, por si njerëz që përveç hallit të madh që u ka ndodhur, në radhë të parë të ndihen mirë dhe të mos u mungojë e gjithë përkujdesja.

Sfida që ne kemi përpara është që gjithë këtyre banorëve t'u sigurojmë akomodimin, t'i takojmë një për një dhe t'u zgjidhim sa më shpejt çështjen e banimit, duke shkuar në programin e rindërtimit të qeverisë së Edi Ramës, i cili do t'u sigurojë një akomodim afatgjatë dhe me kushte shumë të mira këtyre njerëzve.

Ajo që dua të theksoj sa i takon industrisë së turizmit, për të cilën kemi shumë nevojë, është që të gjithë së bashku duhet ta promovojmë, sepse vitin që vjen na pret një sfidë më e madhe në mënyrë që të arrijmë standardet e vitit 2018-2019, por të kemi edhe perspektivën e rritjes.

Ju bëj thirrje ta mbështesim Durrësin, gjë që e kanë bërë çdo ditë edhe kolegët, sepse është e lehtë të kritikosh, por Durrësi është destinacioni që pret më shumë turistë nga të gjitha destinacionet e tjera në vendin tonë. Të gjithë së bashku duhet të dëshmojnë që garancia e strukturave tona dhe e akomodimit është 100% e

sigurt dhe se sezoni i ardhshëm do të jetë përsëri i suksesshëm, duke vazhduar të kontribuojë në gjithë këtë sistem për të pasur një jetë më komode për të gjithë qytetarët tanë, edhe për ata që sot përballen me këtë fatkeqësi të madhe.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi - Fjalën e ka Vasil Sterjovski.

Vasil Sterjovski – I nderuar Kryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Në fillim të fjalës sime dua të shpreh ngushëllimet e mia të sinqerta për familjarët e viktimave të tërmetit, ndërsa të lënduarve u uroj shërim sa më të shpejtë!

Të gjithë qytetarët shqiptarë, pavarësisht përkatësisë etnike, u solidarizuan me bashkëqytetarët e prekur nga tërmeti. Mbështetje për të prekurit nga tërmeti katastrofik dhanë të gjithë qytetarët: shqiptarët, grekët, maqedonasit, vllahët, serbët, malazezët, boshnjakët, romët dhe egjiptianët në Republikën e Shqipërisë.

Shpreh mirënjohje për të gjitha institucionet e vendit tonë, por edhe për vullnetarët, për gjithë sakrificën që treguan gjatë përballjes me pasojat e tërmetit, si dhe ndaj gjithë maqedonasve në Shqipëri, të cilët treguan solidaritet dhe humanizëm, duke kontribuar me ndihma financiare, por edhe me ushqime e veshje për bashkëqytetarët tanë të prekur nga tërmeti. U bëj thirrje ta vazhdojnë solidaritetin e tyre për të gjithë të prekurit nga tërmeti. Shpreh mirënjohje dhe falënderoj fqinjët tanë, por edhe vendet e tjera, të cilat u solidarizuan dhe ndihmuan në përballjen e pasojave emergjente nga tërmeti i 26 nëntorit dhe shpresojmë se ata do të na mbështesin dhe do të na ndihmojnë edhe në fazën e rindërtimit të banesave të shembura dhe të dëmtuara me qëllim që pasojat shkatërrimtare dhe trauma psikologjike që shkaktoi ky tërmet te popullsia të kalojnë sa më shpejt të jetë e mundur.

Sot po shqyrtojmë draftin e projektit për buxhetin e vitit 2020. Pas dëmeve të shkaktuara nga tërmeti i 26 nëntorit, sigurisht që drafti aktual i buxhetit të vitit 2020 duhet të rishikohet dhe të ndryshojë në tërësi, të shkurtohen shpenzimet, të pezullohen disa investime dhe këto fonde të kalojnë për rindërtimin e banesave të shembura dhe të dëmtuara nga tërmeti.

Po u rikthehem disa problemeve konkrete për buxhetin e vitit 2020 sa i takon pjesës që jam i interesuar. Me keqardhje konstatoj se në draftin e projektligjit për buxhetin e vitit 2020 nuk është planifikuar asnjë fond për pakicat kombëtare, pavarësisht detyrimeve që vendi ynë ka ndaj minoriteteve, të cilët janë qytetarë luajalë dhe taksapagues të rregullt të këtij vendi. Sipas ligjit “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”, i miratuar në tetor të vitit 2017, Komiteti për Pakicat Kombëtare financon nëpërmjet fondit për pakicat kombëtare nismat dhe projektet që synojnë mbrojtjen e të drejtave të pakicave kombëtare dhe ruajtjen e promovimin e identitetit kombëtar, gjuhësor e kulturor të tyre. Në këtë draft të projektligjit për buxhetin e vitit 2020 nuk parashikohet asnjë fond për Komitetin për Pakicat Kombëtare, që do të thotë se minoriteti maqedonas, grek, vllah, malazez, serb, boshnjak dhe egjiptian në vitin 2020, ashtu si edhe në 30 vjetët e fundit, nuk do të kenë asnjë fond për mbështetjen e nismave dhe projekteve që synojnë mbrojtjen e të drejtave të pakicave kombëtare, si dhe ruajtjen dhe promovimin e identitetit kombëtar, gjuhësor e kulturor të tyre. Në buxhetin e vitit 2020 nuk është planifikuar asnjë fond për ngritjen e redaksisë së gazetareve të minoriteteve pranë Radiotelevizionit Publik, i cili para 2 vjetësh, në bazë të ligjit “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”, ka filluar të transmetojë 5 minuta lajme në disa gjuhë të minoriteteve në “RTSH 2”, kanal televiziv dedikuar pakicave kombëtare.

Ky ka qenë një hap pozitiv, por mangësitë në lidhje me kohëzgjatjen dhe përmbajtjen e programeve të transmetuara, të cilat nuk iu përgjigjën interesave, nevojave dhe problemeve reale të pakicave, vazhdojnë të ekzistojnë ende. Me ngritjen e redaksisë së gazetareve të minoriteteve në RTSH ata duhet të ishin krijuesit e lajmeve, kronikave dhe të reportazheve për minoritetet që përfaqësojnë.

Gjithashtu, në draftin e projektligjit për buxhetin e vitit 2020 nuk parashikohen fonde për zhvillimin ekonomik për zonat ku jetojnë minoritetet, duke përfshirë këtu edhe minoritetin maqedonas në vendin tonë. Zonat ku jeton minoriteti maqedonas në bashkinë e Pustecit, zona e Prespës, zonën e Gollobordës në bashkinë e Bulqizës dhe Librazhdit, zona e Gorës në

bashkinë e Kukësit, si dhe fshati Vërnik në bashkinë e Devollit, janë zonat më të varfra në vendin tonë, të lëna pas dore nga të gjitha qeveritë gjatë 30 vjetëve të fundit, pa infrastrukturën e nevojshme rrugore, ujësjellës, kanalizime, shërbimin shëndetësor, energjinë elektrike e të tjera.

Me gjithë situatën e rënduar buxhetore nga tërmeti mendoj se trajtimi i problemeve të mësipërme do të mbahet në konsideratë, për të treguar se qeveria aktuale është e interesuar për të zgjidhur problemet që minoritetet në përgjithësi dhe ai maqedonas në veçanti kanë në vendin tonë.

Ju faleminderit!

Gramoz Ruçi – Këtu mbyllet debati në parim për 5 projektligjet për paketën fiskale, si dhe diskutimi në parim i projektligjit për buxhetin e shtetit për vitin 2020.

Kalojmë te një çështje tjetër po kaq e rëndësishme, 4 aktet normative të dërguara nga qeveria lidhur me situatën në të cilën u përfshi edhe debati i sotëm: akti normativ nr. 4, datë 30.11.2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”; akti normativ nr. 5 datë 30.11.2019 “Për një shtesë në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar”; akti normativ nr. 6, datë 30.11.2019 “Për dhurimin e apartamenteve familjarëve të viktimave, si pasojë e tërmetit të datës 26.11.2019” dhe akti normativ nr. 7 datë 30.11.2019 “Për një shtesë në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”.

Fjalën e ka deputeti Halit Valteri.

Halit Valteri – I nderuar Kryetar,

Të nderuar kolegë,

Në këtë situatë aspak të lehtë që po kalon Shqipëria ndiej se nuk jam në gjendje për të bërë politikë, por më besoni se edhe në ëndrrat e mia më të këqija nuk e kam menduar ndonjëherë veten se do të flisja për këtë temë. Tërbitim të papritur të natyrës, pasojat e të cilit Shqipëria nuk i kalonte prej dekadash, më bënë edhe shpresëplotë se ky vend do të bëhet. Sigurisht, do të bëhet pa ju, ndoshta edhe pa mua, por e sigurt është se do të bëhet nga ata mijëra shqiptarë, të cilët u bashkuan brenda natës për të ringritur

themelet e brishta të shtëpisë sonë të madhe me shumë halle.

Sikur të ishim një familje e madhe u bashkuam dhe i dhamë dorën njëri-tjetrit. T’ju them të vërtetën asgjë nuk më befasoï nga sjellja tyre, por me përulje dua t’u them “Faleminderit”!

Faleminderit çdo shqiptari, i cili e pa si vëlla, si motër, si të afërm çdokënd që kishte nevojë. Më duhet të pranoj se ndihem i turpëruar që jam ulur në një parlament të “qeverisë së ngjalave” të 22 prillit të vitit 2013 dhe të “qeverisë së çadrës” së 17 majit 2017, e cila, kur vjen puna për pushtet, deri në shtrat i futen armikut politik të partisë, ndërsa kur vjen puna për t’u ardhur në ndihmë shqiptarëve, nuk ka perëndi t’i ulë bashkë në një tavolinë. Sa u takon partnerëve tuaj të pushtetit, që qëndrojnë të trulllosur jashtë kësaj salle, ata nisën t’i fërkonin duart si hiena kur panë se në qytet ra gjëma dhe thanë: “Hajdeni, o burra, se na doli fati, ta shfrytëzojmë dhe ta kthejmë në politikë” Si kllounë dilnin duke takuar njerëz dhe bënë sikur ishin të merakosur dhe të mallëngjyer kur disa nga ato pallate u ndërtuan nga ata ose familjarët e tyre. Janë aq pa vizion dhe pa shpresë, sa besoj janë të vetmit njerëz në këtë botë që pasi i parashikojmë tërmetet, u japin edhe ngjyrimet politike. Po si ka mundësi që nuk e parashikuan kur firmosën lejet e ndërtimit, apo kur morën milionat nga mafia e ndërtimit? Por edhe nuk iu kemi sharë si konkurrentë të çetës lumi Lana-Presidencë. Na habitët me bujarinë tuaj kur dhuroat pagat, ashtu si menjëherë, për t’iu mbyllur gojën atyre, për t’iu treguar se ju e bëtë pjesën tuaj, hoqët nga goja kafshatën tuaj dhe ua dhatë shqiptarëve. Si mundët të jepnit vetëm rrogën, kur gjysma juaj që ka zënë karriget në këtë parlament kanë paguar mbi 500 mijë euro për t’u ulur në këto karrige dhe gjysma tjetër e ka paguar me klering?

(Ndërhyrje pa mikrofon nga salla)

Nuk është për të qeshur, është për të vënë duart në kokë, Kryeministër. Po, edhe me ata tjerët, edhe me ty. Jeni bashkë ju, jeni mjeshtra. Shok e ke ti Lulin.

Do të dhuroni pagën ju? Po ç’t’ju pyes, nuk e dimë sa e keni rrogën, por i tërhiqni nga frika se mos ju thonë si e shtyni muajin, me çfarë i blini çantat milionëshe, kostumet, fustanet, pushimet, udhëtimet, shkollimet e fëmijëve. Më shumë se gjysma e këtij parlamenti përbëhet nga

biznesmenë e pasanikë, bashkë me gjysmën tjetër të zemrës suaj, që ndodhet jashtë kësaj salle, pra çeta Lumi Lana- Presidencë, e cila paguhet ende nga shqiptarët. Si të paturp që jeni, bëni deklarata se do të jepni rrogën nga frika se mos dikush do t'ju kërkojë më tepër se ç'keni. Tenton çeta jashtë parlamentit, tentoni edhe ju t'u bëni presion biznesmenëve të jenë dorëlëshuar, pra ata që i majmët ju, sepse ju nuk e keni problem t'ua merrni atyre, por e keni shumë problem të fusni dorën tuaj në xhep. A ka më turp se t'ju shohësh ju që dilni nëpër televizione e u kërkon lekët oligarkëve ose në të kundërt mbylljen e tenderëve? Po oligarkët cilët janë? Ju jeni oligarkët dhe ata që menaxhojnë paratë tuaja, tenderët tuaj, shtëpitë tuaja, jahtet dhe makinat tuaja. Ata janë disa biznesmenë që deri dje i mbanit për dado t'ju shoqëronin të afërmit ose fëmijët nëpër kopshte ose për pushimet në vilat tuaja të plazhit.

Mua nuk më digjet xhani aspak për këta oligarkë, por nuk e kuptoj pse u kërkon atyre paratë tuaja, ndërkohë që jemi ne që duhet t'ju kërkojmë juve dhe dado-oligarkëve tuaj paratë e shqiptarëve. Me paturpësinë më të madhe punonjësit të administratës iu mbahet rroga. Po a e dini, o njerëz, që punonjësit e administratës kanë halle, kanë kredi, kanë qira, kanë fëmijë për të rritur? Si do ta shtyjnë muajin ata njerëz? Sikur të dhuronin paratë tre ose katër nga bretkosat që rreziten në këtë moçalin tonë këtu, që të nesërmen u zgjuan si princër, më besoni, do të mjaftonin për të ndërtuar të gjithë qarkun e Durrësit.

A ka dijeni kush se çfarë u bë me apartamentin e Lulit? Tërmeti i parë ishte duke e zënë brenda të shkretin dhe u transferua nga frika te vila, bashkë me plaçkën që ka marrë gjithë këto vite dhe që i jepni ju çdo ditë.

Shqipëria dhe shqiptarët nuk janë të varfër, por jeni ju të pangopur dhe të babëzitur. Të jeni të bindur se pasojat e tërmetit që u shkaktoi dhimbje shqiptarëve, nuk do të krahasohen me pasojat dhe dhimbjet që do t'ju shkaktojë tërmeti i shqiptarëve kur t'ju marrin zvarrë rrogat e gjithçka keni përvetësuar hajdutçe bashkë me shpurën e dado-oligarkëve tuaj.

Ndoshta e përzejve pak me politikë, por dua të bëj një falënderim për të gjithë ata ministra që iu gjenden atyre qytetarëve, për të gjithë ata kolegë, që ishin atje dhe nuk iu

trembën ndihmës për qytetarët, për të gjitha ata forca policie e zjarrfikëse që ditë-natë shpëtuan jetë, për të gjithë ata mjekë dhe infermierë që dhanë shpirtin për të ndihmuar këdo që u lëndua nga tërmeti, mijëra qytetarë shqiptarë që u sensibilizuan me fatkeqësinë që na ra, të gjithë partnerët dhe fqinjët tanë që na u gjendën pranë. Faleminderit Kosovë që mbajta një barrë, siç vetëm ti di ta mbash në raste vuajtjesh!

Nuk na mbetet gjë tjetër veç të lusim Zotin e madh që të na ndihmojë, të jemi të gjithë bashkë dhe ta kalojmë këtë sfidë që na ra!

Faleminderit!

Gramoz Ruçi- Faleminderit!

Fjala për Kryeministrin Rama.

Edi Rama - Duke ndjekur diskutimet këtu, dëgjova që flitej për Japoninë e për OECD-në. Por, në fakt, meqë jemi në një situatë të jashtëzakonshme, dëshiroj të ndaj me ju nevojën që në kuadrin e adresimit të problemeve të konstatuara, të marrim edhe shembullin e Japonisë, të Amerikës, të Izraelit, që, kur ndodhin fatkeqësi të këtyre përmasave, ua mbyllin gojën me ligj të gjithë atyre që s'kanë çfarë të thonë. Nuk iu jepet mundësia lloj-lloj protagonistëve pa lidhje që të çorodisin dhe të dëshpërojnë miletin. Besoj se edhe kjo do të jetë një nga gjërat që ne do ta adresojmë në reformën e përgjithshme ligjore për rastet e fatkeqësive të mëdha natyrore, se nuk është e mundur që, përveç halleve të mëdha nga fatkeqësia natyrore, populli të ketë edhe këtë hall të madh, me ditë e me net të bombardohet nga gjithfarë delirantësh e gjithfarë sharlatanësh, që shfaqen si sizmologë, si shkencëtarë, si inxhinierë, si konstruktorë e si prokurorë.

Nga ana tjetër dëgjova Ralfin që kërkonte matrapik dhe ishte shumë i shqetësuar që në vrapin e tij për t'iu ardhur në ndihmë njerëzve, s'kishte parë matrapik. Nuk përdoret matrapiku, Ralf, në rrënojat ku ka ende jetë.

Dëgjova një zonjë tjetër këtu, që fliste për buxhetin dhe nuk e kishte lexuar fare. Fliste për makina luksi, ndërkohë që në këtë buxhet që ne miratojmë, janë hequr të gjitha shpenzimet për makina, për vitrina dhe për çdo nevojë tjetër të kësaj natyre. S'ka as mobilime. Të gjitha ato fonde i kalojnë fondit të rindërtimit. Po ta kishe lexuar minimalisht, këtë do ta kishe kapur se kjo është kryesorja. Megjithatë, e mirëkuptoj që

tërmeti ka bërë të vetën edhe mbi ju, edhe mbi fjalimet tuaja.

Për të ardhur tek thelbi që na ka mbledhur këtu e për të mos ju harxhuar kohë njerëzve me broçkulla, dëshiroj të theksoj disa gjëra: së pari, buxheti angazhon një fond afro 20 miliardë, prej të cilave 13 miliardë janë lekë si transfertë nga të ardhurat buxhetore dhe 7 miliardë janë të ardhura nga donacionet e ndryshme. Por e gjithë kjo pako e parë është një alokim fillestar.

Kam dëgjuar, përveç klithmave për kapele, për doreza e për çizme, që natyrisht janë jehonë e konstatimeve të përcipta, të përcjella nga ekranet, nga portalet e nga vitrinat, edhe që shteti paska mbetur pa lekë dhe s'paska kapacitet të përballojë këtë situatë, prandaj ne po i shtrijmë dorën botës. Në fakt, kjo është e pavërtetë dhe që ta dëgjojnë të gjithë, ne do ta programojmë të gjithë procesin, sikur të mos marrim asnjë lek nga bota. Kështu e kemi programin dhe kështu do ta bëjmë. Kjo që bëjmë me këtë buxhet është fillimi i këtij programi. Sikur asnjë kokërr leku të mos vijë nga bota, ne do ta përballojmë të gjithën, sepse është detyra jonë ta përballojmë dhe sepse ne jemi më të zgjuar, më të zotë, më të aftë sesa ju dhe ata që juve ju kanë hapur vendin këtu.

Natyrisht, është një mundim më vete t'ju shpjegojmë juve sesi do e bëjmë këtë punë, por, nëse do të jeni pak të vëmendshëm në leximin e dokumentit, mund të kuptoni diçka.

I them këto pasi realisht duhet një kurajë që i kalon kufijtë e përfytyrimit tim për të dalë këtu sot dhe për të folur të gjithë broçkulla, duhet një kurajë që i kalon kufijtë e parafytyrimit tim për të torollisur këtë popull me lumenjtë dhe me përrënjtë e broçkullave që janë thënë gjatë gjithë këtyre ditëve, lart e poshtë, në çdo kabinë dhe në çdo tendë medatike.

Programi për Rindërtimin do të financohet si një program buxhetor më vete. Do të jetë një fond buxhetor i transferushëm dhe dinamik, gjithmonë brenda programit të përgjithshëm buxhetor. Aspekti dinamik i fondit është i rëndësishëm, sepse shuma e alokuar që do të kalojë qysh sot dhe do të detajohet në vijim nga buxheti i shtetit, jo vetëm është e konsiderueshme për të hapur procesin, por garanton që Programi i Rindërtimit të fillojë të zbatohet në shkallë të gjerë. Nga ana tjetër krijon hapësirë të plotë, qoftë për të shtuar në vijim nga

buxheti, qoftë për të integruar në të donacionet e dedikuara për rindërtimin edhe përgjatë vitit 2020, kur do të kryhen disbursimet e donatorëve.

Me një vlerësim të saktë dhe të plotë të nevojave për ndërhyrje, nëse do të duhet angazhim i mëtejshëm i fondeve buxhetore gjatë vitit 2020, është parashikuar skenari që në çdo rishikim buxheti kjo të ndodhë. Përfshirja e fondit si një program i posaçëm buxhetor i shërben qëllimit për të përcaktuar përgjegjësinë dhe për të vendosur njëkohësisht monitorim të plotë mbi institucionin, apo institucionet përgjegjëse për realizimin e programit, për disbursimin dhe transformimin e fondeve në vepra, apo akte të tjera që kanë lidhje me programin.

Duke qenë një zë më vete dhe projekt i dedikuar është e mundur që të identifikohet plotësisht nga të gjithë dhe të bëhet transparencë e plotë për angazhimin total në favor të rindërtimit, duke e ndarë këtë pjesë nga pjesa tjetër e buxhetit.

Objektivi ynë është shumë i qartë dhe kuptohet, që është një arsye tjetër për të parë se sa ndryshe jemi ne nga ju dhe nga të gjithë ata që mendojnë si ju. Ne nuk do t'i prekim parametrat kryesorë të buxhetit vjetor; ne nuk do ta prekim ekonominë në funksion të rindërtimit, por do të përdorim rindërtimin në funksion të ekonomisë; ne nuk do të marrim nga një anë nga populli dhe t'ia japim anës tjetër, po popullit.

Pa diskutim që në vitin 2020 ne do të realizojmë edhe domosdoshmërinë për të mbajtur dhe për të fuqizuar shërbimet, edhe domosdoshmërinë për të ecur hap pas hapi me programin e rindërtimit, edhe domosdoshmërinë për të rritur ekonominë.

Shënojmë këto dhe m'i kujtoni, nëse do të jemi ende këtu dhe do të flasim për këtë punë; nëse do të jeni ju, sepse ne do të jemi.

Për sa i përket qasjes, janë 6,2 miliardë që janë rishikuar në funksion të fondit të rindërtimit vetëm nga projektet e ministrive të linjës. Ndërkohë që për projektet e ideuara për më tutje, jo nga projektet ekzistuese, është garantuar e gjithë vazhdimësia e projekteve dhe janë financuar projektet e reja të ujitjes dhe të kullimit, sipas parashikimit. Natyrisht, duke i prioritetizuar të gjitha këto në funksion të rindërtimit, sepse nuk do të kishte asnjë kuptim që ne të ndalojmë financimin e kullimit dhe të

ujitjes për të financuar rindërtimin. Siç nuk do të kishte asnjë kuptim që të ndalojmë shërbimet për të financuar rindërtimin. Nuk do të kishte asnjë kuptim t'u thoshim njerëzve: nuk do të bëni kontroll mjekësor bazë, se ne do të rindërtojmë. Pra, t'ua hiqim gjysmë milioni të shqiptarëve të drejtën e kontrollit bazë falas me arsyen e rindërtimit. Nuk do kishte kuptim t'u thoshim të gjithëve atyre, që bëjnë më në fund hemodializën si njerëz, që do ktheheni prapë në kohën e torturave, se ne do të bëjmë rindërtimin. Nuk do të kishte kuptim t'u thoshim grave shtatzëna; do të rriini pak më shumë në maternitet pas operacionit do të infektoheni, se ne do bëjmë rindërtimin, apo hajdeni me gërshtë me vete që t'u operojmë se instrumentet mjekësore nuk do t'i paguajmë më, se sterilizimin nuk do ta paguajmë më, apo analizat për të gjithë nuk do t'i bëjmë më, se do të bëjmë rindërtimin. Nuk do kishte kuptim t'u thoshim gjithë banorëve të zonës lart, në Dibër se do ta ndalojmë rrugën e Arbrit, se do bëjmë rindërtimin. Ndërkohë që Rrugën e Arbrit, segmentin nga ana tjetër, do ta fillojë qeveria e Maqedonisë së Veriut, një nga vendimet e marra, ose më saktë të konfirmuara në tryezën që kemi bërë në Ohër dhe kështu do të krijojmë lidhje midis të dy segmenteve, si rezultat i bashkëpunimit rajonal. Do të ndërtojmë një lagje të re në Durrës, do të ndërtojmë një lagje të re në Laç dhe do të ndërtojmë tri në Tiranë: dy lagje të rëndësishme nga pikëpamja e volumit, njërën tek "5 Maji", tjetrën në Kombinatin dhe një të tretë, më të vogël, në ish-Uzinën e Autotraktorëve. Me Laçin do të fillojmë menjëherë. Besojmë se brenda pak kohe, shpresoj shumë në mars të jemi në kantier. Për lagjen e madhe të Durrësit ka filluar puna për projektimin; për lagjen "5 Maji" dhe Kombinatin po ashtu. Së shpejti fillojmë me projektimin për ish-Uzinën e Autotraktorëve. Ndërkohë që do të adresojmë edhe godinat specifike në Lezhë, apo në pikat e tjera që përbëjnë rrezikshmëri. Paralelisht po punojmë, do të kërkojë edhe kjo kohën e saj, për të gjithë projektin e riparimit, që është një projekt gjigant më vete, njësoj si të ndërtohet edhe një lagje tjetër nga e para, sepse ka shumë godina të dëmtuara që kërkojnë riparim.

Për sa i përket pjesës së pastrimit, po nga ky program do të financojmë të gjithë pastrimin, sepse janë me qindra mijëra, në mos miliona tonë mbetje që do duhet të evakohen. Kemi

vendosur që ta përdorim të gjithë sasinë e mbetjeve të Durrësit për të mbyllur përfundimisht fushën e kancerit në Porto Romano dhe për ta transformuar në një park të madh publik. Po studiojmë mundësinë e përdorimit të mbetjeve në zonën e Krujës, në Thumanë, por ndoshta edhe duke futur një sasi nga Durrësi, për të mbyllur më në fund atë kancerin tjetër mbi lëkurë, të gurorëve që na kanë turpëruar të gjithë ne. Jemi i vetmi vend në botë që mund të kthejë në gurorë dhe mund të sakatojë peizazhin e një vendi të shenjtë. Ai është vendi ynë më i shenjtë në histori, Kruja.

Duhet ta përsëris edhe këtu, sepse menjëherë sapo u bë njoftimi nga Komisioni European, për alokimin e 15 milionë eurove, u shpërnda informacioni i shoqëruar me një lajm të rremë se kaq ishte, kjo ishte Europa, jo, 15 milionë euro janë të nxjerra me urgjencë jashtë kanaleve të zakonshme për këtë fazë. Janë 15 milionë euro të nxjerra nga portofoli i Komisionerit për Fqinjësinë dhe Zgjerimin dhe ndërkohë janë në proces qoftë shqyrtimi i kërkesës sonë për të mbledhur të gjitha fondet IPA të Shqipërisë dhe për t'i vendosur në një zë për rindërtimin, qoftë mekanizmi i ndihmës, në rast fatkeqësisht, i Bashkimit European. Paralelisht është vënë në vijë edhe kërkesa e bërë qysh ditën e parë për një konferencë të madhe donatorësh, sepse në këtë rast do të ishte mirë që vendet e BE-së, por jo vetëm ato, të jepnin një kontribut veçmas arkës së buxhetit european. Besoj se këtë e kemi arritur, duke iu referuar gjithmonë deklaratës së bërë nga Presidentja e re e Komisionit. Ndërkohë, na duhet të fillojmë të financojmë fazën e tanishme, duhet të financojmë akomodimin në hotele, sipas marrëveshjes së bërë nga ministri i Turizmit.

I dëgjova edhe këtu, i kam dëgjuar edhe gjatë gjithë ditëve lloj-lloj budallallëqesh për ministrat. Unë kam zënë shumë vend në ekran e nuk e them fare për modesti, por, po të mos ishin të gjitha ata që shikoni mbrapa, nuk do të ishte bërë dot as 1/10 e punës që është bërë. Realiteti nuk është ai që tregon televizori, realiteti nuk është ai që secili percepton nga ekranet, nga portalet dhe nga kanalet. Realiteti është ai që është në territor. Nuk është as përgjegjësia dhe as detyrimi i askujt nga anëtarët e kabinetit volumi i paraqitjeve në televizor të secilit prej tyre, por nëse ministria e Shëndetësisë nuk do kishte qenë

non stop, ditë-natë, në krye të detyrës, sigurisht që nuk do të kishim pasur maksimumin në raport me motivimin, me mbështetjen, me inkurajimin e njerëzve atje.

Në rast se ministrja e Mbrojtjes që sapo është bërë nënë, nuk do të kishte qenë non stop në krye të detyrës, pavarësisht insistimit të mjekëve për të mos qenë atje gjatë gjithë kohës, sigurisht që do të kishte munguar burimi kryesor i shembullit dhe i motivimit. Jo se nuk do të kishte funksionuar shëndetësia apo emergjencat, sepse nuk funksionon kështu, por ka qenë një super energji e vënë në dispozicion nga e gjithë qeveria. Në rast se ministri i Brendshëm nuk do të kishte qenë në krye të detyrës, nuk do të kishte pasur mundësi qeveria të përcillte përmes tij gjithë atë motivim; në rast se ministrja e Infrastrukturrës dhe Energjisë nuk do të kishte qenë non stop, 24 orë dhe nuk do të kishte pushuar në makinë, jo në shtëpi, dy orë, sa për të vazhduar punën, sigurisht që nuk do të kishim pasur mundësi t'i karikonim dhe t'i motivonim njerëzit e kështu me radhë, që të mos i numëroj të gjithë, deri tek zëvendëskryeministri që ka qenë *non stop*. Prandaj mirë është që gjërat t'i shohim siç janë. Nuk kemi bërë ndonjë mrekulli, nuk kemi pasur as perfeksion dhe as një punë që nuk ka pasur të meta. Dëgjova një këtu, Ralfi më duket, se nga Ralfi na vijnë këto direktivat, që kishte parë konfuzion. Tani, nëse një tërmet që mori me vete një popull të tërë, nuk do të shkaktonte një situatë me intensitet aq të lartë emocionesh dhe sigurisht, edhe me një lloj kaotizmi në fillim, atëherë ne nuk do të ishim një shtet mbi këtë rruzull, do të ishim ndonjë shtet model në ndonjë planet tjetër. Po, ka pasur raste abuzimi me ndihmat, se ato që kanë dalë në televizor nuk kanë qenë me aktorë filmash, por ato abuzime, dhe po ju shtoj unë edhe nja 30 të tjera që nuk kanë dalë në televizor, a e dini sa janë, në raport me ndihmat që kanë ardhur? As 1% e tyre. Janë episode, por, nëse episodet merren e kthehen në këngë e në valle nëpër ato tendat televizive, ku ata që ishin prekur realisht nga tërmeti dukeshin njerëz normalë dhe ata që tërmeti vetëm sa i kishte tundur pak nga karrigia nga poshtë-lartë dukeshin sikur ishin çmenduar, natyrisht që mesazhi është i keq dhe, natyrisht, të gjithë ata që e ndjekin këtë situatë nga matanë kufijve tmerrohen. Një dekurajim, një mërzi, një çorodi tek njerëzit, që në televizor kërkonin të

shikonin se çfarë po ndodh në vendin e tyre, çfarë po ndodh me familjet e tyre, çfarë po ndodh me lagjen e tyre, çfarë po ndodh me të afërmit e të njohurit e tyre dhe shikonin hajdutë xhepush, sikur ishin ata që kishin marrë situatën e territorin në kontroll dhe jo 5000 njerëz; policë, ushtarë, zjarrfikës, mjekë, infermierë dhe njerëz të shtetit. Pastaj klithmat: “nuk paska doreza”, “nuk paska kapele”, “nuk paska çizme”, histori qensh. Për më tepër që faktet janë fakte, sepse ka pasur 900 e kusur të plagosur dhe mbi 300 prej tyre kanë hyrë në kategorinë e atyre që ishin realisht në rrezik. Kush e nxori pjesën më të madhe të atyre që ishin nën gërmadha?! I nxorën këta që klithnin nëpër tendat e medias, apo i nxorën njerëzit e këtij shteti? Misioni i parë i ardhur nga jashtë erdhi në kohë urgjente, por ka ardhur vonë, sepse kur mbërriti, në Shqipëri ishte errësuar dhe numri i të shpëtuarve ishte 38. Kush i nxori ata?! I nxorën këta me telat e mikrofonave, apo i thithën me objektivin e kamerës, apo i nxori Ralfi, duke kërkuar matrapik?! Jo, i nxorën njerëzit e shtetit. Natyrisht që në operacionet e tjera duhej një supersofistikim, që ne nuk e kemi dhe është e kotë ta mohojmë. Ky është rasti për ta përmirësuar më tutje të gjithë strukturën tonë të forcave që janë për reagimin e menjëhershëm dhe këtë duhet ta adresojmë në ligj. Dëgjova dikë këtu, më duket se erdhi nga naltmadhnia, nuk e mora vesh se kush e tha, por ngaqë naltmadhninë e dëgjoj me shumë vëmendje gjithmonë, kam përshtypjen që ishte një klithmë e tij, i cili tha se po fshihen provat. Cilat prova po fshihen?! Po pastrohen gërmadhat në Durrës dhe po fshihen provat?! E keni shumë gabim, sepse është fotografuar menjëherë kur ka ndodhur, është fotografuar gjatë procesit, është fotografuar edhe mbrapa dhe aty ku është pastruar janë marrë kampionët e betonit, të tullave e të gjitha me radhë, që merren në këto raste dhe dosjet po bëhen gati. Edhe këtu pati klithma për arrestime: “Pse nuk janë arrestuar ende”, ndërkohë që kjo është një klithmë e përgjithshme e tendave mediatike, që kërkonin arrestime që ditën e parë. Natyrisht, ata duan arrestime, sepse nuk ju punon themeli. Në vend që ditën e parë, ditën e dytë, e ditën e tretë, ditën e katërt e ditën e pestë t'i kthenin sallonet e tyre në sallone energjish pozitive, të qetësonin njerëzit, të bënin verifikim të pesëfishtë të pseudoekspertëve që sillnin aty,

të garantimin 100% që kush futej aty të thoshte një fjalë të mençur e jo budallallëqe, u futën në garë se kush gjen më shumë delirantë për t'i marrë. Donin arrestime që ditën e parë dhe donin faturën e dëmeve ditën e dytë, ndërkohë që vendet e tjera, të cilat kanë kaluar në këto situata, duan gjysmë viti, në rastin më të mirë, të nxjerrin faturën. Madje ata donin edhe shtëpi që ditën e parë, ndërkohë që fqinjët tanë, të cilët janë me një histori, fatkeqësisht, plot me tërmete, kanë ende nëpër kabina njerëzit e tërmetit të vitit 2009. Në shumë nga vendet që po na ndihmojnë ka reagime nga komunitete që akoma presin, nuk po përmend emra, por emra të vendeve më të mëdhenj të Europës, kompensime e dëmshpërblime nga histori tërmetesh që kanë ndodhur vite më parë dhe shkruajnë nëpër profilet e kryeministrave e të presidentëve: “Çfarë Shqipërie do të ndihmoni, kur ne po presim këtu dhe ende nuk kemi marrë ndihmë”, ndërsa këta, pa varrosur akoma të vdekurit, duan arrestime, dëmshpërblime dhe shtëpi. Këta i duan të gjitha ngaqë vetë i kanë marrë qyl gjërat në jetë. E sigurt është që të gjitha ndërtimet, jo vetëm ato të shemburat, por edhe ato që janë në riparim, janë në proces hetimi, ditë-natë dhe jo tani. Që nga ora e parë, drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit ka angazhuar grupin e posaçëm të Policisë Kriminale për të filluar menjëherë me mbledhjen e provave dhe tani po punojnë bashkë me prokurorinë për të evidentuar të gjitha. Janë dosje të tëra, që janë marrë dhe vazhdojnë të merren nga bashkitë përkatëse për të bërë analizë, por për këtë duhen edhe ekspertët e ndërtimit brenda. I gjithë Instituti ynë i ndërtimit është në terren, ditë-natë.

Së fundi, kam dëgjuar shumë herë që është thënë: “S”kemi shtet ne dhe vijnë të tjerët”. Shikoni misionet e kërkim – shpëtimit në Itali, ku Italia ka një nga trupat më të mira në botë për kërkim-shpëtimit, që i jep mësim botës, shikoni sa misione kërkim-shpëtimi kanë shkuar në Itali. Kanë shkuar misione nga Japonia, Kanadaja, Izraeli, BE-ja nuk diskutohet, nga Australia dhe Zelanda e Re, sepse asnjë vend nuk ka luksin dhe kapacitetin të mbajë një trupë të atillë në numër për një moment të tillë, nëse ky moment është aq shkatërrues. Asnjë!

Jo më larg se në takimin e Novisadit, unë e kam diskutuar këtë gjë, që të krijohet një mekanizëm ballkanik i të gjitha vendeve të

Ballkanit për të pasur një rrjet të integruar të trupës së emergjencave civile, në mënyrë që kur ndodh fatkeqësia diku të vihen të gjithë në lëvizje, jo thjesht me vullnetarizëm, por me detyrim, në bazë të angazhimeve të marra nga çdo shtet dhe nga çdo parlament, siç e ka BE-ja. Kur ndodh diçka në BE, ata vihen në lëvizje të gjithë me detyrim. Janë një. Ndërsa këtu te ne thonë: “Jo, pse nuk i bëjmë vetë këto”, “Nuk ka shtet këtu dhe të gjithë e kanë mendjen të vjedhin”. Po patët mundësi, lërin këto histori e të vini këtu dhe të vazhdoni me muhabete rrugësh: “vjedhje”, “ti me euro, ai me dollarë”, lërin! Lërxani këto paraardhësve tuaj dhe mbajeni me nder, këtë kohë që keni, karrigen në parlament. Shtrëngohuni dhe mbajeni me nder, mos u bëni njësoj si ata dhe të mos kuptohet dallimi, sepse dilni më keq. Ata flisnin më mirë se ju, sepse shumica prej jush ka problem me vendosjen e kallëzuesit në vendin e duhur. Të paktën mbajeni me nder këtë pjesë, silluni këtu siç silleni nëpër shtëpitë tuaja e familjet tuaja dhe mos hajdeni këtu të na rrokanisni kokën me shprehjet: “vodhi, nuk vodhi”. Këto janë fjali të tmerrshme për një parlament, pavarësisht se janë bërë si buka që ha.

Nuk po zgjatëm më shumë me aspekte të tjera të buxhetit, por dua të ritheksoj se vitin 2020 ne e shohim si vit të rindërtimit dhe të vazhdimet të zhvillimit ekonomik dhe social. Ne do ta bëjmë dhe do të dëshmojmë me vepra që kjo është e duhura, në mënyrë që ata, të cilët kanë nevojë për mbështetje, ta marrin mbështetjen dhe ata që kanë nevojë për strehë, ta marrin strehën. Ka edhe shumë aspekte të tjera që nuk i preka këtu, të cilat kanë të bëjnë me financimin e fazës së tranzicionit nga hoteli në shtëpi, sepse nuk do të rrinë në hotel deri sa të bëhen shtëpitë. Duke filluar nga janari ata do të spostohen në apartamente, që ne do t'i marrim me qira për ta. Nga ana tjetër, fokusimi tek ata nuk duhet të kthehet në një torturë për pjesën tjetër, sepse solidariteti shqiptar është vërtet një gjë madhështore, por e ka afatin e shkurtër. Po ta kishim pasur solidaritetin afatgjatë, do të ishim si Izraeli, por e kemi solidaritetin me intensitet të madh në një kohë të shkurtër. Ne kemi edhe një karakteristikë tjetër, bëhemi shumë të urtë dhe i lutemi Zotit kur Zoti na duket si varkë për të kaluar lumin e rrëmbyer dhe kur jemi matanë i themi Zotit: “Ta futa edhe kësaj radhe, shihemi

herën tjetër”. Më vjen keq, por kjo është e vërteta.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Cila opozitë, sepse ju jeni shumë? Na ndihmoni ju këtu, sepse ju jeni pasojat e tërmetit të opozitës. Opozita ra, gërmadhat jeni ju. Ata nuk e di ku janë, në kuptimin e mirë të fjalës, mos m'i merrni për keq këto gjëra, sepse unë e kam me shumë dashamirësi, por, ju lutem shumë, në këtë fazë pak përmbajtje nga fjalori i përditshëm! Pastaj do të vijë dita dhe këtu do të jemi. Meqenëse hyri naltmadhnia, unë po e ndërpres fjalën dhe po shkoj në vendin tim.

Shumë faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, Kryeministër!

Vazhdojmë me projektligjin “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në aktin final të konferencës së shteteve anëtare të Konventës Ndërkombëtare për Standardet e Kualifikimit, Certifikimit dhe Shërbimit për Detarët”. Nuk ka diskutantë.

Kalojmë te projektrezoluta “Për ndërhyrjet e huaja në proceset zgjedhore dhe dezinformimin në proceset demokratike kombëtare”. Edhe këtu janë tërhequr kolegët, të cilët ishin regjistruar për diskutim.

Këtu mbyllet debatet për çështjet e sotme.

Ju lutem, bëhuni gati për votim!

Kalojmë në procesin e votimit dhe të bëhen gati kolegët.

Hapet votimi për prezencën.

Mbyllet votimi për prezencën.

113 deputetë janë prezentë.

Fillojmë me projektvendimin “Për zgjedhjen e Prokurorit të Përgjithshëm”. Në mbështetje të nenit 148, germa “a” të Kushtetutës dhe nenit 35 të ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, projektvendimi kërkon shumicë të cilësuar votash për miratim, pra tre të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit, ose të paktën 84 vota pro.

Ju rikujtoj se Këshilli i Lartë i Prokurorisë, me vendimin nr. 236, datë 14.11.2019, ka miratuar renditjen e kandidatëve për Prokuror të Përgjithshëm, si dhe relacionin shoqërues dhe ia ka përcjellë Kuvendit të Shqipërisë.

Siç jeni në dijeni, kandidaturat janë renditur si më poshtë: 1. Olsian Çela, 2. Arta Marku, 3. Fatjona Memçaj. Për procedurën e votimit vetëm

një kërkesë për mënyrën e votimit me elektronikë, sigurisht votimi është i fshehtë, dhe duhen, siç e thashë, 84 vota pro për miratim.

Të përgatitemi për votim të fshehtë për kandidatin e parë, zotin Olsian Çela.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

Janë 101 vota pro, 2 vota kundër dhe 10 vota abstenime.

(Duartrokitje nga salla)

Sipas Rregullores, do të vazhdojmë edhe me kandidatët e tjerë.

Hapet votimi me elektronikë për zonjën Arta Marku.

Mbyllet votimi.

Janë 11 vota pro, 22 vota kundër dhe 78 vota abstenime dhe 2 deputetë nuk kanë marrë pjesë në votim.

Vazhdojmë votimin për zonjën Fatjona Memçaj

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

Janë 8 vota pro, 16 vota kundër dhe 87 vota abstenime dhe 3 deputetë nuk kanë marrë pjesë në votim.

Pra, si rezultat i votimit, Prokuror i Përgjithshëm zgjidhet zoti Olsian Çela.

Në mbështetje të nenit 36 të ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, Prokurori i Përgjithshëm, para se të fillojë detyrën, duhet të bëjë betimin para Kuvendit të Shqipërisë në një ceremoni publike, sipas formulës së përcaktuar në ligj. Prandaj, shërbimet e Kuvendit të kontaktojnë me Prokurorin e Përgjithshëm të porsazgjedhur për të qenë i pranishëm për betimin në fund të seancës plenare.

Vazhdojmë me projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar” (votim në parim). Sipas Kushtetutës dhe Rregullores, kërkohet shumicë e thjeshtë votash për miratim; një votim me elektronikë në parim.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

Me 93 vota pro, 13 vota kundër, 3 vota abstenime dhe 5 deputetë që nuk kanë marrë pjesë në votim miratohet projektligji në parim.

Vazhdojmë me projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar” (votim në parim). Edhe ky projektligj kërkon shumicë të thjeshtë votash për miratim.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

Janë 88 vota pro, 16 vota kundër, 5 vota abstenime dhe 5 deputetë nuk kanë marrë pjesë në votim.

Vazhdojmë me projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”. Edhe ky votim në parim kërkon shumicë të thjeshtë votash për miratim.

Hapet votimi me elektronikë në parim.

Mbyllet votimi.

Janë 88 vota pro, 18 vota kundër, 5 vota abstenime dhe 3 deputetë nuk kanë marrë pjesë në votim.

Vazhdojmë me projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar” (votim në parim). Sipas Kushtetutës dhe Rregullores, kërkohet shumicë e thjeshtë votash për miratim.

Hapet votimi me elektronikë.

Mbyllet votimi.

Janë 87 vota pro, 17 vota kundër, 5 vota abstenime dhe 5 deputetë nuk kanë marrë pjesë në votim.

Vazhdojmë me projektligjin “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit” (votim në parim). Sipas Kushtetutës dhe Rregullores, kërkohet shumicë e thjeshtë votash për miratim.

Hapet votimi me elektronikë në parim.

Mbyllet votimi.

Janë 88 vota pro, 18 vota kundër, 5 vota abstenime dhe 3 deputetë nuk kanë marrë pjesë në votim.

Miratohet në parim.

Vazhdojmë me projektligjin “Për buxhetin e vitit 2020” (votim në parim). Sipas Kushtetutës dhe Rregullores, kërkohet shumicë e thjeshtë votash për miratim.

Hapet votimi me elektronikë në parim.

Mbyllet votimi.

Janë 92 vota pro, 15 vota kundër, 3 vota abstenime dhe 4 deputetë nuk kanë marrë pjesë në votim.

Vazhdojmë me aktin normativ nr. 4, datë 30.11.2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”. Sipas Kushtetutës dhe Rregullores, ky akt normativ kërkon shumicë e thjeshtë votash për miratim. Procedura e votimit: një votim me elektronikë. Votimi është i hapur.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

Me 94 vota pro, 10 vota kundër dhe 5 vota abstenime miratohet akti normativ nr. 4.

Vazhdojmë me aktin normativ nr. 5, datë 30.11.2019 “Për një shtesë në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar”. Sipas Kushtetutës dhe Rregullores, kërkohet shumicë e thjeshtë votash për miratim. Procedura e votimit: një votim me elektronikë, votim i hapur.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

Me 97 vota pro, 9 vota kundër, 1 votë abstenim dhe 7 deputetë që nuk morën pjesë në votim miratohet akti normativ nr. 5.

Vazhdojmë me aktin normativ nr. 6, datë 30.11.2019 “Për dhurimin e apartamenteve familjarëve të viktimave, si pasojë e tërmetit të datës 26.11.2019”. Në mbështetje të Kushtetutës dhe Rregullores, kërkohet shumicë e thjeshtë votash për miratim. Procedura e votimit: një votim me elektronikë, votim i hapur.

Hapet votimi me elektronikë.

Mbyllet votimi.

Më falni, por të paktën vetëm për këtë mos votoni kundër!

Kush ka votuar kundër?

Megjithatë, është e drejta juaj!

Mbyllet votimi.

112 vota pro, 1 votë kundër, asnjë abstenim dhe 1 deputet nuk ka marrë pjesë në votim miratohet akti normativ nr. 6.

Vazhdojmë me aktin normativ nr. 7, datë 30.11.2019 “Për një shtesë në ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”. Në mbështetje të Kushtetutës dhe Rregullores, kërkohet shumicë e thjeshtë votash për miratim.

Procedura e votimit është e njëjtë si më lart: një votim i hapur me elektronikë.

Hapet votimi me elektronikë.

Mbyllet votimi.

Me 105 vota pro, 1 votë kundër, dy vota abstenime miratohet edhe akti normativ nr. 7.

Vazhdojmë me projektligjin “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në aktin final të konferencës së shteteve anëtare të Konventës Ndërkombëtare për Standardet e Kualifikimit, të Certifikimit dhe Shërbimit për Detarët (STCW) 1978”, i cili kërkon shumicë absolute votash për miratim.

Hapet votimi me elektronikë në parim.

Mbyllet votimi.

Janë 107 vota pro, asnjë votë kundër, asnjë abstenim dhe 7 deputetë nuk kanë marrë pjesë në votim.

Kalojmë në shqyrtimin nen për nen me kartonë, sipas variantit të propozuesit.

Neni 1. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi.

Hapet votimi me elektronikë.

Mbyllet votimi.

Me 103 vota pro, asnjë votë kundër, 1 votë abstenim dhe 10 deputetë që nuk kanë marrë pjesë në votim miratohet edhe në tërësi.

Vazhdojmë me projektrezolutën “Për ndërhyrjet e huaja në proceset zgjedhore dhe dezinformimit në proceset demokratike kombëtare”. Sipas Kushtetutës dhe Rregullores, kërkohet shumicë e thjeshtë votash.

Ju rikujtoj, para se të votoni, se komisioni përgjegjës ka paraqitur një variant integral të projektrezolutës, ku përfshihen amendamentet e paraqitura si nga deputetët, ashtu edhe nga Komisioni për Politikën e Jashtme, si komisione për dhënie mendimi. Variantin integral e keni të gjithë përpara në tavolinën e punës.

Hapet votimi me elektronikë.

(Ndërhyrje nga salla)

Nuk kërkohet fjala gjatë votimit.

(Ndërhyrje nga salla)

Nuk ka. Procedura është e saktë.

(Ndërhyrje nga salla)

Debatu u bë, por ju ishit në kafe.

(Ndërhyrje nga salla)

E pra, nuk do të të presim ty të vish nga kafja!

(Ndërhyrje nga salla)

Vazhdojmë me votimin, ju lutem!

Mbyllet votimi.

Janë 97 vota pro, 5 vota kundër, 6 vota abstenime.

Miratohet.

Vazhdojmë me projektvendimin “Për shqyrtimin me procedurë të përshpejtuar të projektligjit “Për një ndryshim në ligjin “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”.

Sipas Kushtetutës dhe Rregullores, kërkohet shumicë e thjeshtë votash. Në mbështetje të nenit 28 të Rregullores shprehet një folës pro dhe një folës kundër.

Kush e do fjalën nga maxhoranca? Nuk e do njeri. Nga opozita? Nuk ka. Komision përgjegjës caktohet Komisioni për Ekonominë dhe Financat. Shqyrtimi në seancë plenare do të bëhet në datën 19 dhjetor. Projektvendimin e keni të gjithë përpara.

Hapet votimi me elektronikë.

Mbyllet votimi.

Janë 91 vota pro, 2 vota kundër, 8 vota abstenim, 13 deputetë nuk kanë marrë pjesë në votim.

Miratohet.

Projektvendimi “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 84/2019 “Për kontrollin e ligjshmërisë së veprimeve të kryera nga ana e Presidentit të Republikës së Shqipërisë në kuadrin e ushtrimit të kompetencave të tij lidhur me zhvillimin e zgjedhjeve të organeve të qeverisjes vendore, i ndryshuar”. Projektvendimin e keni të gjithë përpara në tavolinën e punës. Procesi i votimit është një votim me elektronikë.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

Janë 98 vota pro, 4 vota kundër, 3 vota abstenim, 9 deputetë nuk kanë marrë pjesë në votim.

Miratohet.

Projektvendimi “Për një ndryshim në vendimin nr. 100/2017 “Për caktimin e anëtarëve zëvendësues në komisionet e përhershme të Kuvendit të Shqipërisë”. Me propozim të kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, zotit Balla, deputetja Ardiana Jaku

caktohet anëtare zëvendësuese në Komisionin për Integrimin European në vend të deputetes Eglantina Gjermeni.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

Janë 100 vota pro, asnjë votë kundër, asnjë votë abstenim, 14 deputetë nuk kanë marrë pjesë në votim.

Miratohet.

Ka ardhur zoti Çela?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vazhdojmë me pikën tjetër të rendi të ditës, që e thashë në fillim të votimit. Në mbështetje të nenit 36 të ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë së Republikës së Shqipërisë”, prokurori i Përgjithshëm, para se të fillojë detyrën, bën betimin para Kuvendit të Shqipërisë në një ceremoni publike, sipas formulës që është përcaktuar në ligj.

Ftoj zotin Çela të paraqitet për të bërë betimin.

Formula e betimit është: “Betoem solemnisht se gjatë kryerjes së detyrës do t’u qëndroj kurdoherë besnik Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjeve në fuqi dhe do të respektoj rregullat e etikës profesionale”.

Olsian Çela - Betoem!

Gramoz Ruçi – Urime, zoti prokuror i Përgjithshëm!

Këtu mbyllet seanca e ditës së sotme.

Faleminderit!

(Seanca u mbyll në orën 16:00)

Kryetari i Kuvendit

Gramoz Ruçi

Sekretari për Procedurat dhe Votimin

Alket Hyseni

Drejtori i Shërbimit të Botimeve

Parlamentare

Krenar Hajdëri